

Indeksi i Politikave për NVM-të

Balkani Perëndimor dhe Turqia 2019

VLERËSIMI I ZBATIMIT TË AKTIT TË BIZNESIT
TË VOGËL PËR EVROPËN

KOSOVA: PROFILI I AKTIT TË BIZNESIT TË VOGËL



Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019

Profili i Aktit të Biznesit të Vogël i Kosovës

Nga:

Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019

Vlerësimi i zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën

Publikimi i plotë mund të gjendet në:

<https://doi.org/10.1787/g2g9fa9a-en>

Ky publikim të citohet si:

OECD/ETF/EU/EBRD (2019), "Profili i Aktit të Biznesit të Vogël i Kosovës", në Indeksin e Politikave për NVM-të: *Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019: Vlerësimi i zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën*, Indeksi i Politikave për NVM-të, OECD Publishing, Paris.
<https://doi.org/10.1787/g2g9fa9a-en>

Të dhënat statistikore për Izraelin ofrohen nga dhe nën përgjegjësinë e autoriteteve përkatëse izraelite. Përdorimi i këtyre të dhënave nga OECD-ja është pa paragjykim për statusin e Lartësive të Golanit, Jerusalemit Lindor dhe vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor sipas kushteve të së drejtës ndërkombëtare.

Foto: Cover © Designed by Caroline Lee, Spielplatz 13.

Korrigjimet e publikimeve të OECD-së mund të gjenden online në: www.oecd.org/about/publishing/corrigenda.htm.

© OECD, FET, Bashkimi Evropian dhe BERZH 2019

Ju mund të kopjoni, shkarkoni ose shtypni përmbajtjen e OECD-së për përdorim tuaj dhe mund të përfshini fragmente nga publikimet e OECD-së, bazat e të dhënave dhe produktet multimediale në dokumentet tuaja, prezantimet, blogjet, faqet e internetit dhe materialet mësimore, me kusht që është paraqitur njëjta e përshtatshme e OECD si burim dhe pronari i të drejtës së autorit. Të gjitha kërkesat për përdorim publik dhe komercial dhe të drejtat e përkthimit duhet të dorëzohen në rights@oecd.org. Kërkesat për leje për të fotokopuar pjesët e këtij materiali për përdorim publik ose komercial duhet të drejtohen drejtpërdrejt në Qendrën për Lëshimin e të Drejtave të Autorit (CCC) në info@copyright.com ose në Qendrën e shfrytëzimit të kopjeve (CFC) në @cfcopies.com.

—

Parathënie

Kapitujt e profilit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën (ABV) të *Indeksit të Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019* ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zbatimit të dhjetë parimeve të ABV-së në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Kosova*, Mali i Zi dhe Serbia) dhe nga Turqia, duke theksuar sfidat aktuale dhe duke dhënë rekomandime përkatëse për kapërcimin e tyre. Ato janë të dizajnuara për të mbështetur përpjekjet e kandidatëve dhe kandidatëve të mundshëm për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) në hartimin e politikave të tyre të bazuara në dëshmi për ndërmarrjet, me theks të veçantë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Secili prej këtyre profileve mbulon progresin e bërë nga ekonomia e vlerësuar në zbatimin e Aktit të Biznesit të Vogël gjatë periudhës 2016-18.

Ky profil ofron një pasqyrë të kontekstit ekonomik të Kosovës, mjedisit të biznesit dhe statusit të procesit të anëtarësimit në BE. Ai jep disa fakte kryesore për NVM-të në ekonominë kosovare, duke hedhur dritë mbi karakteristikat e sektorit të NVM-ve. Ai vlerëson gjithashtu përparimin e bërë në 12 dimensionet tematike të politikave që lidhen me ABV-në gjatë periudhës referuese dhe jep rekomandime shënjestruese të politikave për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Analizat janë bërë bazuar në metodologjinë e Indeksit të Politikave për NVM-të të zhvilluar nga OECD-ja dhe institucionet partnere në vitin 2006, si dhe të rishikuar dhe përmirësuar në katër vlerësime të mëvonshme (2007, 2009, 2012 dhe 2016) për të përcjellë zbatimin e ABV-së nga ana e Kosovës. Në këtë vlerësim, tregues të rinj dhe aspekte të reja të politikave kanë zgjeruar dhe përmirësuar kornizën e vlerësimit për të kapur më mirë zhvillimet e fundit në peizazhin e politikave për NVM-të. Secilit dimension i cakton pikë, që janë rezultat i të dhënave sasiore dhe cilësore të konsoliduara nga vlerësimet e qeverisë dhe ato të pavarura, si dhe të përmirësuara në bazë të konsultimeve me sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile në rajon.

Profilet e ekonomive përkitazi me ABV-në janë punë e përbashkët e OECD-së, Fondacionit Evropian të Trajnimit (ETF) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ekipi është mirënjohës për komentet dhe sugjerimet e vlefshme të ofruara nga Komisioni Evropian, delegacionet e BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi, si dhe ekonomitë e vlerësuara. E gjithë puna u koordinua nga Divizioni i OECD-së për Evropën Juglindore dhe u prodhua me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian.

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e KS të KB 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|-----------|
| Parathënie | 3 |
| Shkurtesat dhe akronimet | 7 |
| Kapitulli 15. Kosova: Profili i Aktit të Biznesit të Vogël | 11 |
| Të gjeturat kryesore..... | 12 |
| Konteksti ekonomik dhe roli i NVM-ve..... | 15 |
| Vlerësimi dhe rekomandimet | 24 |
| Të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësia e grave (Dimensioni 1)..... | 26 |
| Falimentimi dhe shansi i dytë (Dimensioni 2)..... | 31 |
| Korniza institucionale dhe rregullatorë për hartimin e politikave për NMV-të (Dimensioni 3)..... | 36 |
| Mjedisi operacional për NMV-të (Dimensioni 4) | 41 |
| Shërbimet mbështetëse për NMV-të (Dimensioni 5a)..... | 45 |
| Prokurimi publik (Dimensioni 5b) | 48 |
| Qasja në financa për NMV-të (Dimensioni 6)..... | 51 |
| Standardet dhe rregulloret teknike (Dimensioni 7)..... | 55 |
| Aftësitë e ndërmarrjes (Dimensioni 8a)..... | 61 |
| Politika e inovacionit për NMV-të (Dimensioni 8b) | 64 |
| NMV-të në një ekonomi të gjelbër (Dimensioni 9)..... | 68 |
| Ndërkombëtarizimi i NMV-ve (Dimensioni 10) | 71 |
| Përfundime | 76 |
| Shënime..... | 76 |
| Referencat..... | 79 |
| Literaturë shtesë | 84 |
| Shtojca A. Metodologjia për vlerësimin e Aktit të Biznesit të Vogël 2019: | 85 |
| Pasqyrë e kornizës së vlerësimit të vitit 2019 dhe poentimit (rezultateve) | 85 |
| Ndryshimet kryesore në kornizën e vlerësimit që nga vlerësimi ABV në vitin 2016..... | 87 |

Tabelat

| | |
|--|----|
| Tabela 15.1. Kosova: Indikatorët kryesorë makroekonomikë (2013-18)..... | 15 |
| Tabela 15.2. Reformat më të reja biznesore në Kosovë | 19 |
| Tabela 15.3. Përkufizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë | 21 |
| Tabela 15.4. Numri i kompanive të regjistruara në Kosovë sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe Komunës..... | 23 |
| Tabela 15.5. Përshkrimi i niveleve të rezultateve | 25 |
| Tabela 15.6. Rezultatet (Pikët) për Dimensionin 1: Të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësia e grave..... | 26 |
| Tabela 15.7. Rezultatet për Dimensionin 2: Falimentimi dhe shansi i dytë | 31 |
| Tabela 15.8. Pasqyrë e ndryshimeve të prezantuara në kornizën e re të insolvencës | 32 |
| Tabela 15.9. Rezultatet për Dimensionin 3: Korniza institucionale dhe rregullatore për hartimin e politikave për NVM-të..... | 36 |
| Tabela 15.10. Rezultatet për Dimensionin 4: Mjedisi operacional për NMV-të | 41 |
| Tabela 15.11. Rezultatet për Dimensionin 5a: Shërbimet mbështetëse për NMV-të | 45 |
| Tabela 15.12. Rezultatet për Dimensionin 5b: Prokurimi publik | 48 |
| Tabela 15.13. Rezultatet për Dimensionin 6: Qasja në financa për NMV-të | 51 |
| Tabela 15.14. Rezultatet për Dimensionin 7: Standardet dhe rregulloret teknike | 55 |
| Tabela 15.15. Rezultatet për Dimensionin 8a: Aftësitë e ndërmarrjes | 61 |
| Tabela 15.16. Rezultatet për Dimensionin 8b: Politika e inovacionit për NMV-të..... | 64 |
| Tabela 15.17. Rezultatet për Dimensionin 9: NMV-të në një ekonomi të gjelbër..... | 68 |
| Tabela 15.18. Rezultatet për Dimensionin 10: Ndërkombëtarizimi i NMV-ve..... | 71 |
| Tabela A A.1. Përshkrimi i niveleve të rezultateve | 86 |
| Tabela A A.2. Pasqyrë e përgjithshme e ndryshimeve në vlerësimin e ABV... .. | 87 |
| Tabela A A.3. Llojet dhe burimet e të dhënave | 90 |

Figurat

| | |
|--|----|
| Figura 15.1. Rezultati (Pikët) e Kosovës për Aktin e Biznesit të Vogël (2016 dhe 2019) | 12 |
| Figura 15.2. Treguesit e demografisë së biznesit në Kosovë (2013 dhe 2016) | 22 |
| Figura 15.3. Shpërndarja sektoriale e NVM-ve në Kosovë (2016) | 23 |
| Figure A A.1. Shembuj të nivelit të dimensionit, nën-dimensionit dhe treguesit..... | 85 |
| Figure A A.2. Zbërthimi i rezultatit (poentimit) për nën-dimension | 87 |
| Figure A A.3. Struktura e intervistave të sektorit privat | 89 |

Kutitë

| | |
|---|----|
| Kutia 15.1. Programet e Reformave Ekonomike të BE-së | 18 |
| Kutia 15.2. Plani i Francës për Ndërmarrësinë e Grave | 29 |
| Kutia 15.3. Early Warning Europe (“Paralajmërimi i hershëm në Evropë”)..... | 34 |
| Kutia 15.4. Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-21) | 37 |
| Kutia 15.5. Këshilli Profesional i Standardizimit: Drejtë përfshirjes më të mirë të sektorit privat në standardizimin | |

| | |
|---|----|
| kombëtar..... | 57 |
| Kutia 15.6. <i>Confartigianato Imprese</i> : Udhëzimet e NVM-ve për zbatimin e markës CE..... | 59 |
| Kutia 15.7. Parku Kosovaro-Gjerman i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren | 66 |
| Kutia 15.8. Green Business Ireland: Ngritja e ndërgjegjësimit për përparësitë e bërjes së NVM-ve të gjelbërta dhe rritja e efikasitetit të burimeve | 69 |

Shkurtesat dhe akronimet

| | |
|-----------------|---|
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| SHMB | Shërbimet për Mbështetje të Bizneseve |
| OVK | Organi për Vlerësimin e Konformitetit |
| CEN | Komiteti Evropian për Standardizim |
| CENELEC | Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik |
| COSME | Konkurrueshmëria e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme |
| EA | Bashkëpunimi Evropian për Akreditim |
| BERZH | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim |
| PRE | Programi i Reformave Ekonomike |
| BE | Bashkimi Evropian |
| EUR | Euro |
| FET | Fondacioni Evropian i Trajnimeve |
| EWE | Sistemi evropian i paralajmërimit të hershëm (<i>Early Warning Europe</i>) |
| IHD | Investimet e Huaja Direkte |
| BPV | Bruto Produkti Vendor |
| GIZ | Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (<i>Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</i>) |
| AKB | Të Ardhurat Kombëtare Bruto |
| QIK | Qendra e Inovacionit të Kosovës |
| TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Teknologjisë |
| FI | Fondi për Inovacion |
| PIT | Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve |
| JICA | Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| ARBK | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës |
| FKGK | Fondi Kosovar për Garanci Kreditore |
| AMMK | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës |
| KEC | Qendra për Arsim e Kosovës |
| KIESA | Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë |
| KPS | Këshilli Profesional i Standardizimit |
| AKS | Agjencia Kosovare e Standardizimit |
| IMF | Institucion mikrofinanciar |
| NSHK | Ndërmarrje shumëkombëshe |
| MTI | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë |
| NACE | Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian |
| KKZHEK | Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës |
| OJQ | Organizatë joqeveritare |
| KJP | Kredi joperformuese |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| PISA | Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve |
| KPP | Konsultimi publiko-privat |
| LPP | Ligji për Prokurimin Publik |
| ZPP | Zyra e Prokurimit Publik |
| KRPP | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik |
| SPP | Sekretariati i Politikave Publike / Shërbimi i Prokurimit Publik |
| OSHP | Organi Shqyrtues i Prokurimit |
| K&ZH | Kërkimi dhe zhvillimi |
| ANR | Analiza e ndikimit rregullativ |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit |
| ABV | Akti i Biznesit të Vogël |
| NVM | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme |
| NSH | Ndërmarrje shtetërore |
| ANT | Analiza e nevojave të trajnimit |
| UNDP | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |

| | |
|-------------|--|
| USD | Dollar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës |
| TVSH | Tatimi i Vlerës së Shtuar |
| AAP | Arsimi dhe Aftësimi Profesional |
| KV | Kapitali sipërmarrës |
| BPT | Ballkani Perëndimor dhe Turqia |

| Shkurtesat e ekonomive* | |
|-------------------------|------------------------|
| ALB | Shqipëria |
| BIH | Bosnja dhe Hercegovina |
| KOS | Kosova* |
| MKD | Maqedonia e Veriut |
| MNE | Mali i Zi |
| SRB | Serbia |
| TUR | Turqia |

Shënim: * Shifrat në këtë publikim përdorin kodet ISO alpha-3 për emrat e ekonomive, me përjashtim të Kosovës.

** Kosova nuk është e përfshirë si një ekonomi e standardit ISO. Megjithatë kodi jozyrtar treshifror XKX përdoret nga Komisioni Evropian, publikimi zgjodhi KOS për referencë më të lehtë.


Kapitulli 15. Kosova: Profili i Aktit të Biznesit të Vogël

Ky kapitull mbulon në hollësi progresin e bërë nga Kosova në zbatimin e Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën (ABV) gjatë periudhës 2016-18. Fillimisht ai jep një përmbledhje të kontekstit ekonomik të Kosovës, mjedisit të biznesit dhe statusit të procesit të anëtarësimit të saj në BE. Më pas ai jep disa fakte kryesore për NVM-të në ekonominë kosovare, duke hedhur dritë mbi karakteristikat e sektorit të NVM-ve. Në fund ai vlerëson përparimin e bërë në 12 dimensionet tematike të politikave që lidhen me ABV-në gjatë periudhës referuese dhe jep rekomandime shënjestruese të politikave.

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e KS të KB 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Gjetjet kryesore

Figura 15.1. Rezultati (Pikët) e Kosovës për Aktin e Biznesit të Vogël për Kosovën (2016 dhe 2019)



Shënim: Një krahasim i drejtpërdrejtë i pikëve në mes të vlerësimeve 2016 dhe 2019 për Dimensionin 1 (Të mësuarit sipërmarrës dhe ndërmarrësia e grave) dhe Dimensionin 8a (Shkathtësitë e ndërmarrjeve) duhet të trajtohen me kujdes, pasi metodologjia e vlerësimit ka ndryshuar dukshëm. Shihni kapitullin e Kornizës së Politikave dhe Procesit të Vlerësimit dhe Shtojcën A për informata mbi metodologjinë e vlerësimit.

Kosova ka bërë përparim të mirë në zbatimin e Aktit të Biznesit të Vogël që nga publikimi i raportit të mëparshëm - *Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2016* (Figura 15.1). Kornizat e politikave dhe mekanizmat qeverisës, të krijuara me ngut në fillim të viteve 2000, janë forcuar ndjeshëm dhe një numër i rregulloreve janë përshtatur me ato të BE-së. E gjithë kjo ka rezultuar me kushte më të mira rregullative që i afrohen më shumë krijimit të kushteve të barabarta për NVM-të dhe për zhvillimin e ndërmarrësisë. Arritjet kryesore që kanë ndihmuar Kosovën për të përmirësuar performancën e saj në këtë vlerësim mund të përmblihen si më poshtë:

Barrierat rregullative ndaj ndërmarrësisë vazhdojnë të bien ndjeshëm. Themelimi i zyrave për shërbime në një vend (*one stop shop*) në kuadër të Agjencisë të Regjistrimit të Bizneseve Kosovare ishte një moment historik në reduktimin e burokracisë dhe uljen e pengesave të hyrjes për sipërmarrësit kosovarë. Koha e regjistrimit të kompanisë është zvogëluar me gati 50% brenda tri viteve në 5.5 ditë në vitin 2018 dhe numri i procedurave të nevojshme për fillimin e një biznesi është ulur në tre - më e ulëta për ekonomitë e vlerësuara.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) po rrit ndjeshëm kërkesën për kredi në mesin e NVM-ve. Që nga themelimi i tij në vitin 2016, FKGK-ja ka zhvilluar tashmë një portfolio prej rreth 1 550 kredish, që arrijnë shumën e përgjithshme prej 59 milionë eurosh. Duke bashkëpunuar edhe me institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare - megjithëse aktualisht në nivele të ulëta - fondi ka potencial për të përmirësuar qëndrueshmërinë ekonomike të këtyre institucioneve dhe përfundimisht për të lehtësuar qasjen e mikro ndërmarrjeve në kredi.

Korniza institucionale është bërë e favorshme për nxitjen e inovacionit në ndërmarrje. Themelimi i Ministrisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi në vitin 2017 ka shërbyer si bazë për kornizën institucionale për përfshirjen e inovacionit në hartimin e politikave. Edhe pse portfolioja e saj operationale është ende e ngushtë, ministria tani ka burime të rëndësishme për nxjerrjen e instrumenteve të reja për nxitjen e inovacionit dhe krijimin e qendrave të inovacionit në të gjithë vendin.

Korniza ligjore për procedurat e paaftësisë paguese (insolvensës) është më e fuqishme. Ligjet e reja mbi falimentimin dhe organizatat e biznesit, të miratuara në vitin 2016 dhe 2018, tani përfshijnë shumë karakteristika që ishin lënë jashtë nga legjislacioni i mëparshëm, duke hedhur bazat për procedura efikase të paaftësisë paguese. Procedurat që përfshijnë NVM-të debitorë trajtohen tani si raste të riorganizimit të cilat kërkojnë që të emërohet një “monitorues” për të ndihmuar NVM-të në planet e tyre të riorganizimit.

NVM-të kanë qasje të lehtë në tregun e prokurimit publik. Falë një kornize të qëndrueshme institucionale dhe rregullative, janë zbatuar një sërë zgjidhjesh që në aspektin teorik e lehtësojnë qasjen e NVM-ve në prokurimin publik. Kërkesat e dokumentacionit janë racionalizuar më tej dhe është përcaktuar një kufi mbi qarkullimin e kërkuar për të marrë pjesë në procedurat e tenderimit. Sidoqoftë, mbetet të shihet se deri në ç’masë do të ndikohet nga këto përmirësime përqindja e NVM-ve në vlerën totale të kontratave publike të dhëna.

Fushat prioritare

Përkundër përmirësimeve në mjedisin e biznesit të arritura si rezultat i rregullimit efektiv, janë një numër fushash në të cilat Kosova ende duhet të shtojë përpjekjet e saj. Ky raport identifikon shtatë fusha prioritare ku duhen intensifikuar aktivitetet:

- **Të sigurohet ndarje e burimeve të mjaftueshme për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat.** Fondet e pakta të destinuara për masat e planifikuara në kuadër të strategjive të mëparshme të zhvillimit të sektorit privat nënkuptonin që hendeku zakonisht mbushej nga iniciativat e financuara nga donatorët. Megjithëse kjo nuk është një gjë e keqe në vetvete, pritshmëria e heshtur se do të ketë ndihmë nga fondet e donatorëve krijon paqartësi rreth zbatimit dhe çon në vonesa. Përfshirja e tepruar e donatorëve të ndryshëm gjithashtu mund të zhvendosë llogaridhënien për strategjinë tutje nga qeveria, duke dobësuar prioritetet publike.
- **Përmirësimi i marrjes së shërbimeve të mbështetjes së biznesit nga NVM-të duke riformuluar skemat ekzistuese.** Duke pasur parasysh numrin e ulët të aplikacioneve nga NVM-të, Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA) duhet të shqyrtojë ridizajnimin e procedurave të saj të aplikimit dhe të bashkëfinancimit për shërbimet e saj mbështetëse. Ajo mund të fillojë këtë duke përshtatur mbështetjen e saj bashkëfinancuese me madhësinë e ndërmarrjeve. Për më tepër, ajo mund të rishqyrtojë praktikën e rimbursimit të përfituesve vetëm pas përfundimit të projekteve pasi kjo mund të shtyjë ndërmarrjet mikro dhe të vogla me burime të pakta që të mos aplikojnë fare.
- **Përmirësimi i qasjes së NVM-ve në financa përmes rritjes së FKGK dhe ndërmarrjes së reformave legislative për të zgjeruar gamën e instrumenteve financiare alternative.** Rritja e mëtejme e FKGK-së dhe rishikimi i performancës së tij të përgjithshme - duke përfshirë atraktivitetin e tij për bankat - do të përmirësonte peizazhin e financimit të jashtëm për NVM-të. Për më tepër, zbatimi i ligjit të planifikuar të faktoringut do të përmirësonte transparencën dhe zbatueshmërinë ligjore të shërbimeve të faktoringut dhe do të ishte instrumental në përmirësimin e menaxhimit të rrjedhës së parasë të NVM-ve.
 - **Zhvillimi i kornizës ligjore dhe infrastrukturës së nevojshme për nxitjen e tregtisë elektronike (e-commerce).** Një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për të mbështetur përdorimin e rregulluar të tregtisë elektronike mbetet ende për t'u zhvilluar. Pagesat elektronike ndërkombëtare nuk mund të bëhen në mënyrë efektive për shkak të qasjes së kufizuar të NVM-ve tek ofruesit e shërbimeve të pagesave elektronike të palëve të treta të lidhur me bankat kosovare.
 - **Përqendrimi në ofrimin e udhëzimeve për NVM-të në miratimin e praktikave të shëndosha mjedisore.** NVM-të duhet të nxiten për të miratuar masa të efijencës së burimeve. Për të arritur këtë, duhet të përgatiten aktivitete që rrisin ndërgjegjësimin e NVM-ve për faktin se efijencia e burimeve ofron kthime të larta për investime me kosto të ulët. Një agjenci publike relevante si KIESA ose Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) mund t'u japin këshilla të drejtpërdrejta NVM-ve lidhur me kursimin e shpenzimeve të energjisë, materialeve dhe ujit.
 - **Shtimi i përpjekjeve për të rritur ndërmarrësinë e grave.** Mbi 80% e grave kosovare nuk marrin pjesë në tregun e punës, dhe më pak se 10% e bizneseve të ekonomisë janë në pronësi të grave. Nevojiten politika të përshtatura dhe masa të shënjestruara për të adresuar sfidat e përjetuara nga gratë sipërmarrëse, veçanërisht në lidhje me pronësinë e aseteve, qasjen në financa, aftësitë dhe rrjetet e ndërmarrësisë. Krijimi i një mekanizmi ndër-ministor të koordinimit mund të jetë hapi i parë drejt çlirimit të kontributeve potenciale të grave për ekonominë.
 - **Rritja e ndërgjegjësimit të NVM-ve mbi standardet e miratuara rishtazi të BE-së.** Me 650 standarde të BE-së të miratuara vetëm në vitin 2017, NVM-të në Kosovë kanë vështirësi që të jenë në hap me standardet e reja që duhet të përmbushin.

Organizimi i punëtorive dhe përgatitja e materialeve informuese mbi standardet e reja dhe aplikimin e tyre duhet të jetë prioritet për Agjencinë Kosovare të Standardizimit. Sidoqoftë, shtrirja e agjencisë së pari duhet të rritet përmes alokimit të më shumë burimeve njerëzore dhe financiare.

Konteksti ekonomik dhe roli i NVM-ve

Pasqyra ekonomike

Kosova është një ekonomi me të ardhura të ulëta-të mesme dhe një nga katër ekonomitë e vetme në Evropë që kanë shënuar rritje çdo vit që nga fillimi i krizës globale financiare në vitin 2008. Me një popullsi prej 1.8 milionë banorësh, Kosova është ekonomia e dytë më e vogël në Ballkanin Perëndimor pas Malit të Zi.

Ekonomia kosovare ka pasur një rritje të qëndrueshme në vitet e fundit (Tabela 15.1). Rritja reale e bruto produktit vendor (BPV) shënoi një mesatare prej rreth 3.2% në vit¹ gjatë periudhës 2013-17: një performancë e konsiderueshme krahasuar me ekonomitë e tjera në rajon (KE, 2018^[1]). Pavarësisht nga normat pozitive të rritjes, megjithatë, Kosova ishte ende ekonomia e dytë më e varfër në Evropë në vitin 2017, pas Moldavisë, me një BPV mesatare për kokë banori prej 3 894 dollarësh.

Tabela 15.1. Kosova: Indikatorët kryesorë makro-ekonomikë (2013-18)

| Indikatori | Njësia matëse | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|--|-------|------|------|------|------|--------|
| Rritja e BPV-së ¹ | % vit pas viti | 3.4 | 1.2 | 4.1 | 3.4 | 4.2 | 3.8** |
| Inflacioni ¹ | % mesatare | 1.8 | 0.4 | -0.5 | 0.3 | 1.5 | 0.3** |
| Bilanci qeveritar ¹ | % e BPV-së | -3.1 | -2.2 | -2.0 | -1.2 | -0.8 | .. |
| Bilanci i llogarisë rrjedhëse ¹ | % e BPV-së | -3.4 | -6.9 | -8.6 | -8.3 | -6.0 | -6.5** |
| Eksporti i mallrave dhe shërbimeve ¹ | % e BPV-së | 21.9 | 22.5 | 21.9 | 22.2 | 27.0 | 27.5** |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve ¹ | % e BPV-së | 49.6 | 51.2 | 50.4 | 50.8 | 53.8 | 54.8** |
| IHD-të neto ¹ | % e BPV-së | 5.3 | 2.7 | 5.3 | 3.6 | 4.5 | 3.7** |
| Borxhi i jashtëm ² | % e BPV-së | 30.2 | 31.2 | 33.3 | 33.2 | 32.6 | .. |
| Rezervat ndërkombëtare bruto ¹ | Raporti i importit 12 mujor të mallrave Mesatarja lëvizëse | 7.4 | 6.0 | 5.9 | 5.0 | 4.9 | 4.9** |
| Papunësia ¹ | % e gjithsej popullsisë aktive | 30.00 | 35.3 | 32.9 | 27.5 | 30.5 | 27.9** |
| BPV-ja kombëtare ³ | Miliardë euro | 5.3 | 5.6 | 5.8 | 6.1 | 6.4 | .. |

Shënim: *projektim; **mesatarja e tremujorit të parë dhe të dytë.

Burimet: ¹KE (2018^[2]), “Raporti tremujor ekonomik i vendeve candidate dhe kandidatëve potencialë të BE-së (CCEQ): tremujori i 3-të 2018”, https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/economy-finance/tp028_en.pdf;

²BERZH (2018^[3]), *Raporti i tranzicionit 2018-2019: Puna në tranzicion*, <https://2018.tr-ebrd.com/countries/#/>;

³Eurostat (2018^[4]), *Eurostat (baza e të dhënave)*, <https://ec.europa.eu/eurostat/web/national->

[accounts/data/database.](#)

Sektorët e patregtueshëm dominojnë prodhimin dhe punësimin në Kosovë. Shërbimet janë sektori më i madh në ekonomi, me një pjesë të vlerës së shtuar prej 54% të BPV-së gjatë viteve 2009-17. Industria është e vogël sipas standardeve rajonale, me 16.8% të BPV-së, ku prodhimi përbën rreth 10%. Sektori i bujqësisë mbetet relativisht i madh, me 11% të BPV-së (Banka Botërore, 2016^[5]).

Ekonomia karakterizohet nga një integrim i kufizuar rajonal dhe global ekonomik dhe një varësi e madhe në remitencat nga diaspora kosovare. Në fakt, remitencat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë familje dhe përbënin 12% të BPV-së në vitin 2017 (KE, 2018^[6]). Megjithatë, konsumi privat mbetet nxitësi kryesor i rritjes (KE, 2018^[11]). Megjithatë, ndonëse hyrjet e remitencave mbeten vendimtare për kompensimin e deficitit tregtar të Kosovës në mallra dhe shërbime (KE, 2018^[7]), ato rrallë orientohen në investime dhe potencialisht dekurajojnë pjesëmarrjen në tregun e punës (UNDP, 2016^[8]).

Pavarësisht se është ndër ekonomitë më të hapura për investimet e huaja direkte (IHD) sipas Indeksit të Kufizimit Rregullativ të IHD-së të OECD-së, hyrjet e IHD-ve mbeten të kufizuara, mesatarisht 4.2% të BPV-së gjatë periudhës 2013-17 dhe kryesisht kanë origjinën nga diaspora e madhe e Kosovës (OECD, 2017^[9], OECD, 2018^[10]). Shpërndarja sektoriale e IHD-ve vazhdon të mbizotërohet nga sektorët jo-produktivë, përkatësisht sektori i patundshmërive dhe ai i ndërtimitarisë (KE, 2018^[6], OECD, 2018^[10]), gjë që ka ndikim të kufizuar pozitiv në efikasitetin e firmave kosovare. E thënë ndryshe, përbërja e tanishme e IHD-ve nuk lejon efekte të rëndësishme të përhapjes.

Ndërsa eksportet e mallrave dhe shërbimeve përfaqësonin vetëm 26.5% të BPV-së në vitin 2017, Kosova mbështetet në masë të madhe në importe, të cilat përbënin 53.8% të BPV-së në vitin 2017 (KE, 2018^[11]). Këto pritet të rriten më tej për shkak të projekteve të mëdha të infrastrukturës. Përveç që është shumë e varur nga inputet e importuara për prodhimin industrial, Kosova është gjithashtu një nga importuesit më të mëdhenj për kokë banori të ushqimit në Evropë. Ndërkohë, shporta e saj e eksportit është ndër më pak të larmishmet në rajon, duke u mbështetur kryesisht në mallrat me vlerë të ulët të shtuar, të tilla si metalet, mineralet dhe lëndët e tjera të papërpunuara (EC, 2018^[11]). Kombinuar me konsumin e lartë, eksportet e ulëta japin një bilanc negativ të llogarisë rrjedhëse për ekonominë. Me shërbimet që janë sektori eksportues me rritjen më të shpejtë - duke kontribuar me 57.3% të vlerës së shtuar bruto në vitin 2017 - këto po ndihmojnë në reduktimin e hendekut të konsiderueshëm nga tregtia e mallrave dhe zbutjen e disbalanceve të jashtme. Për shembull, deficitin e llogarisë rrjedhëse ka rënë nga 9.1% në 2016 në 5.9% në vitin 2017 (KE, 2018^[11], KE, 2018^[7]). Megjithatë, deficitin tregtar mbetet i lartë përkundër rritjes së fuqishme të eksporteve, duke reflektuar bazën e dobët të prodhimit të ekonomisë (KE, 2018^[7]). Ndërsa BE-ja është destinacioni i 23% të eksporteve të Kosovës, ajo përbën rreth 42% të importeve të Kosovës (Sanfey dhe Milatovic, 2018^[11]) dhe mbetet partneri më i madh tregtar i ekonomisë, që përfaqëson 41% të tregtisë së përgjithshme në vitin 2017 (KE, 2018^[7]).

Me miratimin e euros në mënyrë të njëanshme dhe si një ekonomi e vogël dukshëm e varur nga importet, Kosova është tejet e ndjeshme ndaj zhvillimeve të çmimeve në partnerët kryesorë tregtarë. Ajo është gjithashtu e ndjeshme ndaj luhatjeve në çmimet globale të mallrave, veçanërisht të ushqimit dhe energjisë. Në të vërtetë, rritja e çmimeve të ushqimeve dhe karburantit në vitin 2017 e shtyri inflacionin deri në 1.5%, krahasuar me 0.3% në vitin 2016 dhe -0.5% në vitin 2015. Megjithatë, Kosova aktualisht gëzon stabilitet të konsiderueshëm të çmimeve falë inflacionit të vazhdueshëm të ulët në eurozonë, rënies në çmimet globale të mallrave dhe një kursi këmbimi që është i paluajjtshëm në raport me euron. Duke pasur parasysh përshpejtimin e parashikuar të rritjes së BPV-së dhe parashikimet e inflacionit më të lartë për vendet anëtare të BE-së dhe ekonomitë e tjera në rajon, pritja e qeverisë për inflacion të ulët (mesatarisht 1.2% midis 2018 dhe 2020) mund të jetë një nënvlerësim (KE, 2018^[11]).

Në mungesë të mjeteve të politikës monetare, politika fiskale mbetet instrument kryesor i politikës makroekonomike të Kosovës. Në përpjekjet për të reduktuar deficitin e saj fiskal, Kosova ka konsoliduar kornizën e saj fiskale të bazuar në rregulla dhe ka rregulluar rregullin e saj të deficitit (2% të BPV-së) dhe tavanin e borxhit (40% të BPV-së). Përkundër mangësisë në zbatimin e disa reformave të rëndësishme dhe sfidave të paraqitura nga skemat e kushtueshme të përfitimeve të veteranëve të luftës, rritja e fortë ekonomike dhe arkëtimi i përmirësuar i të ardhurave kanë sjellë rritje të të ardhurave prej 9.4% në vitin 2016 dhe 5.3%

në vitin 2017 (KE, 2018_[6]). Në vitin 2017, deficiti fiskal ishte 1.4% dhe niveli i borxhit të përgjithshëm publik ishte 16.8% e BPV-së. Megjithatë relativisht i vogël, ky i fundit ka qenë në rritje dhe parashikohet të arrijë në 21% të BPV-së deri në vitin 2020 (KE, 2018_[11]). Nga ana tjetër, zvogëlimi i madhësisë së sektorit joformal dhe luftimi i korrupsionit mbeten prioritetet kyçe të politikave pasi ato vazhdojnë të shkaktojnë humbje të konsiderueshme fiskale.

I dominuar nga sektori bankar, sektori financiar i Kosovës është i qëndrueshëm, likuid dhe fitimprurës: në vitin 2017, lehtësimi i standardeve të kreditit dhe normat më të ulëta të interesit të kredive u kombinua me kërkesën e fuqishme nga ekonomitë familjare dhe bizneset për të gjeneruar rritje të kreditit prej 11.5%, më e madhja që nga viti 2011 (KE, 2018_[11]). Megjithatë, sektori bankar i Kosovës në pronësi të huaj me 90% mbetet i nënshfrytëzuar, kryesisht për shkak të kredidhënies hipotekare të dobët dhe joformalitetit shumë të përhapur (Sanfey dhe Milatovic, 2018_[11], KE, 2018_[11]). Veçanërisht, krahasuar me ekonomitë e tjera të Ballkanit Perëndimor me nivele të vazhdueshme të larta të kredive joperformuese (KJP), Kosova ka mbajtur NPL-të në normën jashtëzakonisht të ulët prej 3.1%.

Pavarësisht rritjes së qëndrueshme në vitet e fundit, Kosova ka normën më të lartë të papunësisë (32.9%) dhe normën më të ulët të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (37.8%), jo vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi (BPT)², por edhe duke mbetur prapa mesatareve të BE-së (66.8%) dhe OECD-së (67%) (KE, 2018_[7], KE, 2018_[11]). Gratë, të rinjtë dhe punëtorët e pakualifikuar janë veçanërisht të prekur, por problemet strukturore në tregun e punës janë të përhapura për të gjithë popullsinë kosovare.

Sipas të dhënave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, norma e punësimit në vitin 2016 ishte 43% për burrat dhe vetëm 12.7% për gratë (ILO, 2018_[12]). Kosova ka gjithashtu një normë shumë të lartë të papunësisë së të rinjve (15-24 vjeç). Ajo arriti një normë rekorde prej 61% në 2014, por kjo ra në 52.4% në vitin 2016. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të të rinjve për burrat është 28.8% krahasuar me 12.7% për gratë. Problemi i theksuar i papunësisë së të rinjve dhe niveli i lartë i papunësisë në mesin e mbajtësve të diplomave universitare zbulojnë mospërputhjen në mes të rezultateve të sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës, duke kërkuar politika më aktive të tregut të punës (KE, 2018_[6]). Në përgjithësi, tregu kosovar i punës shfaqë një kërkesë të lartë për kualifikime teknike, por sistemi i arsimit dhe aftësimin profesional (AFP) nuk arrin të ofrojë këto në sasi dhe cilësi të mjaftueshme (KE, 2018_[11]). Akoma duhet të bëhet progres në adresimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës.

Përmirësimi i sistemit arsimor është një sfidë kryesore e politikave për ekonominë, pasi qasja në arsim cilësor mbetet problematike në të gjitha nivelet (UNDP, 2016_[8]). Ekziston gjithashtu një hendek i konsiderueshëm gjinor në arsim, veçanërisht në vijimin e arsimit të lartë (KE, 2018_[7]). Përveç kësaj, Kosova është performuesi më i keq në mesin e ekonomive të BPT-së në Programin e fundit (2015) për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) (OECD, 2017_[13]).

Trendet e mjedisit të biznesit

Mjedisi i biznesit në Kosovë është përmirësuar që nga vlerësimi i fundit, kryesisht për shkak të thjeshtimit të procedurave të regjistrimit të biznesit dhe përmirësimit të kornizës ligjore, e cila ka forcuar të drejtat ligjore të huamarrësve dhe huadhënësve. Përveç kësaj, ligji i ri për investimet strategjike - i projektuar për të thjeshtuar procesin e investimeve për investitorët dhe për të rritur IHD-të - ka ndihmuar në uljen e burokracisë dhe rritjen e transparencës.

Kosova konsiderohet se qëndron më mirë se ekonomitë e tjera në rajon kur është fjala për ndërmarrjet shtetërore (NSH). Kjo është kryesisht për shkak se qeveria i nënshtron pjesë të sektorit të NSH-ve ligjeve specifike, të cilat imponojnë kërkesa shtesë për raportim. Kosova ka miratuar reforma të rëndësishme, veçanërisht në kodin e saj të qeverisjes korporative për NSH-të dhe ka formuar një komision ndërministror të rekomandimeve për të shmangur politizimin e nominimeve të anëtarëve të bordit (OECD, 2018_[10]).

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, mjedisi i biznesit në Kosovë vazhdon të pengohet nga një sërë sfidash të rëndësishme, duke përfshirë korrupsionin, ekonominë joformale dhe furnizimin jo të besueshëm me energji, siç është identifikuar në Programin e Reformave Ekonomike të Kosovës 2017-19 (Kutia 13.1). Lufta kundër korrupsionit ka qenë një ndër prioritetet e bashkësisë ndërkombëtare dhe, së fundmi, edhe e qeverisë kosovare. Progresi i

bërë drejt “shmangies së korrupsionit” në legjislacion (vlerësimi anti-korrupsion të legjislacionit) (“corruption-proofing”) mbetet i dobët. Si rezultat, në vitin 2018, Kosova u rendit e 93-ta ndër 180 ekonomitë në *Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit* të Transparency International - pozita e tretë më e keqe në rajonin e BPT (OECD, 2018_[10], Transparency International, 2018_[14]).

Kutia 15.1. Programi i Reformave Ekonomike të BE-së

Që nga viti 2015, të gjitha vendet candidate të BE-së dhe kandidatët potencialë janë të detyruar të përgatisin Programet e Reformave Ekonomike (PRE). PRE-të përgatisin vendet e zgjerimit për pjesëmarrjen e tyre në të ardhmen në procedurat e koordinimit të politikave ekonomike të BE-së. Ato gjithashtu luajnë një rol kyç në përmirësimin e planifikimit të politikave ekonomike dhe drejtimin e reformave për të mbështetur stabilitetin makroekonomik, rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e kushteve për rritje gjithëpërfshirëse dhe krijimin e vendeve të punës.

PRE-të përmbajnë projeksionet makroekonomike afatmesme (duke përfshirë për rritjen e BPV-së, inflacionin, bilancin tregtar dhe flukset e kapitalit), planet buxhetore për tre vitet e ardhshme dhe një agjendë reformash strukturore. Agjenda e reformës strukturore përfshin reforma për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të përmirësuar kushtet për rritje gjithëpërfshirëse dhe krijimin e vendeve të punës, në fushat e mëposhtme:

- menaxhimi i financave publike
- tregjet e energjisë dhe transportit
- zhvillimi sektorial
- mjedisi i biznesit dhe reduktimi i ekonomisë joformale
- reforma lidhur me tregtinë
- arsimimi dhe shkathtësitë
- punësimi dhe tregjet e punës
- përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta.

Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane pastaj i vlerësojnë këto shtatë programe. Kjo përbën bazën për një dialog shumëpalësh të politikës ekonomike që përfshin vendet e zgjerimit, shtetet anëtare të BE-së, Komisionin dhe Bankën Qendrore Evropiane. Dialogu kulminon në një takim të nivelit të lartë gjatë të cilit pjesëmarrësit miratojnë konkluzione të përbashkëta që përfshijnë udhëzime politike specifike për vendin që pasqyrojnë nevojat më të ngutshme të reformës ekonomike.

Gjetjet e vlerësimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë ofrojnë sfondin analitik dhe udhëzime për shtatë vendet candidate për në BE dhe kandidatët potencialë në identifikimin e pengesave kryesore ndaj konkurrencës dhe rritjes ekonomike dhe në zhvillimin e masave të reformës strukturore për t'i kapërcyer ato.

Burimi: KE (2018_[15]), Programet e Reformave Ekonomike: Ballkani Perëndimor dhe Turqia, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-erp-factsheet.pdf>.

Ekonomia joformale e Kosovës vlerësohet se përbën 31% të BPV-së së saj. Joformaliteti i përhapur çon në një konkurrencë të pandershme, duke penguar qasjen në financa dhe aftësinë e bizneseve të regjistruara për t'u rritur dhe inovuar (KE, 2018_[7]) Për më tepër, ai redukton pagat dhe fuqinë blerëse, tkurrë bazën tatimore të ekonomisë dhe në mënyrë përfundimtare buxhetin e shtetit.

Një pengesë tjetër për konkurrueshmërinë e Kosovës është furnizimi i pamjaftueshëm dhe jo i besueshëm i energjisë. Firmat kosovare përballen me ndërprerjet më të shpeshta të energjisë në rajon dhe ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësimin e efikasitetit të energjisë (KE, 2018_[7]). Bizneset kosovare pësojnë kosto shtesë prej rreth 296 milionë euro në vit për shkak të furnizimeve të parregullta të energjisë (USAID, 2015_[16]). Për të trajtuar këtë çështje, qeveria ka njoftuar ndërtimin e një centrali të ri prej 500 MË deri në vitin 2023, që synon forcimin e rritjes në periudhën afatmesme dhe mbështetjen e mjedisit të biznesit duke minimizuar shkurtime të energjisë elektrike. Megjithatë, një kapacitet i vjetër i prodhimit, një treg jo i liberalizuar i energjisë dhe një sistem tarifor që nuk reflekton kostot reale mbeten çështje të rëndësishme, ndër të tjera, në sektorin energjetik të Kosovës (KE, 2018_[11]).

Marrë në përgjithësi, Kosova është ndër dhjetë ekonomitë më të mëdha që tregojnë progresin më të madh në *Raportin e të Bërit Biznes* 2018 të Bankës Botërore, duke lëvizur për 35 vende më lartë që nga viti 2015 dhe duke e renditur e 40-ta nga 190 ekonomitë (Banka Botërore, 2017_[17]). Reformat që e bëjnë më të lehtë të bërit biznes janë paraqitur në Tabelën

15.2.

Tabela 15.2. Reformat e fundit biznesore në Kosovë

| | Reformat që e lehtësojnë të bërit biznes | Reformat që e vështirësojnë të bërit biznes |
|-----------------------------|---|---|
| Të bërit biznes 2019 | Marrja e lejeve të ndërtimit është lehtësuar me anë të racionalizimit të sistemit të inspektimit përmes përdorimit të inxhinierit të brendshëm. Pagesa e taksave gjithashtu është lehtësuar duke u lejuar taksapaguesve të kërkojnë kthim të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) me anë të formularit standard të kthimit të TVSH-së, duke racionalizuar procesin e auditimit të TVSH-së dhe duke hequr kërkesën për raportimin e blerjeve mbi 500 euro. Eksporti është lehtësuar duke racionalizuar zhdoganimin në kufi. | Asnjë |
| Të bërit biznes 2018 | Hapja e biznesit të ri është lehtësuar duke thjeshtuar procesin e regjistrimit të të punësuarve. Qasja në kredi është fuqizuar duke miratuar një ligj të ri që përcakton rregulla të qarta prioriteti brenda falimentimit për kreditorët e siguruar dhe bazave për lirim nga pezullimi (moratoriumi) për kreditorët e siguruar në procedurat e riorganizimit. Kosova gjithashtu ka lehtësuar zgjidhjen e paaftësisë paguese duke futur në zbatim kornizën ligjore për paaftësinë paguese të korporatave, duke vënë procedurat e likuidimit dhe riorganizimit në dispozicion të debitorëve dhe kreditorëve. | Asnjë |
| Të bërit biznes 2017 | Kosova thjeshtoi pagesën e taksave duke futur në zbatim një sistem online për dorëzimin dhe pagesën e TVSH-së dhe të kontributeve të sigurimit social, si dhe duke bërë tatimet më pak të kushtueshme duke lejuar që më shumë shpenzime të zbriten nga llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatave. Gjithashtu, është lehtësuar tregtia ndërkufitare duke përmirësuar sistemin automatik të menaxhimit të të dhënave doganore, duke përshtatur proceset e zhdogimit dhe duke zbatuar Korridorin Tranzit Shqipëri-Kosovë | |

Shënim: Janë marrë parasysh vetëm reformat me ndikim pozitiv ose negativ mbi të bërit biznes. Burimi: Banka Botërore (2018^[18]), Të Bërit Biznes 2019: Trajnimi për Reforma, www.worldbank.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB2019-report_web-version.pdf

Procesi i Anëtarësimit në BE

Kosova është kandidatë potenciale për BE që nga viti 2008 dhe bashkëpunimi midis BE dhe Kosovës është rritur me hapa të shpejtë pas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (SAA), e cila hyri në fuqi muajin prill të vitit 2016. Kjo ofron një kornizë gjithëpërfshirëse për dialog më të ngushtë politik ndërmjet BE-së dhe Kosovës si dhe krijon një zonë të tregtisë së lirë. Më pastaj, qeveria miratoi Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, i cili aktualisht është dokumenti kryesor politik i vendit për anëtarësim në BE. Ky program përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të të gjitha reformave të kërkuara për të përbushur detyrimet që dalin nga MSA, përkatësisht masat dhe prioritetet e nevojshme për përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së (Ministria e Integritimit Evropian, 2017^[19]).

Në muajin nëntor të vitit 2016, Kosova gjithashtu miratoi Agjendën për Reforma Evropiane, me anë të së cilës u përcaktuan prioritetet deri në fund të vitit 2017. Qëllimi kryesor i agjendës është prioritetizimi i fushave specifike në kuadër të MSA-së, si qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, me qëllim të ngritjes së nivelit të zbatimit të aktivitetëve që i përbushin ato.

Çdo vit, BE-ja dhe autoritetet kosovare takohen për të diskutuar mbi një mori çështjesh të politikave dhe për tu dakorduar mbi veprimet pasuese. Raportet e progresit vlerësojnë gatishmërinë e Kosovës për t'u afruar më pranë BE-së. Gjetjet dhe rekomandimet e publikuara në *Indeksin e Politikave të NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia* ofrojnë monitorimin dhe udhëzimet e nevojshme për të ndihmuar Kosovën në përbushjen e kërkesave lidhur me statusin e tyre të mundshëm të kandidatit sipas seksionit “Ndërmarrja dhe politika industriale” në raportin e progresit.

Sipas raportit të fundit të progresit, të publikuar në muajin prill të vitit 2018, Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e ndërmarrjes dhe politikës industriale (EC, 2018^[7]). Ajo ka shënuar progres me futjen e masave për përmirësimin e mjedisit të biznesit. Megjithatë, ende ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve administrative dhe sigurimin e koordinimit më të mirë ndër-ministral. Kosovës iu rekomanduan veprimet e mëposhtme:

- futja e vlerësimeve të ndikimit rregullator me qëllim të zvogëlimit të barrës administrative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
- vazhdimi i implementimit të rekomandimeve të përfshira në vlerësimin e ABV
- sigurimi i harmonizimit të Ligjit për Zonat Ekonomike me *Acquis* të BE-së.

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) vepron si Koordinator i ABV përgjegjës për zbatimin e parimeve të ABV. Në muajin janar të vitit 2017, u krijua Grupi Kombëtar i Koordinimit të ABV, i përbërë nga 12 grupe punuese. Secili prej këtyre grupeve punuese ishte përgjegjës për ndërmarrjen e një dimensionit të ndryshëm të politikave sipas vlerësimit të ABV, të udhëhequr nga OECD. Edhe pse disa nga këto grupe nuk ishin funksionale në kohën e përgatitjes së këtij dokumenti, ky zhvillim thekson rëndësinë e dhënë vlerësimit të ABV në Kosovë në nivel politik.

Për më tepër, qeveria e re, e emëruar në shtator të vitit 2017, është zotuar për zbatimin e reformave të lidhura me BE-në. Në këtë kontekst, Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018. Kjo paraqet një arritje të rëndësishme dhe përbush një nga kriteret kryesore për liberalizimin e vizave për Kosovën (EC, 2018^[7]).

Në shkurt të vitit 2018 u vërejt një rifreskim i ritmit për anëtarësim në BE tek vendet e Ballkanit Perëndimor pas deklaratës së Komisionit Evropian që kërkonte “perspektivë të besueshme të zgjerimit për angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor” (EC, 2018^[20]). KE lansoi strategjinë e saj të re të anëtarësimit për Ballkanin Perëndimor e cila

paraqet në detaje gjashtë iniciativa kryesore të reformave duke përfshirë adresimin e çështjeve kyçe lidhur me sundimin e ligjit, sigurinë dhe migracionin, rritjen e lidhjes dhe marrëdhëniet fqinjësore. Ato gjithashtu inkorporojnë elemente të rëndësishme që mbështesin politikat e NVM-ve dhe përgatitshmërinë në lidhje me Kapitullin 20 (Ndërmarrja dhe Politika Industriale) në *acquis*, përkatësisht: zhvillimin socio-ekonomik dhe agjenda digjitale.

Mbështetja financiare e BE-së

Bashkimi Evropian - si vendet anëtare ashtu edhe institucionet e tij, veçanërisht Komisioni Evropian - kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës. Kosova ka pranuar më shumë se EUR 2.3 miliardë ndihmë nga BE që prej vitit 1999 dhe afër EUR 1 miliard si mbështetje për praninë ndërkombëtare që nga viti 1999 (Komisioni Evropian, 2016^[21]). BE është dukshëm donatori më i madh që ofron asistencë për Kosovën dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe gjendet në krye të përpjekjeve për rindërtim.

Përveç fondeve të asistencës së BE-së, Kosovës i janë dhënë EUR 149 milionë në formë të kredive nga Banka Evropiane e Investimeve që nga viti 1999 dhe EUR 95.7 milionë të tjera në formë të granteve të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor që nga viti 2009, duke leverazhuar investime të vlerësuara në EUR 764 milionë (EC, 2018^[22]).

Në muajin dhjetor të vitit 2017 u nënshkrua një marrëveshje për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e BE-së të Konkurrueshmërisë së Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME). Kosova do të ketë qasje në financimin e COSME pas përfundimit të procedurave të brendshme për miratimin e marrëveshjes. Kosova duhet të fillojë zhvillimin e masave për ngritjen e ndërgjegjësimit midis akterëve të biznesit dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tyre aktive në program.

NVM-të në ekonominë kombëtare

Klasifikimi i Kosovës për NVM-të përcaktohet me ligjin për investimet e huaja, i cili hyri në fuqi në vitin 2014. Kriteri i vetëm është madhësia e punësimit, e cila është në përputhje me përkufizimin e BE-së (Tabela 15.3).

Tabela 15.3. Përkufizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë

| | Përkufizimi i BE-së | Përkufizimi i Kosovës |
|----------|---|-----------------------|
| Mikro | < 10 punonjës, qarkullimi ose totali i bilancit ≤ EUR 2 m | < 10 punonjës |
| Të Vogla | < 50 punonjës, qarkullimi ose totali i bilancit ≤ EUR 10 m | < 50 punonjës |
| Të Mesme | < 250 punonjës, qarkullimi ose totali i bilancit ≤ EUR 43 m | < 250 punonjës |

Shënim: Në Kosovë klasifikimi i NVM-ve përkufizohet me Ligjin Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja. Kategorizimi i NVM-ve bazohet në numrin e të punësuarve (Neni 2, paragrafi 1.21).


Për qëllime që kanë të bëjnë me ligjin mbi falimentimin, NVM përkufizohet si organizatë afariste e cila ka qarkullim vjetor deri në EUR 1 milion ose që ka deri në 25 punonjës. Ky përkufizim zbatohet vetëm në rastet e falimentimit.

Burimi: Republika e Kosovës (2014^[23]), *Ligji Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja*, <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/1916AE1F-48E8-451D-A328-CA350EC4D7D2.pdf>.

Sektori i biznesit në Kosovë përbëhet pothuajse tërësisht nga NVM-të. Në Kosovë janë rreth 38.000 ndërmarrje të regjistruara, prej të cilave 93.1% janë mikro-ndërmarrje, 5.9% janë të vogla dhe 0.9% janë të mesme. Vetëm 0.1% e numrit total të bizneseve klasifikohen si ndërmarrje të mëdha.

NVM-të përbëjnë 76.2% të totalit të punësimit në sektorin e biznesit dhe përbëjnë 81% të totalit të vlerës së shtuar të sektorit të biznesit. Megjithatë, totali prej 13.2% i vlerës së shtuar të krijuar nga mikro ndërmarrjet mbetet shumë i ulët në krahasim me ekonomitë e tjera në rajon. Vlera më e madhe e krijuar vjen nga ndërmarrjet e mesme, të cilat përfaqësojnë më pak se 1% të popullsisë së biznesit, niveli i punësimit të të cilave është një e pesta e totalit të sektorit të biznesit. Nga ana tjetër, kontributi i ndërmarrjeve të mëdha në vlerën e shtuar është në rënie e sipër që nga viti 2013 (Figura 15.2). Sipas të dhënave të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përqindja e NVM-ve në pronësi të grave në Kosovë ka shënuar rënie të lehtë nga 10.54% në vitin 2013 në 10.24% në vitin 2016.


Figura 15.2. Treguesit e demografisë së biznesit në Kosovë (2013 dhe 2016)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018.

StatLink2 <http://dx.doi.org/10.1787/888933937869>

Në Kosovë, NVM-të kryesisht operojnë në sektorin e tregtisë shpërndarëse (44.1%), ndërsa 12.5% veprojnë në sektorin e prodhimit, por me një nivel të ulët të integritit në zinxhirin global të vlerës (EC, 2018 [1]); 7% në sektorin e ndërtimit, vetëm 2.8% në sektorin bujqësor dhe 0.4% në sektorët e minierave dhe gurëthyesve (Figura 15.3). Sa i përket shpërndarjes gjeografike të ndërmarrjeve, rreth një e treta e të gjitha ndërmarrjeve të regjistruara gjenden në Komunën e Prishtinës (Tabela 15.4).

Figura 15.3. Shpërndarja sektoriale e NVM-ve ne Kosove (2016)

Shënim: Klasifikimi i sektorit në përgjithësi ndjek Klasifikimin Statistikor të Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE) Rev.2 klasifikimi i aktiviteteve ekonomike prodhuese me përjashtimet e mëposhtme: “Shërbimet Komunale” përbën shumën e “Furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar” (D) dhe “Ujësjetësi, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e trajtimit” (E); “Tregtia Shpërndarëse” mbulon “Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave” (F); dhe Shërbimet e tjera përbëhet nga (I) Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit, (L) Aktivitetet e patundshmërive, (M) Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, (N) Aktivitetet administrative dhe të shërbimeve mbështetëse si dhe (S) Aktivitete të tjera shërbyese. Për më shumë informacion, shikoni Klasifikimin NACE Rev. 2.

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018.

Tabela 15.4. Numri i kompanive të regjistruara në Kosovë sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe Komunës

| Komuna | Viti | Madhësia e ndërmarrjes, sipas punësimit | | | | Total | Përqindja e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve |
|-----------|------|---|-------|--------|------|--------|--|
| | | 0-9 | 10-49 | 50-249 | 250+ | | |
| Gjakovë | 2013 | 3 275 | 136 | 10 | 0 | 3 421 | 10.02% |
| | 2017 | 3 408 | 162 | 17 | 2 | 3 589 | 9.40% |
| Gjilan | 2013 | 3 397 | 150 | 20 | 0 | 3 567 | 10.45% |
| | 2017 | 3 580 | 233 | 20 | 0 | 3 833 | 10.04% |
| Mitrovicë | 2013 | 2 755 | 96 | 14 | 3 | 2 868 | 8.40% |
| | 2017 | 3 069 | 146 | 23 | 2 | 3 240 | 8.49% |
| Pejë | 2013 | 2 863 | 130 | 29 | 1 | 3 023 | 8.86% |
| | 2017 | 3 189 | 185 | 23 | 2 | 3 399 | 8.90% |
| Prizren | 2013 | 5 310 | 232 | 27 | 5 | 5 574 | 16.33% |
| | 2017 | 5 625 | 317 | 34 | 3 | 5 979 | 15.66% |
| Prishtinë | 2013 | 10 845 | 789 | 166 | 38 | 11 838 | 34.68% |
| | 2017 | 12 605 | 1 111 | 216 | 47 | 13 979 | 36.62% |
| Ferizaj | 2013 | 3 683 | 142 | 20 | 1 | 3 846 | 11.27% |
| | 2017 | 3 898 | 231 | 28 | 1 | 4 158 | 10.89% |
| Kosovë | 2013 | 32 128 | 1 675 | 286 | 48 | 34 137 | 100.00% |
| | 2017 | 35 374 | 2 385 | 361 | 57 | 38 177 | 100.00% |

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018.

Vlerësimi dhe rekomandimet

Procesi

Cikli i vlerësimit të Aktit të Bizneseve të Vogla (ABV) u lansua në Kosovë me një takim fillestar të mbajtur në Prishtinë më datën 12 tetor 2017. Gjatë takimit, ministrive të linjës dhe institucioneve publike iu prezantua korniza e re e vlerësimit (shih kapitullin Korniza e Politikave dhe Procesi i Vlerësimit dhe Shtojcën A për detaje) në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në procesin e mbledhjes së informacionit. Dy dokumentet të cilat përbëjnë kornizë e vlerësimeve - pyetësi dhe tabela e të dhënave statistikore - iu shpjeguan thellësisht pjesëmarrësve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë pyetjeve të shtuara rishtazi dhe indikatorëve të ri.

Pas eventit lansues, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve Kosovare (KIESA) shpërndau pyetësin tek homologët përkatës në ministrinë dhe agjencitë qeveritare dhe dërgoi fletën statistikore në Zyrën Kombëtare të Statistikave të Kosovës. Prej muajit tetor të vitit 2018 deri në muajin janar të vitit 2019, u hartuan të dhënat dhe dokumentacionet e nevojshme, dhe ky proces u ndjek nga plotësimi i pyetësorit. Kësisoj, u caktua një rezultat (pikët) për secilin dimension të politikave, shoqëruar me një arsytim. Pyetësorët e plotësuar dhe të dhënat statistikore iu dërguan ekipit të OECD më 15 janar 2018.

Rishikimi i inputeve nga OECD dhe institucionet partnere vuri në pah nevojën për informacion shtesë mbi të dhënat statistikore. Një gjë e tillë u kërkuar nga KIESA, e cila ktheu fletën e përditësuar statistikore më 27 shkurt 2018.

Ndërkohë, u krye edhe një vlerësim i pavarur nga OECD dhe organizatat e saja partnere. Kjo u bazua në inputet e një ekipi të ekspertëve vendorë në Kosovë, të cilët grumbulluan të dhëna dhe informacione dhe realizuan intervista me akterët kyç publik dhe të shoqërisë civile, si dhe me përfaqësuesit e NVM-ve.

Pas përfundimit të vetëvlerësimit të qeverisë dhe vlerësimit të pavarur, OECD-ja organizoi një takim akordues në Prishtinë më 17 prill 2018. Takimi synoi plotësimin e boshllëqeve të mbetura të informacionit në pyetësor, në të njëjtën kohë duke shërbyer si mundësi për të kërkuar pikëpamjet e një spektri të gjerë të akterëve të politikave mbi atë se si NVM-të ndikohen nga politikat aktuale dhe çfarë tjetër mund të bëhet në fushat e ndryshme të politikave për përmirësimin e performancës dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë. Për dy dimensionet e politikave (të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësia e grave dhe aftësitë ndërmarrëse), vlerësimi i të cilëve u udhëhoq nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), takime të ngjashme u zhvilluan në Prishtinë më 24-25 janar 2018.

Takimi i akordimit bëri të mundur konsolidimin e gjetjeve të vlerësimit. OECD dhe organizatat e saj partnere vendosën mbi rezultatet (pikët) përfundimtare nën çdo dimension të politikave të paraqitura në këtë raport. Gjetjet dhe rezultatet paraprake u paraqitën më pas tek koordinatorët e ABV në një takim të mbajtur në Paris më 14 korrik të vitit 2018. Draft publikimet e Indeksit të Politikave të NVM-ve dhe profili i vlerësimit të ABV të Kosovës janë vënë në dispozicion të Qeverisë së Kosovës për shqyrtimin dhe komentimin mbi to gjatë periudhës Gusht - Tetor 2018.

Qasja e poentimit

Secilit dimension të politikave dhe pjesëve përbërëse të tij i caktohet një rezultat numerik prej 1 deri në 5 në përputhje me nivelin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave, në mënyrë që performanca të krahasohet nëpër ekonomitë dhe me kalimin e kohës. Niveli 1 paraqet rezultatin më të ulët ndërsa niveli 5 rezultatin më të lartë, duke treguar një nivel zhvillimi

në përpjesëtim me praktikat e mira të OECD-së (Tabela 15.5).

Për detaje të mëtejshme mbi metodologjinë e Indeksit të Politikave të NVM-ve dhe mënyrën e llogaritjes së rezultateve, si dhe ndryshimet në ciklin e fundit të vlerësimit, ju lutemi referojuni Shtojcës A.

Tabela 15.5. Përshkrimi i niveleve të rezultateve

| | |
|-----------------|---|
| Niveli 5 | Niveli 4 plus rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit informojnë hartimin dhe zbatimin e kornizës së politikave |
| Niveli 4 | Niveli 3 plus dëshmi për një evidencë konkrete të zbatimit efektiv të politikave. |
| Niveli 3 | Ekziston një kornizë solide e aprovuar zyrtarisht, e cila adreson fushën e politikave në fjalë. |
| Niveli 2 | Ekziston një draft kornizë ose pilot kornizë, me disa shenja të aktivitetit të qeverisë për të adresuar fushën e politikave në fjalë. |
| Niveli 1 | Nuk ka kornizë (p.sh. ligji, institucion) për adresimin e temës së politikave në fjalë. |

Të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësia e grave (Dimensioni 1)

Kosova ka shënuar njëfarë progresi sa i përket implementimit të të mësuarit ndërmarrës dhe ajo po shënon progres të mirë sa i përket zhvillimit të politikave për kompetencat kyçe të ndërmarrësisë. Përkundër kësaj, rezultati i përgjithshëm i saj prej 2.53 (Tabela 15.6) e rendit Kosovën në pozitën më të ulët në rajon për këtë dimension së bashku me Republikën e Maqedonisë Veriore. Një kornizë e dobët e monitorimit dhe vlerësimit për të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësinë e grave ndikon negativisht në performancën e Kosovës në këtë dimension të politikave.

Tabela 15.6. Rezultatet (pikët) për Dimensionin 1: Të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësia e grave

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Bloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT | |
|---|--|------------------------------|-------------|-----------------|-------------|
| Dimensioni 1: Të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësia e grave | Nën-dimensioni 1.1: Të mësuarit ndërmarrës | Planifikimi dhe hartimi | 3.00 | 3.73 | |
| | | Implementimi | 3.59 | 3.61 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 1.00 | 2.57 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.89 | 3.43 | |
| | Nën-dimensioni 1.2: Ndërmarrësia e grave | Planifikimi dhe hartimi | 2.33 | 3.57 | |
| | | Implementimi | 1.86 | 3.16 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 1.80 | 2.37 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 1.99 | 3.12 | |
| | Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 1 | | | 2.53 | 3.31 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kyçe

Të mësuarit ndërmarrës

Në nivel të politikave, zhvillimi ekonomik i Kosovës është i lidhur qartë me kapitalin njerëzor. Plani i Rishikuar Strategjik për Arsimin i Kosovës për 2017-2021 e sheh arsimin si funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të ekonomisë. Nëpërmjet kapitullit mbi zhvillimin e kapitalit njerëzor, strategjia është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021, e udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit. Plani Strategjik i Zhvillimit për Arsimin propozon aktivitete konkrete për të lidhur më mirë arsimin dhe tregun e punës duke lehtësuar qasjen në specializimet e mençura³ në përputhje me strategjinë e Evropës 2020. Megjithatë, Strategjia për Zhvillimin e NVM-ve (2012-16), e përdorur më parë për të drejtuar aktivitetet e donatorëve për mbështetjen e NVM-ve, është bashkuar me Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit Privat që parashikohet të aprovohet në fillim të vitit 2019.

Koordinimi, përafrimi i planeve dhe prioriteteve, dhe monitorimi i tyre në sistemin arsimor mbeten sfiduese. Nuk është shënuar progres në qasjet e qeverisë ndaj bashkëpunimit ndërmjet ministrive mbi të mësuarit ndërmarrës dhe kompetencat kyçe apo përmirësimin e përfshirjes së komunave, institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat, gjë që është esenciale për avancimin e zbatimit të reformës arsimore. Fushat e kompetencave kyçe të të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësisë kanë veçanërisht nevojë për një kornizë të koordinuar të planifikimit dhe monitorimit pasi ato janë të shpërndara nëpër dokumente të shumëfishta të politikave, siç është Plani Strategjik për Arsimin i Kosovës (2017-21), Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjve (2018-2020) dhe Strategjia

Kombëtare e Zhvillimit (2016-2021). Megjithatë, ekzistojnë disa partneritete politike ndërmjet ministrive përkatëse dhe palëve të tjera të interesit për promovimin e arsimit ndërmarrës. Këto përfshijnë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e cila udhëheq Këshillin për Arsim dhe Aftësim Profesional (i themeluar në vitin 2012); dhe Ministrinë e re të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e cila udhëheq Këshillin Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi (i themeluar në muajin nëntor të vitit 2017). Mbledhja e të dhënave mbi zbatimin e të mësuarit ndërmarrës paraqet gjithashtu problem dhe e njëjta ndikon në aftësinë e Kosovës për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimin.

Kosova ka një angazhim politikash ndaj agjendës së arsimit ndërmarrës dhe Ministria e Arsimit ka shënuar progres të mirë në zbatimin e të mësuarit ndërmarrës në arsimin fillor dhe të mesëm si pjesë e një programi mbi ndërmarrësinë dhe teknologjinë. Në kuadër të sistemit të AAP, kompetencat kyçe janë në fazën e hartimit dhe ato do të fokusohen në zhvillimin e shkathtësive të vetë-punësimit duke u mësuar njerëzve se si të pikasin mundësitë e vetë-punësimit dhe të veprojnë në këtë drejtim. Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të Rinjve 2018-2020 është dokumenti kryesor referues dhe i njëjti përfshin aktivitetet për zhvillimin e ndërmarrësisë si një kompetencë kyçe në arsimin formal dhe për promovimin e të mësuarit jo formal të ndërmarrësisë. Implementimi i saj mbështetet financiarisht nga ana e Qeverisë.

Ndërmarrësia e grave

Kosova nuk ka shënuar progres të konsiderueshëm në avancimin e ndërmarrësisë së grave. Zyra e Kryeministrit ka një agjenci të veçantë e cila koordinon, informon dhe inkurajon gratë për përfshirje në aktivitete biznesore. Ndërmarrësia e grave është e integruar dhe secila ministri e sektorit është përgjegjëse për udhëheqjen mbikëqyrjen, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave sektoriale brenda sektorit të tyre të aktivitetit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve në nivel nën-kombëtar, si dhe udhëheqjen e grumbullimit dhe shpërndarjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë në të gjitha ministrinë e sektorit. Dokumentet kryesore të politikave që mund të shërbejnë si referenca për ndërmarrësinë e grave janë Strategjia tashmë e skaduar e Zhvillimit të Sektorit Privat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (2013-17), e cila i referohet në mënyrë specifike grave; dhe Strategjia për Zhvillimin e NVM-ve (2012-16), gjithashtu e skaduar, pasi Qëllimi Strategjik 7 i ishte kushtuar “përmirësimit të pozitës së ndërmarrëseve femra”. Strategjia e re për zhvillimin e sektorit privat, e cila aktualisht është duke iu nënshtruar dëgjimit publik, parasheh përmirësimin dhe pozicionimin e grave në ndërmarrësi.

Kosova vazhdon të vuajë nga mungesa e koordinimit në fushën e ndërmarrësisë së grave. Platforma e vetme formale e politikave që aktualisht përdoret është Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik. Këshilli, i kryesuar nga ana e Kryeministrit, organizon dhe koordinon të gjitha aktivitetet e institucioneve shtetërore, me qëllim eliminimin e barrierave dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe investimeve në ekonomi. Rregullorja e këshillit nuk përmend në mënyrë specifike ndërmarrësinë e grave dhe as nuk ka një nëngrup të dedikuar. Oda Ekonomike e Gruas në Kosovë, me punën e saj në Agjendën Kombëtare të Fuqizimit Ekonomik të Gruas, është e vetmja organizatë e shoqërisë civile pjesëmarrëse e këshillit e cila punon në ndërmarrësinë e grave. Aktualisht nuk ekziston ndonjë mekanizëm tjetër i strukturuar i koordinimit i udhëhequr nga organizatat joqeveritare për përmirësimin e vizibilitetit të grave në ndërmarrësi dhe as nuk ka financim qeveritar për të ngritur një kapacitet të tillë nga zeroja.

Një sukses i rëndësishëm në aspektin e integritit gjinor është vendosja nga ana e Qeverisë së Kosovës e një kuote prag minimale për gratë që duhet përmbushur në të gjitha rastet e ofrimit të mbështetjes financiare për para *start-up-et*, *start-up-et* dhe *start-up-et* teknologjike. Përveç kësaj, një ligj i ri (Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare 05/2018)

përcakton se bordet e Shoqërive Aksionare duhet të përbëhen fillimisht nga të paktën 40% femra dhe dy vjet pas regjistrimit, nga të paktën 50%.

Rruga përpara për Dimensionin 1

Kosova, në aspektin e të mësuarit ndërmarrës dhe ndërmarrësinë grave, është duke performuar nën mesataren rajonale. Hapat e mëposhtëm mund të ndihmojnë në avancimin e përparimit në këtë dimension:

- **Forcimi i përvetësimit të ndërmarrësisë si një kompetencë gjithëpërfshirëse.** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të forcojë më tej qasjen e kompetencave kyçe dhe të shkojë drejt miratimit horizontal të kompetencave kyçe të ndërmarrësisë në të gjitha kurrikulat dhe nivelet e arsimit. Programet e trajnimit të mësuesve që përfshijnë metoda të të mësuarit aktiv për zhvillimin e kompetencave kyçe të ndërmarrësisë duhet të vihen në dispozicion për trajnimin në shërbim.
- **Lehtësimi i bashkëpunimit arsim-biznes për qëllimet e të mësuarit ndërmarrës.** Bashkëpunimi më i fortë arsim-biznes paraqet një mundësi të pasfrytëzuar për të ndihmuar në kapërcimin e hendekut midis aftësive të nevojshme në tregun e punës dhe atyre të ofruara nga ofruesit e arsimit dhe trajnimit. Shembuj të bashkëpunimit të mirë midis sektorit publik dhe atij privat përfshijnë partneritetet si ai ndërmjet Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Institutin e Shërbimeve të Aeroportit Limak, i cili adreson hendekun e aftësive në sektorin e aviacionit. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Instituti për Kërkime dhe Zhvillime në Arsim në kuadër të Fakultetit të Edukimit mund të angazhohen për të përmirësuar procesin arsimor përmes bashkëpunimit arsim-biznes, duke inkorporuar punën praktike në kurrikulë dhe rezultatet e të nxënit.
- **Lehtësimi i bashkëpunimit arsim-biznes nëpërmjet trajnimit të mësuesve dhe mekanizmave të shpërblimit.** Bashkëpunimi arsim-biznes mbështetet shumë në mësuesit aktivë dhe në dëshirën e tyre për të inkorporuar NVM-të në mësimdhënien e tyre. Ngritja e aftësive të mësimdhënësve me anë të integritimit të bashkëpunimit arsim-biznes në arsimimin dhe trajnimin e tyre - dhe krijimi i mekanizmave për njohjen e saj - do të stimulonte një bashkëpunim të tillë. Instituti Pedagogjik, së bashku me KEC, mund të angazhohen në hartimin e bashkëpunimit arsim-biznes për të përmirësuar aftësitë praktike të ndërmarrësisë të mësimdhënësve. Llojet e bashkëpunimit arsim-biznes mund të përfshijnë: lëvizshmërinë e studentëve, ngritjen e aftësive të fuqisë punëtore ekzistuese të NVM-ve (nxitjen e angazhimit të kompanive ndaj të mësuarit gjatë gjithë jetës), ofrimin e arsimit dhe trajnimit të udhëhequr nga punëdhënësi dhe bashkëpunimin në kërkimin dhe zhvillimin me institucionet e arsimit të lartë (për shembull, Universiteti i Prishtinës aktualisht përdor lojëra simulimi të biznesit) dhe ofruesit e AAP-së.
- **Ndërtimi i kapaciteteve të decentralizuara për të lidhur biznesin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimin.** Autoritetet lokale mund të luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e zhvillimit të territorit nëpërmjet lehtësimit të ndërveprimit midis biznesit dhe ofrimit të arsimit dhe aftësimin, p.sh. duke zhvilluar kurrikula dhe qasje ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies që plotësojnë nevojat e punëdhënësve. Një rol i tillë aktualisht realizohet nga autoritetet qendrore, për shembull nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që së bashku me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në partneritet me komunitetin e biznesit implementuan një

projekt Internship Biznesi, i cili u mundësoi studentëve të kombinojnë njohuritë e tyre me aftësitë profesionale të kërkuara nga një biznes specifik.

- **Formalizimi i koordinimit mbi fuqizimin ekonomik të grave.** Fuqizimi i gruas në ekonomi është një parakusht për rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të Kosovës. Kosova do të përfitonte nga një udhëheqje e fortë politike e nivelit të lartë në njohjen se potenciali i plotë i kontributit të grave në ekonominë e Kosovës mbetet i pashfrytëzuar. Me krijimin e një grupi formal ndërministror, apo edhe një nëngrupi në kuadër të Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik, mbështetja për ndërmarrësinë e grave do të koordinohet më mirë dhe do të bëhet më efikase. Nën-grupi mund të ndihmojë në përmylljen e Agjendës Kombëtare të Fuqizimit Ekonomik të Gruas, zhvillimin e një plani veprimi për zbatimin e saj dhe të marrë rolin e udhëheqjes së grumbullimit dhe shpërndarjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shembujt nga vendet e BE dhe OECD mund të shërbejnë si udhërrëfyes gjatë zhvillimit të një plani të veprimit (Kutia 15.2).
- **Zhvillimi i një kornize të koordinuar për monitorimin dhe vlerësimin, për të sjellë ndryshime pozitive.** Monitorimi dhe vlerësimi mbeten fushat më të dobëta në vlerësimin e ABV - Kosovës i duhet të adresojë menjëherë sfidën e të dhënave të aftësive. Këshilli Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi mund të krijojë një mekanizëm monitorimi, në bashkëpunim me KIESA, për të kryer gjurmimin e aftësive si një proces rutinor për mbledhjen dhe regjistrimin e informacionit nëpër politika dhe sektorë të shumtë. Kjo do të siguronte informata të përditësuara nga punëdhënësit dhe industria për të siguruar relevancën e ofrimit të arsimit dhe trajnimit për NVM-të. Aktualisht, sidoqoftë, Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në kuadër të së cilës funksionin komisioni, nuk i janë alokuar burime financiare shtesë për mbulimin e shpenzimeve të drejtimit të këshillit, duke bërë që të gjitha shpenzimet të absorbohen nga buxheti ekzistues. Pa burime të dedikuara (financiare, njerëzore dhe pajisje) nuk mund të ketë kornizë të koordinuar të planifikimit dhe monitorimit e cila do të kontribuonte në politika të aftësive të cilat janë racionale dhe të bazuara në dëshmi dhe qeverisje të mbështetjes për NVM-të e cila është e orientuar në rezultate.
- **Ripërtëritja e Strategjisë Kombëtare për Arsim dhe Aftësim në Ndërmarrësi.** Këshilli Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi mund të marrë përsipër shqyrtimin e kësaj strategjie kombëtare tashmë të skaduar.

Kutia 15.2. Plani i Francës për Ndërmarrësinë e Grave

Plani i Ndërmarrësisë së Grave u lansua në muajin gusht të vitit 2013 nga ministrinë e të drejtave të grave; arsimit kombëtar; arsimit të lartë dhe hulumtimit; dhe Ministria e Deleguar për NVM-të, Inovacionin dhe Ekonominë Digjitale. Ajo synon rritjen e përqindjes së grave në *start-up*-et e reja nga 30% sa është në 2012 deri në 40% në vitin 2017.

Dy nga tre shtyllat e planit të veprimit fokusohen në zhvillimin e aftësive. Shtylla e parë synon përmirësimin e komunikimit mbi ndërmarrësinë duke forcuar ndërmarrësinë në sistemin arsimor, duke mbështetur aktivitetet promovuese si Java e Ndërgjegjesimit të Ndërmarrësisë dhe lansimi i një faqeje të re (www.ellesentreprennent.fr), e cila ofron informacion dhe vegëza në programet mbështetëse në dispozicion (p.sh. trajnim, mentorim).

Shtylla e dytë forcon mbështetjen individuale për gratë ndërmarrëse me anë të krijimit të 14 rrjeteve rajonale mbështetëse që ofrojnë mentorim për gratë ndërmarrëse. Disa nga këto rrjete ofrojnë mbështetje të përgjithshme, ndërsa të tjerat ofrojnë mbështetje të përshtatur për grupe të caktuara siç janë gratë ndërmarrëse inovative ose ndërmarrëset më të moshuara gra. Një nga objektivat kryesore të këtyre rrjeteve është përforsimi i mbështetjes për gratë ndërmarrëse në zonat rurale.

Shtylla e tretë përmirëson qasjen në financa për gratë ndërmarrëse. Qasja krijoi një partneritet me *Caisse des Dépôts et Consignations*, dy banka (BPCE dhe BNP Paribas) dhe rrjete financiare (*France Active* dhe *Initiative France*), të cilat organizojnë takime mëngjesore dhe evente rrjetëzimi për ndërmarrësit dhe institucionet financiare. Përveç kësaj, qeveria lehtëson kreditë për gratë ndërmarrëse përmes fondit për garanci kreditore *Fonds de garantie à l'initiative des femmes (FGIF)*. Deri në shtator të vitit 2015, limiti për garancitë ishte EUR 45 000.

Në vitin 2013, iniciativa mobilizoi një rrjet prej 130 ndërmarrëseve femra dhe arriti 260 gra të reja që ishin të interesuara të bëheshin ndërmarrëse. Në vitin 2015 u organizuan 400 evente promovuese, që paraqiste dyfishin e numrit të tyre në vitin 2014. Në vitin 2015 FGIF ndihmoi 2 075 gra për të filluar biznese si dhe ndihmoi në krijimin e 3 095 vendeve të punës.

Çelësi i suksesit të kësaj iniciative është se e njëjta është një qasje e integruar që prek bizneset fillestare (*start-up-et*), para *start-up-et* dhe aktivitetet e zhvillimit të biznesit. Kësisoj, të tre shtyllat e përforsojnë njëra-tjetrën, sepse njerëzit mund të lëvizin nëpër fazat e ndryshme të mbështetjes teksa projekti i tyre i biznesit zhvillohet.

Burimi: Qeveria e Francës (2018^[24]), L'entrepreneuriat: Redonner de la Compétitivité aux Entreprises, www.gouvernement.fr/action/l-entrepreneuriat (Frëngjisht).

Falimentimi dhe shansi i dytë (Dimensioni 2)

Që nga vlerësimi i fundit, Kosova ka shënuar progres në miratimin e ligjeve të reja të cilat mundësojnë procedura efektive të falimentimit. Rezultati i Kosovës në këtë vlerësim është rritur nga 2.68 në 2.71 (shih Tabelën 15.7), që pasqyron këtë kornizë të përmirësuar ligjore. Megjithatë, për shkak të aftësisë së ulët të zbatimit dhe mungesës së politikave për shansin e dytë, ajo ende performon më dobët se mesatarja rajonale prej 2.87 (Tabela 15.7).

Tabela 15.7. Poenat për Dimensionin 2: Falimentimi dhe shansi i dytë

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Bloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT |
|---|---|---------------------------------------|-------------|-----------------|
| Dimensioni 2: Falimentimi dhe shansi i dytë | Nën-dimensioni 2.1: Masat parandaluese | | 2.29 | 2.39 |
| | Nën-dimensioni 2.2: Procedurat e falimentimit | Hartimi dhe implementimi | 3.41 | 3.71 |
| | | Performanca, monitorimi dhe vlerësimi | 2.40 | 2.46 |
| | | Mesatarja e matur | 3.01 | 3.21 |
| Nën-dimensioni 2.3: Promovimi i shansit të dytë | | 1.90 | 1.93 | |
| Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 2 | | | 2.71 | 2.87 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kyçe

Masat parandaluese dhe procedurat e falimentimit

Rregullorja e mëparshme mbi Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim u zëvendësua me një ligj të ri për falimentimin⁴ në muajin korrik të vitit 2016, duke çuar në një numër ndryshimesh të rëndësishme (Tabela 15.8). Veçanërisht, ligji i ri përfshin një kapitull për NVM-të⁵, dhe Neni 12 thotë se procedurat që përfshijnë një debitor NVM do të trajtohen si raste të riorganizimit, ku NVM-ve u kërkohet të paraqesin një plan riorganizimi brenda 30 ditëve nga fillimi i procedurave të falimentimit. Neni 13 parasheh emërimin e një “monitoruesi”, të ngarkuar me ofrimin e ndihmës për NVM-të në planet e tyre të riorganizimit.

Përveç kësaj, në mars të vitit 2018 u miratua Ligji i ri për Shoqëritë Tregtare, i cili parasheh rregullore të cilat rregullojnë procedurat e falimentimit dhe insolvencës për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

Sa i përket masave parandaluese, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka një sistem të paralajmërimit të hershëm, i cili operon sipas deklaratave tatimore të kompanive, për identifikimin e kompanive me probleme financiare. ATK ka të drejtë të paraqesë kërkesë për falimentim jo-vullnetar në rastet kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- një detyrimi i ka kaluar afati i pagesës prej të paktën 60 ditë
- debitori tatimor i detyrohet ATK-së më shumë se EUR 2 000
- borxhi nuk është i kushtëzuar apo nuk i nënshtrohet një mosmarrëveshjeje *bona fide*⁶.

Legjislacioni i Kosovës lejon që ristrukturimi të marrë forma të ndryshme, si falja e borxhit, shtyrja e borxhit, konvertimet borxh-ekuitet dhe shitja e biznesit ose pjesëve të tij. Norma e rikuperimit në Kosovë është në rritje të vazhdueshme: në vitin 2016 ajo ishte në nivelin 37.7 cent në dollarë, ndërsa në vitin 2018 kjo shifër shënoi rritje deri në 39.4 cent në dollarë (Banka Botërore, 2018_[18]). Megjithatë, procedurat e insolvencës mbeten relativisht të shtrenjta, ku të njëjtat kushtojnë mesatarisht 15% e aseteve, në krahasim me mesataren e OECD-së prej 9.6%.

Tabela 15.8. Pasqyrë e ndryshimeve të prezantuara në kornizën e re të insolvencës

| | Korniza paraprake | Korniza e re |
|--|--|--|
| A mundet një debitor të iniciojë procedura të likuidimit apo riorganizimit? | Nuk ka likuidim apo riorganizim në dispozicion.* | Po. Debitorët mund të iniciojnë të dyja procedurat. |
| A votojnë kreditorët mbi planin e riorganizimit? | Nuk ka riorganizim në dispozicion. | Po. Kreditorët të drejtat e të cilëve preken nga plani i propozuar votojnë mbi të. |
| A mundet gjykata të shfuqizojë transaksionet preferenciale dhe ato të nënvlerësuara të bëra para procedurave të insolvencës? | Nuk ka dispozita. | Po. |
| A mundet një debitor të marrë kredi pas fillimit të procedurave të insolvencës? | Nuk ka dispozita. | Po. Debitori ose administratori mund të marrin financim të ri pas fillimit të procedurave të insolvencës dhe prioritetet e financimit të ri përcaktohen qartë. |
| A mund të marrin pjesë kreditorët në vendime të rëndësishme? | Nuk ka dispozita. | Po. Çdo kreditor ka të drejtë të kërkojë informacion mbi gjendjen financiare të debitorit nga përfaqësuesi i insolvencës dhe mund të kundërshtojë vendimin |

Shënim: * Më parë ka pasur një ligj të posaçëm për riorganizimin i cili u mundësonte kompanive shtetërore të ristrukturojnë/riorganizojnë borxhet e tyre.

Burimi: Banka Botërore (2017^[17]), *Doing Business 2018: Reforming to Create Jobs*, <http://dx.doi.org/10.1596/978-1-4648-1146-3>.

Zgjidhja jashtëgjyqësore, si mënyrë alternative për paraqitjen e falimentimit, nuk ekziston në Kosovë. Megjithatë, që nga viti 2008, korniza ligjore u lejon kreditorëve dhe debitorëve që, pas fillimit të procedurave të insolvencës, të hyjnë në ndërmjetësim për të zgjidhur mosmarrëveshjet nën mbikëqyrjen e një ndërmjetësi neutral.

Disa masa lidhur me kohën e procedurave formale të lirimit janë prezantuar edhe në kornizën ligjore të vitit 2017. Debitori mund të lirohet nga përgjegjësia atëherë kur çështja e likuidimit është mbyllur ose kur agjencia për regjistrimin e bizneseve ose administrata tatimore njoftohet për mbylljen e rastit. Për NVM-të, ligji thotë që një debitor NVM do të marrë lirimin me rastin e konfirmimit të planit të tij gjatë fazës së riorganizimit. Megjithatë, këto përmirësime nuk reflektohen domosdoshmërisht në statistikat gjatë periudhës së vlerësimit pasi që koha mesatare për të zgjidhur insolvencën (dy vjet) nuk ka ndryshuar që nga viti 2016 (Banka Botërore, 2018^[18]).

Me qëllim të sigurimit të mbrojtjes për të gjitha palët e përfshira në një transaksion, Kosova ka nxjerrë Ligjin për Sistemin e Pagesave dhe Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit në nëntor të vitit 2016. Legjislacioni specifikon se debitori i jep kreditorit të drejtën të posedojë pronën e mbajtur nga debitori. Kjo dispozitë ligjore siguron që në rast të falimentimit, prona e përfshirë në marrëveshjen e transaksionit të siguroar përmbush obligimet financiare të debitorit. Nga ana tjetër, kreditorët janë të siguroar ndaj humbjes dhe paguhen të parët në rastin e likuidimit të biznesit.

Divizioni i Regjistrimit të Kredive i Bankës Qendrore të Kosovës monitoron dhe mbikëqyrë raportimin dhe përditësimin e të dhënave të paraqitura nga institucionet të përcaktuara në Rregulloren e Regjistrimit të Kredive. Megjithatë, ky nuk mund të konsiderohet si një mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi i ligjit të falimentimit pasi është i kufizuar vetëm në publikimin dhe përditësimin e kompanive në vështirësi.

Promovimi i shansit së dytë

Kosova nuk ka ndërmarrë iniciativa për të promovuar shansin e dytë në mesin e ndërmarrësve, dhe nuk ka strategji kombëtare apo fushatë promovuese të planifikuara. Përveç kësaj, Kosova nuk ofron asnjë lloj mbështetje mentorimi për ndërmarrësit potencialë që kanë drojë nga dështimi.

Rruga përpara për Dimensionin 2

Pavarësisht ndryshimeve në kornizën legjislative lidhur me falimentimin dhe shansin e dytë, ende mbesin sfida. Masat e mëposhtme do të ishin të dobishme:

- **Zhvillimi i një sistemi të plotë për paralajmërim “të hershëm”:** Pronarët e NVM-ve kanë tendencë për të nënvlerësuar vështirësitë e tyre financiare dhe për t'i rezistuar ndërmarrjes së veprimeve për lehtësimin e vështirësive të tyre. Përveç masave të ndërmara nga autoritetet tatimore, Kosova duhet të marrë parasysh futjen e një sistemi që do t'i bindte këta ndërmarrës për të filluar masat e rimëkëmbjes. Një sistem i tillë mund të marrë forma të ndryshme. Megjithatë, së pari duhet të hartojë procedura të veçanta për ekzaminimin dhe monitorimin e shenjave të hershme për të zbuluar NVM-të në vështirësi financiare. Së dyti, duhet afruar NVM-ve të identifikuar dhe këshilluar ato lidhur me vlerësimin në mënyrë objektive të gjendjes së tyre financiare, si dhe opsionet e ndryshme në dispozicion sa i përket rimëkëmbjes. Sapo të informohen më mirë, NVM-të do të jenë në gjendje të ndërmarrin hapat e kërkuar në një fazë më të hershme, duke rritur kështu shanset e tyre për mbijetesë. Mekanizmat e paralajmërimit të hershëm të krijuara në shtetet e BE-së mund të shërbejnë si shembull për Kosovën (Kutia 15.3).
- **Përmirësimi i kornizës ligjore dhe zhvillimi i iniciativave për të reduktuar stigmën kulturore rreth dështimit të ndërmarrësve.** Duhet të bëhet një dallim i qartë midis masave ose rregulloreve që zbatohen për falimentime mashtruese dhe atyre që zbatohen për ato të ndershme - ky dallim mund të jetë instrumental në aspektin e ndryshimit të qëndrimit të shoqërisë ndaj debitorëve. Megjithatë, ndryshimet në kornizën ligjore si të vetme nuk janë të mjaftueshme: ato duhet të plotësohen me iniciativa që promovojnë një fillim të ri dhe një kulturë që pranon dhe toleron dështimin. Punëtoritë dhe seminarët që synojnë ndarjen e mësimave të nxjerra nga ndërmarrësit e falimentuar mund të heqin stigmën rreth falimentimit dhe dështimit.
- **Zvogëlimi i mëturësive të kostos mesatare dhe kohëzgjatjes së procedurave të falimentimit.** Ekziston një korrelacion i fortë midis kostos mesatare dhe kohëzgjatjes së procedurave të falimentimit. Duke pasur parasysh këtë, duhet të zbatohen rregulla më të rrepta në lidhje me menaxhimin e pasurive të falimentimit, si dhe tarifave dhe shpërblimeve që u paguhen administratorëve të falimentimit. Për shembull, përcaktimi i një afati kohor për periudhën gjatë së cilës paguhen tarifatat për administratorët e falimentimit do të ofronte stimuj shtesë për zgjidhjen e shpejtë të rasteve të falimentimit, duke zvogëluar kështu kostot e lidhura me procedurat.
- **Vënia në dispozicion e sistemit ekzistues të ndërmjetësimit para hapjes së rasteve të falimentimit.** Kosova aktualisht nuk ka zgjidhje jashtëgjyqësore, megjithatë lejon ndërmjetësimin përmes odave ekonomike, sapo të dorëzohet një kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit. Ky sistem mund të zgjerohet për të mundësuar që ndërmjetësimi të bëhet menjëherë pas marrjes së një sinjali nga administrata tatimore ose një sistem i mirë-projektuar për paralajmërim të hershëm, përpara inicimit të një rasti gjyqësor. Kjo qasje ofron një alternativë më pak të shtrenjtë dhe më të shpejtë ndaj paraqitjes së kërkesës për falimentim dhe gjithashtu mbështet ekonominë duke zvogëluar numrin e likuidimeve, madhësinë

e barrës administrative dhe kostot për

NVM-të, si dhe duke shkurtuar kohën e nevojshme për zgjidhjen e insolvencës.

Kutia 15.3. Early Warning Europe (“Paralajmërimi i hershëm në Evropë”)

Projekti ndërkombëtar Early Warning Europe (EWE) u zhvillua me qëllim të promovimit të rritjes së NVM-ve në të gjithë Evropën duke i ndihmuar ato gjatë periudhave të vështira financiare. Në vitin 2016, Early Warning Europe aplikoi për financim përmes programit të Evropës Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) dhe mori pothuajse EUR 5 milionë. Vala e parë e projektit zgjati tre vjet dhe u përqendrua në krijimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës të paralajmërimit të hershëm në Poloni, Itali, Greqi dhe Spanjë.

Konsorciumi është i përbërë nga 15 partnerë në 7 vende duke përfshirë partnerët mentorë Early Warning Denmark, TEAM U në Gjermani, Dyzo në Belgjikë, partnerë të autoritetit si Autoriteti Danez i Biznesit, qeveria rajonale e Madridit dhe Agjencia Polake për Zhvillimin e Ndërmarrjeve, si dhe shoqata të nivelit të BE si Aleanca Evropiane e Bizneseve të Vogla, Eurochambres dhe SME United. Projekti Early Warning Europe financohet nga COSME dhe synon të ofrojë ndihmë për bizneset dhe ndërmarrësit në vështirësi, si dhe për ata të cilët dëshirojnë t'i parashikojnë më mirë problemet. Projekti krijon politika të reja më të mira dhe bazohet në përvojën ekzistuese nga këto 15 organizata. Aktualisht, pesë shtete të reja anëtare të BE janë në proces të anëtarësimit në komunitetin EWE, si dhe disa të tjera kanë shprehur interesimin e tyre. EWE është e hapur për të gjitha vendet e COSME dhe zgjerimi në faza i jep qasje mekanizmave të paralajmërimit të hershëm të parashikuar në Direktivën e ardhshme të BE mbi kornizat e ristrukturimit parandalues, shansin e dytë dhe masat për rritjen e efikasitetit të ristrukturimit, procedurave të falimentimit dhe lirimit.

Konsorciumi përbëhet nga tre grupe organizatash: 1) organizatat mentore me përvojë të konsiderueshme në ofrimin e mbështetjes për kompanitë në vështirësi; 2) organizatat kombëtare ose rajonale që synojnë të zbatojnë mekanizma të paralajmërimit të hershëm; dhe 3) organizatat që janë përgjegjëse për mbështetjen e aktiviteteve pan-Evropiane të komunikimit dhe shpërndarjes të projektit.

Nëpërmjet EWE, ndërmarrësit mund të marrin ndihmë nga konsulentët për të fituar një pasqyrë të qartë të kompanisë, për të identifikuar fushat të cilat janë duke shkaktuar probleme dhe për të propozuar aktivitete të mëtejshme përmirësuese. Hapi i dytë i procesit të restaurimit është bashkëpunimi me një mentor. Mentorët punojnë ngushtë me ndërmarrësin duke ofruar ekspertizë, njohuri dhe mbështetje për ta kthyer ndërmarrjen në rrugën e duhur. Ata gjithashtu mund ta udhëheqin kompaninë drejt një mbyllje të shpejtë dhe të organizuar, në rastet kur një gjë e tillë është alternativa më e mirë për kompaninë. Kjo gjithashtu kontribuon shumë në shanset e pronarit të kompanisë për një fillim të dytë dhe redukton humbjen për pronarin, kreditorët dhe shoqërinë si tërësi.

Vlerësimet e pavarura tregojnë një ndikim shumë pozitiv të sistemit të paralajmërimit të hershëm në shoqëri sa i përket vendeve të shpëtuara të punës dhe kursimeve për thesaret publike. Vlerësimet tregojnë një kursim të përgjithshëm prej 20% për thesaret publike në rastet e mbylljes së ndërmarrjeve bazuar në mekanizmin e Paralajmërimit të Hershëm (Early Warning), nivel të lartë të ruajtjes së vendeve të punës dhe qarkullim dhe rritje dukshëm më të mirë në vitin e parë pas ndërhyrjes së Paralajmërimit të Hershëm (Early Warning).

Një element inovativ i projektit është futja e inteligjencës artificiale dhe përpunimi i të dhënave të mëdha në zbulimin e shenjave të hershme të vështirësive tek kompanitë. Early Warning Europe ka zhvilluar një model të dhënash që identifikon probabilitetin e

të qasshme, duke u mundësuar partnerëve të rrjetit që të ndihmojnë në mënyrë proaktive kompanitë të cilat nuk mund të zgjidhin problemet e tyre para se të jetë shumë vonë.

Aktualisht projekti ka mbështetjen e më shumë se 500 mentorëve. Mbështetja e ofruar është e paanshme, konfidenciale dhe falas. Në valën e parë, EWE ofroi mbështetje për 3500 kompani në vështirësi në vendet si Poloni, Spanjë, Itali dhe Greqi. Në valën e dytë (2017-19) projekti do të mbështesë krijimin e mekanizmave të paralajmërimit të hershëm në pesë shtete tjera anëtare të BE-së, me qëllimin përfundimtar të krijimit të mekanizmave të paralajmërimit të hershëm në të gjitha vendet anëtare të BE.

Burimi: Early Warning Europe (2018^[25]), *Early Warning Europe faqja e internetit*, www.earlywarningeurope.eu.

Korniza institucionale dhe rregullatore për hartimin e politikave për NVM-të (Dimensioni 3)

Nga të gjitha ekonomitë e vlerësuara, Kosova ka përparuar më së shumti në këtë dimension, ku prej 3.01 në vitin 2016 ka arritur në 3.92 (shih Tabelën 15.9 dhe Figura 15.1), duke sinjalizuar një kalim të rëndësishëm nga hartimi i avancuar i politikave në zbatim efektiv. Kosova ka përmirësuar performancën e saj në të gjitha aspektet e politikave të mbuluara nën këtë dimension.

Tabela 15.9. Rezultatet për dimensionin 3: Korniza institucionale dhe rregullatore për hartimin e politikave për NVM-të

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Bloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT | |
|---|---|-------------------------------------|-------------|-----------------|-------------|
| Dimensioni 3: Korniza institucionale dhe rregullatore për hartimin e politikave për NVM-të | Nën-dimensioni 3.1: korniza institucionale | Planifikimi dhe hartimi | 3.71 | 4.06 | |
| | | Implementimi | 4.53 | 4.06 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 3.67 | 3.92 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 4.11 | 4.03 | |
| | Nën-dimensioni 3.2: Thjeshtimi legjislativ dhe analiza e ndikimit rregullator | Planifikimi dhe hartimi | 4.20 | 4.00 | |
| | | Implementimi | 2.83 | 3.25 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 3.27 | 3.23 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.33 | 3.47 | |
| | Nën-dimensioni 3.3: Konsultimet publiko-private (KPP) | Frekuenca dhe transparenca e KPP | 4.38 | 3.86 | |
| | | Përfshirja e sektorit privat në KPP | 4.40 | 4.26 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 3.67 | 2.73 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 4.25 | 3.79 | |
| | Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 3 | | | 3.92 | 3.79 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kyçe

Korniza institucionale

Që nga vlerësimi i fundit, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar më tej kornizën e saj institucionale dhe rregullatore për NVM-të. Strategjia e mëparshme për Zhvillimin e Sektorit Privat ka skaduar në vitin 2017 - Strategjia e Re për Zhvillimin e Sektorit Privat që mbulon periudhën 2018-22 u hartua dhe e njëjta është dërguar për dëgjim publik në fund të vitit 2018.

Draft Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat është e përkushtuar drejt zhvillimit të vazhdueshëm të sektorit privat. Ajo bazohet në qasjen e miratuar në vitet e mëparshme, me shtimin e disa elementeve të reja, siç është vënia e një theksi më të madh në integrimin e NVM-ve në zinxhirët global të vlerave dhe futja e shërbimeve të reja të fokusuara në përmirësimin e njohurive financiare të NVM-ve. Megjithatë, draft Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat, njëjtë sikur ajo e mëparshme, nuk arrin të identifikojë indikatorët e performancës ose mekanizmat raportues për masat dhe aktivitetet e planifikuara.

Zbatimi i aktiviteteve të ndërlidhura me NVM-të është mbështetur vazhdimisht nga një agjenci implementuese mirëfunksionuese e NVM-ve - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Pas përvojës me shkurtimin e burimeve, KIESA u përforcua në 2018, si në aspektin financiar (një rritje buxhetore prej 40% në 2018) ashtu edhe në aspektin e burimeve njerëzore (20% më shumë staf në 2018 se në 2017). Ky trend pozitiv parashikohet të vazhdojë në 2019, ku KIESA ka njoftuar rritje të lehtë të buxhetit të saj për vitin 2019.

Megjithatë, masat për luftimin e ekonomisë jo-formale nuk janë përfshirë në draft Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat. Ministria e Financave është ngarkuar me detyrën e luftimit të ekonomisë gri: si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Jo-formale, Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (2014-2018), ka zbatuar një numër masash për të zvogëluar evazionin fiskal dhe për të rritur ndërgjegjësimin për natyrën e dëmshme të ekonomisë jo-formale. Instalimi i regjistrave të arkave fiskale është përfunduar dhe reforma e sistemit të inspektimit ka filluar – e njëjta planifikohet të finalizohet në vitin 2020.

Thjeshtimi legjislativ dhe analiza e ndikimit rregullator

Që nga vlerësimi i fundit, Kosova ka intensifikuar përpjekjet për të shqyrtuar dhe thjeshtuar legjislacionin e saj primar dhe të varur lidhur me biznesin përmes Strategjisë së përditësuar për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-2021) dhe Planit përkatës të Veprimit (Kutia 15.4). Qëllimi i strategjisë së përditësuar është përmirësimi i mëtejshëm i hartimit të politikave dhe legjislacionit të bazuar në dëshmi, si dhe kontribuimi në rritjen gjithëpërfshirëse. Më shumë se 60% e legjislacionit primar lidhur me biznesin është shqyrtuar deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2018.

Përveç kësaj, Strategjia për Rregullim më të Mirë ka intensifikuar përpjekjet për të përmirësuar praktikën e analizës së ndikimit rregullator (ANRr). Në veçanti, draft manuali për kryerjen e ANRr është përditësuar dhe një analizë kosto-përfitim e legjislacionit të ri tani është bërë pjesë e detyrueshme e procesit të ANRr. Ekziston edhe një kërkesë formale për të shqyrtuar aspektet e NVM si pjesë e ANRr, por një test i plotë i NVM ende nuk është përfshirë në metodologjinë e ANRr. Gjithashtu, është iniciuar ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve qeveritarë për ANRr, ku Instituti i Kosovës për Administratë Publike ofroi një kurs trajnimi 10-ditor mbi ANRr për 161 zyrtarë në vitin 2016 (OBZHE, 2017_[26]).

Megjithatë, përkundër këtyre iniciativave, ANRr është ende në një fazë të hershme të zhvillimit në Kosovë, gjegjësisht nuk zbatohet plotësisht në praktikë. Vetëm një pakicë e projektligjeve shoqërohen me dokumentin e detyrueshëm analitik të historikut. Edhe kur shoqërohen, cilësia e analizës në këto dokumente është e ndryshueshme, ku në shumicën e rasteve mungojnë elemente të rëndësishme.

Kutia 15.4. Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-21)

Reforma e parë e rëndësishme rregullatore në Kosovë u zhvillua në vitin 2014 me prezantimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë të Qeverisë së Kosovës (2014-2020). Sidoqoftë, në vitet që pasuan, janë shfaqur probleme serioze lidhur me zbatimin e strategjisë dhe përmbushjen e objektivave të saj. Disa nga arsyet kryesore për këtë qëndrojnë në mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe supozimet tepër ambicioze rreth asaj se si duhet hartuar dhe zbatuar politikën e Rregullimit më të Mirë brenda një administrate.

Si rezultat i kësaj, në vitin 2016, pas një analize gjithëpërfshirëse dhe të detajuar, qeveria vendosi të ristrukturojë strategjinë dhe të sigurojë që Agjenda e Kosovës për Rregullim më të Mirë ishte bazuar në një qasje më realiste që merrte parasysh kohën e nevojshme për të zhvilluar dhe zbatuar me sukses aktivitetet e saj. Kjo çoi në zhvillimin dhe miratimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-2021), me qëllim përmirësimin e hartimit të politikave dhe legjislacionit duke siguruar që ato të bazohen në dëshmi (në të dhëna dhe statistika relevante), analiza dhe konsultime me palët kyçe të interesit. Objektivat e saj kryesore janë si më poshtë:

- vlerësimi se si Qeveria e Kosovës mund të zhvillojë një program efektiv për reduktimin e barrës administrative
- futja e vlerësimeve të ndikimit bazuar në sistemin aktual për zhvillimin e koncept dokumenteve, për të cilat kapacitetet e zhvillimit të politikave do të rriten ndjeshëm
- përmirësimi i konsultimeve me palët e interesit nëpërmjet zbatimit të plotë të Standardeve Minimale për konsultim
- përmirësimi i komunikimit të politikave bazuar në analizën e detajuar të situatës aktuale që do të paraqitet në një koncept dokument të kombinuar me një plan specifik të veprimit
- zhvillimi i një plani pune më realist që merr parasysh kohën e nevojshme për të kryer analizat e politikave dhe konsultimet me palët e interesit; bazuar në një koncept dokument në të cilin do të përshkruhet hartimi.

Për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë për Rregullim më të Mirë 2.0, qeveria ia ka atribuar këtë detyrë Sekretariatit Koordinues të Qeverisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Burimet: Zyra e Kryeministrit (2017^[27]), *Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën: 2017-2021*, www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Better_Regulation_Strategy_2_0_for_Kosovo_-_ENGLISH.pdf; informacionet e mbledhura nga qeveria gjatë këtij vlerësimi.

Konsultimet publike-private

Konsultimet publike-private (KPP-të) janë të nevojshme për të gjithë legjislacionin e lidhur me biznesin në Kosovë. Risia kryesore që nga vlerësimi i fundit ka qenë futja e një uebfaqeje të centralizuar në vitin 2017, e cila tregon të gjitha konsultimet e vazhdueshme dhe ato të mëparshme së bashku me rezultatet e tyre. Kjo ka sjellë disiplinë të mëtejshme në ministritë e linjës sa i përket ndarjes së draft propozimeve legjislative për konsultime publike me shkrim.

Përveç kësaj, KPP-të zhvillohen rregullisht, në përputhje me kërkesat e rregullimit. Kosova është një nga ekonomitë e BPT me pjesëmarrjen më të ulët të ligjeve të miratuara nëpërmjet një procedure urgjente, pra pa ndonjë konsultim të kryer. Në vitin 2016, 19% e ligjeve u miratuan duke anashkaluar KPP. Megjithëse kjo përqindje nuk është shumë e ulët, vetëm Shqipëria dhe Mali i Zi kishin një pjesëmarrje më të ulët në mesin e ekonomive të vlerësuara në të njëjtin vit, përkatësisht me 5% dhe 9% (OBZHE, 2017^[26]).

Sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të KKP-ve, Kosova është e vetmja ekonomi e BPT që i ka dhënë mandatin një organi, gjegjësisht Zyrës për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit, për të monitoruar ekzekutimin dhe rezultatet e konsultimeve në vitin 2017. Sidoqoftë, edhe pse zyra është e ngarkuar me përgatitjen e një raporti vjetor mbi procesin e konsultimit publik, ajo nuk kontrollon vazhdimisht pajtueshmërinë e draft propozimeve me kërkesat e konsultimit publik përpara se propozimet të paraqiten në qeveri për vendime.

Në vitin 2015, qeveria rithemloi Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës (KKZHEK), i cili është i vendosur dhe koordinuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Këshilli organizon dhe koordinon aktivitetet e institucioneve shtetërore, me qëllim të eliminimit të pengesave dhe adresimit të sfidave të të bërit biznes në Kosovë, duke ndihmuar në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe investimeve si përfundim. Një nga karakteristikat e tij kryesore është të veprojë si platformë për shkëmbimet publike-private, duke mbledhur përfaqësues nga sektori privat dhe institucionet publike dhe duke forcuar rolin e komunitetit të biznesit në procesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Sidoqoftë, efektiviteti i tij deri më tani ka qenë i diskutueshëm - bizneset e shohin KKZHEK si të paefektshëm në adresimin e çështjeve siç duhet dhe në kohën e duhur (BERZH, 2018_[28]). Kjo është pjesërisht sepse sekretariati i këshillit është i vendosur në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me personel nga nëpunësit civilë të cilët nuk janë domosdoshmërisht të pajisur në mënyrë profesionale për t'i shërbyer nevojave të këshillit dhe që kanë detyrime të tjera profesionale përveç përkrahjes së KKZHEK dhe anëtarëve të tij (BERZH, 2018_[28]). Për të kapërcyer këto sfida, në vitin 2018, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë i Kosovës kërkoi mbështetjen e BERZH-it për të siguruar një Sekretariat profesional me orar të plotë për KKZHEK, duke marrë parasysh përvojën e tyre në këtë fushë. Me këtë shtysë të re, KKZHEK pritet të përmirësojë performancën dhe ndikimin e tij - megjithëse rezultatet konkrete ende mbetet të shihen.

Rruga përpara për Dimensionin 3

Siç u përmend më lart, Kosova ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në ndërtimin e një kornize të qëndrueshme institucionale dhe rregullatore për NVM-të. Në rrugën përpara, ajo duhet të fokusohet më shumë në pikat e mëposhtme:

- **Përmirësimi i monitorimit të strategjisë për zhvillimin e sektorit privat dhe fillimi i vlerësimit të efektivitetit të saj në terren.** Strategjia e mëhershme për Zhvillimin e Sektorit Privat, e cila skadoi në vitin 2017, nuk është vlerësuar - prandaj mësimet e nxjerra nga zbatimi i saj nuk mund të përdorshin gjatë hartimit të të strategjisë së re. Për më tepër, draft strategjisë së sektorit privat i mungojnë objektivat konkrete dhe treguesit e performancës, gjë që pengon monitorimin efektiv. Prandaj, sapo të jetë miratuar Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat 2018-2022, qeveria duhet të fillojë ndjekjen e zbatimit të saj duke krijuar një sistem monitorimi që përfshin treguesit dhe objektivat. Kjo duhet të pasohet nga vlerësimi i masave të zbatuara sipas strategjisë - duke marrë parasysh fondet relativisht të mëdha publike të disbursuara, ky vlerësim do të ndihmonte qeverinë për të shpërndarë më mirë burimet e saj të kufizuara në programet dhe aktivitetet më efektive dhe më të nevojshme.
- **Sigurimi i zbatimit të plotë të ANRr, duke i marrë parasysh njëkohësisht aspektet e NVM-ve.** Dëshmitë tregojnë se ka ndryshime të rëndësishme në cilësinë e raporteve të ANRr të marra nga ministritë e ndryshme të linjës. ANRr-ve shpesh iu mungon informacioni i kërkuar, p.sh. analiza e opsioneve alternative ndaj draftit të propozuar dhe/ose vlerësimi i duhur i ndikimit në NVM-të. Përveç ofrimit të trajnimeve mbi ANRr për zyrtarët qeveritarë dhe shpërndarjes së udhëzimeve të qarta me shembuj konkretë se si të kryhen ANRr-të, qeveria mund të përfitojë më tej nga Zyra për Qeverisje të Mirë për të siguruar cilësinë e ANRr-ve. Kësaj zyreje mund t'i jepet një mandat i qartë për kthimin e dokumenteve të ANRr që konsiderohen të jenë më poshtë standardit tek institucioni përgjegjës për rishikim para se propozimi të shkojë në qeveri. Në këtë mënyrë, institucioni që propozon legjislacionin do të jetë i detyruar të sigurojë një cilësi minimale të ANRr, në përputhje me kërkesat ligjore.

Sigurimi i pjesëmarrjes efektive të NVM-ve në konsultimet publiko-private.

Shumë pak punë është bërë për t'i shtrirë dorën NVM-ve sa i përket rritjes së pjesëmarrjes së tyre në dialogun mbi legjislacionin që lidhet me biznesin. Për ekonominë e vogla si Kosova, me më pak NVM, është më e lehtë për politikëbërësit që të kenë takime të rregullta me një pjesë më të madhe të NVM-ve. Karvani i Biznesit i Malit të Zi mund të shërbejë si një shembull i mirë se si t'i shtrihet dora NVM-ve dhe të sigurohet pjesëmarrja e tyre në zhvillimin e legjislacionit të lidhur me biznesin. Karvani i Biznesit u organizua gjatë zhvillimit

të strategjisë së re të NVM-ve. Ai përbëhej nga një sërë takimesh në 14 komuna në Malin e Zi gjatë së cilave qeveria u takua me përfaqësuesit e sektorit privat për të mbledhur mendimet e tyre mbi cilësinë e masave të propozuara, si dhe fushat për përmirësime të mëtejshme.

Mjedisi operacional për NVM-të (Dimensioni 4)

Që nga vlerësimi i vitit 2016, Kosova ka bërë një përparim të konsiderueshëm në fushën e mjedisit operacional për NVM-të (Figura 15.1), duke rritur rezultatin e saj nga 3.2 në 3.75 (Tabela 15.10). Ky rezultat e vendos Kosovën në vendin e dytë në rajonin e BPT, duke reflektuar përpjekjet e saj në reformimin e mëtejshëm të rregulloreve që lidhen me NVM-të.

Tabela 15.10. Rezultati për Dimensionin 4: Mjedisi Operacional për NVM-të

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Blloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT | |
|--|---|---|-------------|-----------------|-----------------------------|
| Dimensioni 4: Mjedisi operacional për NVM-të | Nën-dimension 4.1: Shërbimet e qeverisjes digjitale për ndërmarjet | Planifikimi dhe hartimi | 4.20 | 4.07 | |
| | | Zbatimi | 3.57 | 3.47 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 2.47 | 2.05 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.48 | 3.29 | |
| | Nën-dimensioni 4.2: Regjistrimi i kompanisë | Hartimi dhe zbatimi | 4.73 | 4.48 | |
| | | Performanca | 4.90 | 3.72 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 5.00 | 3.59 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 4.87 | 3.97 | |
| | Nën-dimensioni 4.3: Licencimi i biznesit | Procedurat e Licencës | 3.76 | 3.67 | |
| | | Monitorimi dhe ristrukturimi (racionalizimi) i sistemit të | 3.13 | 3.18 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.44 | 3.43 | |
| | Nën-dimensioni 4.4: Procedurat e përputhshmërisë tatimore për NVM-të | Procedurat e përputhshmërisë tatimore dhe të thjeshtimit të NVM-ve | | | Nuk ka poena (rezultate) |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi i masave tatimore specifike të NVM-ve | | | |

Shënim: Një nën-dimension i ri 4.4 për procedurat e përputhshmërisë tatimore për NVM-të ishte shtuar me kërkesë të ekonomive të vlerësuara, për të reflektuar më mirë kompleksitetin e pasqyrës së përgjithshme të mjedisit operacional për NVM-të, megjithatë, pasi që është një pilot analizë, ky nën-dimension nuk është përfshirë në caktimin e poenave (rezultatit).

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Shërbimet e qeverisjes digjitale për ndërmarrjet

Përpjekjet e Kosovës për të integruar qeverisjen digjitale në reformat e administratës publike janë të lidhura me zbatimin e Strategjisë së Reformave të Administratës Publike 2015-2020. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është zhvillimi i administratës publike dhe kapaciteteve të saj administrative. Në kontekstin e shërbimeve digjitale, strategjia përcakton dy objektiva kryesore:

- zhvillimin dhe integrimin e sistemeve elektronike bazuar në kornizën e interoperabilitetit
- krijimin e një modeli të një pike të vetme kontakti (one-stop shop) për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, dhe aplikimin e metodave të qeverisjes elektronike.

Kosova nuk ofron shërbime digjitale për paraqitjen e deklaratave të sigurimeve shoqërore dhe nuk ka iniciativa për ngritjen e vetëdijes së NVM-ve për përdorimin e shërbimeve digjitale në përgjithësi. Megjithatë, NVM-të mund të përfitojnë nga shërbime të ndryshme elektronike përmes disa institucioneve. Për shembull, shërbimet për paraqitjen e deklaratave tatimore dhe shërbimet për skemat e pensioneve janë të digjitalizuara dhe janë plotësisht operacionale në faqen e internetit të administratës tatimore (www.atk-ks.org). Shërbimet digjitale në lidhje me kadastrin, të tilla si skica gjeografike dhe numri i identifikimit të tokës, ofrohen online (www.geoport.al). Përveç kësaj, statistikave të ndërmarrjeve ofrohen po ashtu nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Nuk ka ende asnjë sistem të autentikimit digjital ose nënshkrimit digjital në dispozicion për NVM-të (shih Seksionin “Mjedisi operacional për NVM-të” (Dimensioin 4)). Në anën tjetër, sistemi për shkëmbimin e të dhënave brenda sektorit publik është funksional dhe planifikohet të zhvillohet më tej, me qëllimin përfundimtar krijimin e një rrjeti të vetëm digjital. Ka gjithashtu disa sisteme të shkëmbimit të të dhënave që operojnë në mesin e institucioneve të ndryshme publike, duke përfshirë Listën e Pagave dhe Thesarin, Agjencinë për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë (ARBK), ASK, Doganat, Regjistrin Civil dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Përkundër faktit që nuk është pjesë e Partneritetit të Qeverisë së Hapur, Kosova është zotuar për të dhëna të hapura duke miratuar Kartën e të Dhënave të Hapura në vitin 2016. Ky dokument kyç mandatoi Ministrinë e Administratës Publike që të hartojë një plan kombëtar të hapjes së të dhënave. Për më tepër, Ministria lansoi edhe Procesin e Vlerësimit të Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave duke përdorur metodologjinë e Bankës Botërore (Banka Botërore, 2019^[29]). Ky vlerësim është një mjet metodologjik që përdoret për të kryer një vlerësim të orientuar kah veprimet, të gatishmërisë së një qeverie për të vlerësuar, dizajnuar dhe zbatuar një iniciativë të të dhënave të hapura në një fazë të mëvonshme.

Në përgjithësi, zhvillimet pozitive në fushën e planifikimit dhe zbatimit nuk janë reflektuar ende në monitorim dhe vlerësim. Kosova nuk mbledh të dhëna mbi përdorimin e

shërbimeve digjitale nga NVM-të - përjashtim i vetëm është administrata tatimore, e cila ofron një anketë të kënaqshmërisë së përgjithshme për përdoruesit përmes e-portalit të saj.

Regjistrimi dhe licencimi i biznesit

Që nga viti 2015, Kosova ka vazhduar të zvogëlojë numrin e procedurave që kërkohen për të filluar një biznes në tri procedura, që është numri më i ulët në rajon. Duhet theksuar se Kosova ka qenë pararendëse në tërë rajonin, duke reduktuar kohën e regjistrimit të një kompanie për pothuajse 50% në tri vitet e fundit - një zhvillim që lidhet me thjeshtësimin e regjistrimit të punonjësve. Përveç kësaj, koha që nevojitet për të hapur një biznes është 5.5 ditë, koha e dytë më e ulët në ekonomitë e BPT. Situata është e ngjashme për koston e hapjes së një biznesi, që është 1% e të ardhurave për kokë banori.

Pas Strategjisë për Reforma në Administratë Publike 2015-2020, në vitin 2016, Kosova futi një sistem të zyrave për shërbime në një vend (one-stop shops) që u mundësojnë ndërmarrësve të përfundojnë tërë hapat e kërkuar të regjistrimit përmes njëres prej 29 zyrave komunale për shërbime në një vend (zyrave komunale për regjistrim të biznesit) të ARBK-së. Regjistrimi online u bë funksional në mars të vitit 2017, dhe përafërsisht 400 biznese janë regjistruar përmes sistemit. Për më tepër, këto zyra ofrojnë 33 shërbime, 24 prej të cilave janë për ndryshimet lidhur me regjistrimin e biznesit. Gjashtë shërbime janë për regjistrimin e biznesit dhe dy janë për shërbimet e likuidimit të biznesit. Shërbimet për regjistrimin e biznesit përfshijnë lëshimin e një numri fiskal dhe një certifikate të TVSH-së. Zyrat për shërbime në një vend operojnë në një sistem të integruar të regjistrimit, që përfshin një aplikim të vetëm, duke lehtësuar rrjedhën e informacionit ndërmjet ARBK-së, Doganës dhe Administratës Tatimore.

Kosova është një prej ekonomive të BPT që ofron informacione mbi procesin e licencimit përmes një ueb portali (Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave), edhe pse licencat jepen nga institucione të ndryshme publike. Përkundër faktit që Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave ka përgjegjësinë për lëshimin e lejeve dhe licencave, është Departamenti Ligjor i Zyrës së Kryeministrit ai që kryen shqyrtimet periodike legjislative në lidhje me licencat dhe lejet kështu që Regjistri Qendror nuk mund të konsiderohet një organ administrativ, por vetëm një regjistër pa ndonjë autoritet ligjor.

Kosova synon të racionalizojë më tej procedurat e saj administrative për bizneset duke prezantuar Strategjinë për Rregullim më të Mirë (2014-2020), e cila është përditësuar në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-2021) (Kutia 15.4). Strategjia thekson se testi i planifikuar i NVM-ve dhe testi i konkurrueshmërisë rregullative do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë lejeve dhe licencave; megjithatë, dokumenti nuk jep informacione të detajuara mbi procesin ose përmbajtjen.

Procedurat e përputhshmërisë tatimore për NVM-të

Në vitin 2015, të hyrat e mbledhura nga tatimet në Kosovë ishin barazi me pothuajse 25% të BPV-së së ekonomisë. Tatimi në Kosovë anon në drejtim të TVSH-së për të reduktuar sektorin informal, që ka kontribuar me rreth 75% të përqindjes totale të të hyrave tatimore në vitin 2015 (OECD, 2018_[10]).

Në Kosovë, të gjitha bizneset i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatave. Regjimi i kontabilitetit të parasë së gatshme (kontabiliteti me bazë monetare) për tatimin mbi të ardhurat e korporatave u fut në vitin 2015, sipas të cilit bizneset me të ardhura bruto vjetore deri në 50,000 euro kanë të drejtë ta përdorin atë. Sipas kontabilitetit të parasë së gatshme, tatimi mbi të ardhurat paguhet mbi të hyrat vetëm kur pranohen paratë e gatshme dhe kostot e inputeve zbriten vetëm kur paguhen shpenzimet. Shumë NVM zgjedhin këtë metodë pasi që thjeshtëson llogarimbajtjen duke eliminuar nevojën për të regjistruar të arkëtueshmet dhe të pagueshmet; d.m.th. nevojitet vetëm një ditë para të gatshme që regjistron shitjet dhe blerjet. Përveç kësaj, bizneset e Kosovës me të ardhura vjetore bruto deri në 50,000 euro kanë të drejtë të paguajnë 3% tatim në të ardhurat bruto që rrjedhin nga aktivitetet tregtare, të transportit dhe bujqësisë, dhe 9% nga aktivitetet e lidhura me shërbimet. Nëse të ardhurat vjetore bruto të ndërmarrjeve tejkalojnë 50,000 euro, ato janë të detyruara të paguajnë normën tatimore standarde mbi të ardhurat e korporatave të fiksuara në 10%.

Sa i përket masave të thjeshtësimit të TVSH-së, ndërmarrjet në Kosovë mund të përfitojnë nga një prag i regjistrimit dhe mbledhjes së TVSH-së. Regjistrimi vullnetar për TVSH është i mundur nëse qarkullimi i një biznesi është nën 30,000 euro brenda një viti kalendarik. Në shtator të vitit 2015, si një prej masave nën Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, Kosova futi përjashtimet e TVSH-së në importin e lëndëve të para dhe pajisjet e teknologjisë informative për të tërhequr investitorët dhe për të reduktuar ekonominë e zezë në këtë sektor.

Masa të mëtejshme të thjeshtësimit për tatimet tjera përfshijnë skemat speciale për agjencitë e udhëtimit dhe marrëveshje të veçanta të zbatueshme për mallrat e dorës së dytë, veprat artistike, antikitetet dhe artikuajt e kolektorëve. Lista përfshin një skemë marzhe (mark-up) fitimi dhe aranzhime të veçanta për shitjet në ankande publike, një skemë norme të sheshtë për fermerët dhe një skemë të veçantë për investimet në ar.

Rruga përpara për dimensionin 4

Megjithë përmirësimin e bërë nga Kosova në regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, prapë mbetet të adresohen sfidat e mëposhtme:

- **Krijimi i një sistemi të autentikimit digjital ose nënshkrimit elektronik** për të zgjeruar gamën e shërbimeve elektronike. Nënshkrimet elektronike ose autentikimet digjitale u mundësojnë përdoruesve të përfundojnë të gjitha proceset online dhe të kursejnë kohë - aktualisht prania e tyre fizike është e nevojshme për të kompletuar shërbimet.

- **Ristrukturimi (racionalizimi) i licencave dhe lejeve të bizneseve duke integruar autoritetin që i lëshon ato.** Edhe pse zyrat aktuale për shërbime në një vend (one-stop shops) që operohen nga ARBK-ja mundësojnë regjistrim të lehtë të bizneseve, ato nuk centralizojnë procesin e aplikimit për licenca dhe leje të ndryshme. Rrjedhimisht, mandati i ARBK-së mund të zgjerohet për të thjeshtuar më tej procesin e licencave në mënyrë që ndërmarrjet të mos kenë nevojë të vizitojnë disa institucione publike për të marrë lejet.
- **Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të përmirësuar të dhënat e hapura qeveritare** bazuar në rezultatin e Vlerësimit të Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave që është aktualisht në zhvillim e sipër. Kosova duhet të zgjerojë raportimin online të statistikave të ndërmarrjeve dhe të zbatojë të dhëna të hapura qeveritare. Të dhënat e hapura qeveritare jo vetëm që rrisin transparencën dhe ndihmojnë në zvogëlimin e korrupsionit, ato gjithashtu hapin shtigje të reja për përfshirjen e qytetarëve. Nivelet e përdorimit të të dhënave të hapura qeveritare nga NVM-të mbeten të ulëta, kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve të sofistikuar analitike që nevojiten për të analizuar grupet e mëdha të të dhënave. Prandaj, për të rritur përdorimin e të dhënave të hapura qeveritare nga NVM-të, Kosova duhet të rrisë numrin e grupeve të të dhënave të publikuara që mund të lexohen nga pajisjet në lidhje me NVM-të dhe të vazhdojë përpjekjet e saj për të rritur vëllimin e të dhënave të qasshme dhe relevante. Kjo mund të arrihet duke forcuar kulturën e shtytur nga të dhënat në sektorin publik, për shembull me anë të digjitalizimit më të madh të shërbimeve.

Shërbimet mbështetëse për NVM-të (Dimensioni 5a)

Që nga vlerësimi i vitit 2016 i ABV, Kosova ka përmirësuar performancën e saj në shërbimet mbështetëse për NVM-të, me një rritje të rezultatit të saj të përgjithshëm në këtë dimension nga 2.74 në 3.64 - një nga rritjet më të mëdha nga të gjitha ekonomitë e BPT (Tabela 15.11). Përkundër këtij progresi, Kosova shënon rezultat nën rezultatin mesatar të BPT prej 3.89.

Tabela 15.11. Rezultati për dimensionin 5a: Shërbimet mbështetëse për NVM-të

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Bloku tematik | Kosovë | Mesatarja e BPT | |
|--|---|------------------------------|-------------|-----------------|-------------|
| Dimensioni 5a: Shërbimet e mbështetjes së bizneseve për NVM-të | Nën-dimension 5a.1: Shërbimet e mbështetjes së bizneseve të ofruara nga qeveria | Planifikimi dhe hartimi | 4.56 | 3.84 | |
| | | Zbatimi | 2.79 | 3.68 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 2.92 | 3.19 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.35 | 3.63 | |
| | Nën-dimension 5a.2: Iniciativat qeveritare për të stimuluar shërbimet private të mbështetjes së bizneseve | Planifikimi dhe hartimi | 5.00 | 4.67 | |
| | | Zbatimi | 3.29 | 3.85 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 4.00 | 4.07 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.94 | 4.14 | |
| | Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për dimensionin 5a | | | 3.64 | 3.89 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Që nga vlerësimi i vitit 2016, dokumenti kryesor strategjik i Kosovës për ofrimin e shërbimeve të mbështetjes së bizneseve (SHMB) për NVM-të, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, është hequr gradualisht, ku një draft është duke u përgatitur, i cili mbulon vitet 2018 deri 2022. Përveç mbështetjes me grante dhe kredi, plani i veprimit i strategjisë së re parasheh vazhdimin e dy skemave “vaucher” të bashkëfinancimit të përshtatshme më poshtë: njëra për certifikim të produkteve dhe tjetra për shërbime të konsulentëve. Plani i veprimit po ashtu përfshin objektiva të matshëm për të monitoruar zbatimin e tyre. Të dy skemat e bashkëfinancimit tashmë janë zbatuar nga KIESA gjatë periudhës aktuale të vlerësimit. Informatat mbi të gjitha SHMB-të e ofruara nga KIESA mund të gjenden në faqen e internetit të institucionit, që përditësohet rregullisht.

KIESA është agjencia publike e mandatuar për të promovuar dhe mbështetur NVM-të, dhe operon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Është institucioni i dedikuar për t'i ofruar SHMB NVM-ve. Në vitin 2018, kishte një staf prej 25 punonjësve dhe një buxhet prej 5.2 milionë euro për të mbuluar këto aktivitete (Republika e Kosovës, 2018^[30]). Në vitin 2017, KIESA financoi një analizë të nevojave të trajnimit, ku u anketuan 600 mikro-ndërmarrje, 150 ndërmarrje të vogla, dhe 50 ndërmarrje të mesme (KIESA, 2017^[31]). Megjithatë gjetjet e studimit nuk janë marrë parasysh në përgatitjen e SHMB-ve të Kosovës, ato kanë potencial për të ndihmuar në përshtatjen e ofrimit të SHMB-ve më afër nevojave të NVM-ve në të ardhmen.

Në vitin 2017, KIESA u ofroi mbështetje NVM-ve për pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare

të tregtisë; organizoi ngjarje promocionale (p.sh. panairi tregtar Gratë në Biznes), dhe një garë për planin e biznesit për sipërmarrësit e rinj); dhe ofroi dy skemat vauçer të përmendura më lart. Shuma totale e alokuar për të dy skemat vauçer në vitin 2017 ishte 50,000 euro (25,000 euro për vauçerin e konsulencës dhe 25,000 euro për vauçerin e certifikimit të prodhimit). Vauçeri i konsulencës mbulon 50% të kostove të përfituesit për marrjen e këshillave të konsulencës, deri në një shumë maksimale prej 50 euro në ditë për deri në 12 ditë. Nga përfituesi kërkohet që të mbulojë kostot e konsultimit në tërësi dhe kostot rimbursohen pas përfundimit të projektit. Skema vauçer për certifikimin e produkteve bashkëfinancon sektorët e ndërtimitarisë, të përpunimit të metaleve, dhe të përpunimit të drurit dhe mobileve. Certifikimi i produkteve bashkëfinancohet me një normë prej 75%, me një kufi të sipërm prej 10,000 euro për përfitues. Për të përfituar nga rimbursimi prej 75%, NVM-të duhet të dëshmojnë që produktet e tyre janë certifikuar me sukses nga një organ i akredituar i vlerësimit të konformitetit. Sipas këtyre skemave vauçer, NVM-të janë të lira të zgjedhin konsulentët ose trajnerët e tyre të sektorit privat.

KIESA gjithashtu ka lansuar një skemë të re të bashkëfinancimit në vitin 2018, që bashkëfinancon deri në 75% të blerjeve të makinerive nga NVM-të për qëllime të prodhimit. Buxheti për këtë skemë ishte 1.5 milionë euro në vitin 2018 dhe në kohën e përgatitjes së këtij dokumenti, kishte 36 NVM që kishin përfituar.

Ndërsa KIESA ofron skema të bashkëfinancimit për NVM-të, ajo nuk ofron drejtpërsëdrejti kurse trajnimi ose mentorim. Përveç kësaj, shfrytëzimi i skemave të KIESA-së të bashkëfinancimit ka qenë shumë i ulët. Në vitin 2017, asnjë NVM nuk aplikoi për vauçerin e konsulencës dhe vetëm pesë aplikuan për vauçerin e certifikimit të produkteve, por vetëm një përmbushi kriteret. Prandaj nuk është për t'u habitur që më pak NVM kanë përfituar nga SHMB-të në Kosovë se sa në ekonomitë e tjera të BPT. Në vitin 2017, vetëm 37 (0.1%) e të gjitha NVM-ve në Kosovë përdorën një shërbim mbështetës të biznesit (SHMB) të ofruar nga KIESA, 36 prej të cilave u mbështetën që të ndjekin një panair tregtar, ndërsa vetëm një NVM përfitoi nga vauçeri i bashkëfinancimit për certifikim të produkteve. Si krahasim, 18.6% e NVM-ve në Turqi kanë përdorur një SHMB me bashkëfinancim publik në vitin 2017, dhe mesatarisht 3.9% e NVM-ve kanë vepruar kështu në pesë ekonomitë e tjera të Ballkanit Perëndimor.

KIESA përdor anketime për të mbledhur reagime nga NVM-të mbi skemat e saj të bashkëfinancimit, megjithëse deri më sot nuk ka përdorur rezultatet për të përshtatur SHMB-të e saj. Përveç kësaj, KIESA i dërgon raportet e saj vjetore Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, e cila fut informacionet dhe të dhënat relevante në raportet vjetore të qeverisë.

Rruga përpara për dimensionin 5a

Përkundër përmirësimit të Kosovës në ofrimin e SHMB-ve, mbeten ende sfida. Hapat e mëposhtëm do të ndihmojnë në përmirësimin e situatës:

- **Përshtatja e shërbimeve mbështetëse të biznesit më afër nevojave të NVM-ve duke përdorur rezultatet e analizës së nevojave për trajnim.** KIESA ende nuk ka përdorur rezultatet e analizës së nevojave për trajnim të NVM-ve që ka financuar në vitin 2017. Ngjashëm, KIESA nuk përdorë reagimet kthyesë të NVM-ve në skemat e saj të bashkëfinancimit për t'i përmirësuar ato më tej. KIESA duhet t'i përdorë më mirë këto inpute për të mbushur boshllëqet në ofrimin e shërbimeve të mbështetjes së bizneseve, për të shënjestruar më mirë mbështetjen e ofruar dhe për të krijuar sisteme më efektive të ofrimit. Të bërit më shumë për të marrë parasysh rezultatet e analizës së nevojave të trajnimit do të ndihmonte KIESA-në dhe institucionet tjera relevante që të sigurojnë që programet dhe

iniciativat e SHMB përshtaten për karakteristikat dhe dinamikën e përfituesve mikro dhe NVM, si dhe për sektorin e industrisë të cilit i përkasin, dhe për fazën e tyre të zhvillimit dhe përvojën faktike në treg. Për më tepër, Kosova duhet gjithashtu të konsiderojë ftuarjen e një institucioni të pavarur për të kryer një vlerësim të hollësishëm të ofrimit të SHMB të saj, për të hedhur dritë mbi arsyen për pranimin e ulët të shërbimeve të saj nga NVM-të, dhe për të vlerësuar ndikimin e programeve të saj ekzistuese të SHMB kundrejt treguesve kyç të performancës.

- **Përmirësimi i pranimit të SHMB-ve nga NVM-të duke ridizajnuar skemat ekzistuese.** Duke pasur parasysh numrin e ulët të aplikimeve, KIESA duhet të konsiderojë ridizajnimin e procedurave të saj të aplikimit dhe bashkëfinancimit. Për shembull, fakti që përfituesit rimbursohen vetëm pas përfundimit të projektit mund të ndikojë që kompanitë mikro dhe ato të vogla me burime të pakta të zbrapsen dhe të mos aplikojnë. Në vend të kësaj, KIESA mund të shkallëzojë rimbursimin për të ofruar një transhe të parë pas pranimit zyrtar të NVM-së në skemë, dhe një transhe të dytë pas përfundimit të suksesshëm të projektit. KIESA gjithashtu do të mund të merrte parasysh përshtatjen e mbështetjes së bashkëfinancimit në varësi të madhësisë së ndërmarrjeve, duke bashkëfinancuar në këtë mënyrë një përqindje më të lartë të kostove për kompanitë mikro dhe të vogla. KIESA gjithashtu mund të bëjë më të lehtë aplikimin, për shembull duke hequr nevojën për ofrimin e dokumenteve zyrtare që do mund t'i siguronte vetë drejtpërdrejt nga institucionet relevante publike, siç janë certifikata e regjistrimit të biznesit, numri fiskal dhe certifikata tatimore dhe regjistrimi i falimentimit. Forcimi i bashkëpunimit me odat ekonomike për të ngritur vetëdijen e NVM-ve për SHMB-të në dispozicion do të paraqiste gjithashtu një mundësi shtesë për të rritur interesin e NVM-ve në to.
- **Ofrimi i një game të gjerë të SHMB-ve pa pagesë.** Shërbimet e ofruara nga institucionet publike janë një instrument i rëndësishëm për të siguruar qasjen e NVM-ve në informacione vendimtare, këshilla, trajnim dhe mentorim. Ndërsa KIESA ofron skema bashkëfinancimi për NVM-të, ajo nuk ofron në mënyrë të drejtpërdrejtë trajnime apo mentorime. Edhe pse ofrimi i SHMB-ve të bashkëfinancuara ndihmon në stimulimin e ofrimit të SHMB përmes sektorit privat, mbështetja ekskluzive në to mbartë rrezikun që SHMB-të të bëhen të paarrtshme për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, të cilat në përgjithësi nuk janë në gjendje të përballojnë tarifat e konsulencës private, edhe nëse ato bashkëfinancohen. Prandaj, KIESA duhet të plotësojë ofertën e saj të SHMB të skemave të bashkëfinancimit me shërbime këshillimore dhe trajnime të cilat ofrohen direkt nga stafi i saj dhe pa pagesë.
- **Futja e një mekanizmi për sigurimin e cilësisë për konsulentët dhe trajnuesit e sektorit privat** të përdorur nga NVM-të në kuadër të programeve të bashkëfinancuara të mbështetjes. NVM-të në Kosovë aktualisht mund të zgjedhin lirshëm konsulentët e sektorit privat që përdorin nën skemat e bashkëfinancimit të KIESA-s. KIESA duhet të konsiderojë futjen e një sistemi akreditimi për të siguruar që ofruesit e sektorit privat të kenë një nivel minimal të kërkuar të përvojës dhe kualifikimeve. Pas kësaj, do të mund të kufizonte mbështetjen e bashkëfinancimit të NVM-ve për konsulentët dhe trajnuesit e sektorit privat në ofruesit e akredituar. Kjo do të garantonte cilësinë e shërbimeve të ofruara, do të kishte një ndikim pozitiv në rritjen e NVM-ve dhe do të inkurajonte NVM-të të jenë më entuziaste rreth kërimit të përfitimeve nga SHMB-të e ofruara në mënyrë private.
- **Sigurimi se KIESA posedon burimet njerëzore të nevojshme për të rritur**

cilësinë e ofrimit të SHMB-ve. KIESA nuk ka një departament ligjor dhe personelit të saj shpesh i mungojnë aftësitë e nevojshme ligjore për të hartuar kontrata dhe dokumente të tjera ligjore në mënyrën më efektive. Stafi i saj po ashtu duhet të jetë i përgatitur mirë për sfidat dhe nevojat e ndërmarrjeve, në mënyrë që të jetë në gjendje të zhvillojë programe të përshtatura të promovimit të eksporteve për NVM-të që operojnë në sektorë të ndryshëm.

Prokurimi publik (Dimensioni 5b)

Kosova shënoi rezultatin e ponderuar prej 4.09 për këtë dimension (Tabela 15.12), që është rezultati i dytë më i mirë në rajon. Është gjithashtu një përmirësim në rezultatin e saj të vitit 2016 prej 3.5 (Figura 15.1).

Tabela 15.12. Rezultatet për Dimensionin 5b: Prokurimi publik

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Blloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT |
|--|---------------------------------------|---------------------------------------|-------------|-----------------|
| Dimensioni 5b: Prokurimi publik | Nën-dimensioni 5b.1: Prokurimi publik | Korniza rregullative dhe e politikave | 4.76 | 3.92 |
| | | Zbatimi | 4.28 | 4.05 |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 2.67 | 3.24 |
| | | Mesatarja e ponderuar | 4.09 | 3.86 |
| Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 5b | | | 4.09 | 3.84 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Akti bazë ligjor që rregullon prokurimin publik është Ligji për Prokurim Publik (LPP) i vitit 2011. LPP u ndryshua dy herë në vitin 2016, duke e përafuar kështu më shumë me *acquis* të BE-së. Në veçanti, neni 60A për sistemin e preferencave për kompani vendore u hoq në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ndryshimet e vitit 2016 në LPP ndryshuan dispozitat për tarifën e paguara nga operatorët ekonomikë të dëmtuar që ankohen kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese. Tarifën janë tani të barabarta me 1% të vlerës së parashikuar të kontratës ose, në disa raste, të ofertës, por jo më pak se 100 euro. Ndryshimi i vitit 2016 rriti shumën maksimale të tarifave në 5,000 euro. Aktivitetet për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik janë të detajuara në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik (2017-2021) dhe Planin e Veprimit (2017-2019) dhe të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP). Megjithatë, strategjia nuk parasheh ndonjë veprim që synon në mënyrë specifike NVM-të.

Sistemi i prokurimit publik bazohet në parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Autoritetet kontraktuese e kanë të ndaluar që të kryejnë ndonjë aktivitet të prokurimit në mënyrë të tillë që redukton ose eliminon konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomikë ose që diskriminon kundër ose në favor të një ose më shumë operatorëve ekonomikë. Qasja në prokurim publik është e hapur për operatorët ekonomikë, pavarësisht formës së tyre organizative: persona fizikë apo juridikë. Kërkesat për pjesëmarrje ose tenderët mund të paraqiten edhe nga një grup i operatorëve ekonomikë. Këtyre grupeve mund të mos u kërkohej që të adoptojnë ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin.

LPP nuk përfshin dispozita që lidhen në mënyrë specifike me NVM-të. Megjithatë, NVM-të përmenden qartë në dispozitat që mbështesin zbatimin e LPP, megjithëse vetëm në kontekstin e ndarjes së kontratave në lote. Kontratat publike mund të ndahen në lote

homogjene ose heterogjene. Udhëzimet operacionale sugjerojnë që, për të inkurajuar përfshirjen e NVM-ve në prokurim publik, kufizimi i numrit të loteve për të cilat mund të aplikohet duhet të jetë opsion i preferuar nëse ka shumë NVM potencialisht të interesuara në një prokurim të caktuar. Çdo kriter i përzgjedhjes i përdorur duhet të kufizohet vetëm në ato që sigurojnë që vetëm operatorët ekonomikë që posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike që nevojiten për të plotësuar kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen si të kualifikuar për të marrë një dhënie të kontratës ose një ftesë për tender. Çdo kërkesë dokumentacioni ose informacioni duhet të kufizohet në ato që i mundësojnë autoritetit kontaktues të verifikojë që operatori ekonomik përkatës, së pari, nuk i nënshtrohet përjashtimit nga procedura dhe, së dyti, nëse është e aplikueshme, plotëson kriteret minimale të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe kërkesat e dokumentacionit dhe informacionit duhet të jenë drejtpërsëdrejti relevante dhe në përpjesëtim me lëndën e kontratës përkatëse.

Kosova tashmë ka zbatuar disa iniciativa që janë me dobi për NVM-të të parashikuara në Direktivat e BE-së për Prokurim Publik të vitit 2014. Për shembull, qarkullimi minimal vjetor i operatorëve ekonomikë nuk duhet të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesat financiare duhet të shprehen në shifra dhe duhet t'i referohen më së shumti tre viteve të fundit financiare. Në raste të jashtëzakonshme, kur kërkohet një qarkullim minimal në një fushë specifike që mbulohet nga kontrata, ky qarkullim nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Si rregull i përgjithshëm, operatorët ekonomikë duhet të lejohen të përmbushin një kërkesë të tillë duke paraqitur, kur është relevante dhe e përshtatshme, një ose më shumë referenca të listuara në LPP. Megjithatë, nëse për ndonjë arsye valide operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatori mund të demonstrojë pozitën e tij ekonomike dhe financiare duke përdorur çdo dokument tjetër që konsiderohet si i përshtatshëm nga autoriteti kontraktues.

LPP po ashtu përmban rregulla për nënkontraktimin. Operatorët ekonomikë duhet të tregojnë në tenderin e tyre çdo pjesë të kontratës që ata synojnë ta nënkontraktajnë tek palët e treta dhe çdo nënkontraktor i propozuar. Secili nënkontraktor i propozuar duhet të përmbushë kërkesat e kualifikueshmërisë dhe të paraqesë dëshmi se i plotëson kërkesat e kualifikueshmërisë. LPP nuk kufizon pjesën e nënkontraktimit të lejuar, por sipas udhëzimeve operacionale nënkontraktimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës. Autoritetet kontraktuese mund të ofrojnë pagesa direkte për nënkontraktorët. Operatori ekonomik duhet të njoftojë autoritetin kontraktues për çdo ndryshim në planet e nënkontraktimit të bëra pas paraqitjes së tenderit. Autoriteti kontraktues mund të refuzojë çdo nënkontraktorë të propozuar, përveç në rastet kur i plotësojnë kushtet e kualifikueshmërisë.

KRPP është organi qendror i prokurimit publik përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Kompetencat e tij janë të përkrahura në LPP dhe përfshijnë monitorimin e prokurimit; zhvillimin dhe shpërndarjen e manualeve të prokurimit, udhëzimeve dhe modeleve standarde; ofrimin e mbështetjes dhe këshillimit të akterëve të prokurimit; ngritjen e vetëdijes mbi rregulloret e prokurimit publik; dhe mbikëqyrjen e funksionimit të sistemit të prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është organi shqyrtues i shkallës së parë për ankesat në lidhje me prokurimin publik. Dispozitat për mjetet juridike në dispozicion për operatorët ekonomik kundër vendimeve të marra nga autoritetet kontraktuese përputhen në masë të madhe me kërkesat e BE-së, edhe pse disa mospërputhje vazhdojnë të mbeten, si ato që lidhen me ndëshkimet alternative. Autoriteti i OSHP-së për të vendosur një dënim prej 5,000 euro për një ankues nëse ankesa cilësohet të jetë e pabazuar mund

të konsiderohet si një kufizim në qasjen e ankuesit në drejtësi. Megjithatë, me sa duket OSHP nuk e përdorë këtë opsion në praktikë.

Rruga përpara për dimensionin 5b

Kosova ka një kornizë solide institucionale dhe rregullatore në fushën e prokurimit publik që parasheh një numër zgjidhjesh relevante për NVM-të. Në rrugën përpara, ajo duhet të vë një theks më të madh në pikat e mëposhtme:

- **Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar me rregullat e BE-së dhe praktikatat e mira ndërkombëtare. Në veçanti:**
 - Të heqë kufizimet në lidhje me rekursin në nënkontraktimin, si ato në lidhje me përqindjen maksimale të kontratës së prokurimit që mund t'i nënshtrohet nënkontraktimit.
 - Të përshtatë dispozitat me dispozitat e Direktivave të BE-së për Mjete Juridike.
- **Zvogëlimi i mëtejshëm i barrëve administrative të përfshira në pjesëmarrjen në prokurime publike.** Në veçanti, dispozitat ligjore duhet të parashohin se dokumentet mbështetëse duhet të kërkohen vetëm nga ofertuesit, ofertat e të cilëve janë vlerësuar si më të favorshmet. Ofertuesve nuk duhet t'u kërkohet të dorëzojnë një deklaratë ku konfirmohet se ata plotësojnë kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktues dhe duhet të jenë në gjendje të ofrojnë dëshmi dokumentare nëse kjo kërkohet nga autoriteti kontraktues. Futja e detyrueshme e prokurimit elektronik, në veçanti për dorëzimin e tenderëve dhe kërkesave për pjesëmarrje, në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE-së për Prokurim Publik të vitit 2014, do të reduktonte edhe kostot e ofertimit, duke lehtësuar kështu edhe qasjen e NVM-ve në kontrata publike.
- **Rritja e përdorimit të kriterëve jo të bazuara në çmim për dhënien e kontratave** për t'i mundësuar blerësve publik që të marrin vlerën më të mirë për para. Në veçanti, dhëniet e kontratave duhet të bazohen në ofertën më të favorshme ekonomikisht. Institucionet e prokurimit publik duhet të lehtësojnë zbatimin kriterëve jo të bazuara në çmim duke mbështetur autoritetet kontraktuese me manuale, udhëzues, udhëzime dhe shembuj të praktikave të mira.
- **Përmirësimi i monitorimit të sistemit të prokurimit publik, dhe vënia e një fokusi të veçantë në mbledhjen e të dhënave, vlerësimin e pjesëmarrjes së NVM-ve në prokurim publik dhe analizimin e pengesave me të cilat përballen NVM-të** në qasjen në tregjet e prokurimit publik. Këto përfshijnë kostot e qasjes në mbrojtje ligjore (p.sh. për të kundërshtuar vendimet e autoriteteve kontraktuese tek organet e pavarura shqyrtuese).

Qasja në financa për NVM-të (Dimensioni 6)

Kosova ka bërë progres në fusha të caktuara kyçe që lehtësojnë qasjen në financa. Me një rezultat të përgjithshëm prej 3.33, Kosova renditet në gjysmën e poshtme të rajonit, ndonëse praktikisht barazi me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Malin e Zi (Tabela 15.13). Reformat e fundit, sidomos ndryshimet në ligjin e falimentimit dhe lansimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, kanë përmirësuar rezultatin e Kosovës për kornizën ligjore dhe rregullatore dhe financimin bankar.

Tabela 15.13. Rezultatet për Dimensionin 6: Qasja në financa për NVM-të

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Blloku tematik | Mesatarja e BPT | | |
|---|---|--|-----------------|-------------|-------------|
| | | | Kosova | | |
| Dimensioni 6: Qasja në financa për NVM-të | Nën-dimensioni 6.1: Korniza ligjore dhe rregullative | Të drejtat e kreditorit | 3.55 | 4.20 | |
| | | Regjistrat | 4.92 | 4.58 | |
| | | Byrotë për informacion kreditor | 4.22 | 4.55 | |
| | | Rregulloret bankare | 3.50 | 3.79 | |
| | | Bursa | 1.00 | 2.93 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.67 | 4.14 | |
| | Nën-dimensioni 6.2: Financimi bankar | Praktikat dhe kushtet e kreditimit bankar | 2.08 | 2.02 | |
| | | Skemat e garancive kreditorë | 3.00 | 2.30 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.05 | 2.67 | |
| | Nën-dimensioni 6.3: Financimi jo-bankar | Institucionet mikrofinanciare | 4.67 | 3.57 | |
| | | Lizingu | 2.54 | 2.84 | |
| | | Faktoringu | 1.50 | 2.45 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.90 | 2.95 | |
| | Nën-dimensioni 6.4: Ekosistemi i kapitalit sipërmarrës | Korniza ligjore | 2.11 | 2.32 | |
| | | Hartimi dhe zbatimi i aktiviteteve të qeverisë | 2.29 | 2.48 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 1.00 | 1.48 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 1.97 | 2.22 | |
| | Nën-dimensioni 6.5: Edukimi financiar | Planifikimi, hartimi dhe zbatimi | 2.89 | 2.44 | |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 1.00 | 1.19 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.51 | 2.19 | |
| | Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 6 | | | 3.33 | 3.53 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Korniza ligjore dhe rregullatore

Kosova ka një kornizë të mirë-rregulluar ligjore për kredituesit e siguruar, ku reformat e kohëve të fundit i kanë përafëruar më tej ato me praktikën më të mira të etabluara: një ligj i vitit 2016/2017 që prioritetizon pagimin dhe reformon procedurat më të gjera riorganizative ka thjeshtuar procesin e falimentimit dhe ka kontribuar që Kosova të shënojë një rritje të jashtëzakonshme në rezultatin e të *Bërit Biznes* të Bankës Botërore (Banka Botërore, 2017^[17]).

Në fushën e rregullimit bankar, zbatimi i Bazel II është duke vazhduar. Përderisa zbatimi i treguesve të leverazhit të kërkuar sipas Bazel është priorizuar brenda harmonizimit më të gjerë, nuk ka dëshmi se është përcaktuar ndonjë kornizë e dedikuar kohore. Duke pasur parasysh përdorimin nga Kosova të euros, huamarrësit NVM të Kosovës janë më pak të ekspozuar ndaj rreziqeve të këmbimit valutor.

Një kadastër është në dispozicion dhe online - i ndarë në një hartë gjeografike dhe pjesën tekstuale që tregon pronësinë individuale, ku harta është e qasshme për publikun e gjerë ndërsa kjo e fundit kufizohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave vetëm në organet e autorizuara si bankat. Megjithatë, në praktikë, përdorimi i tij pengohet nga prevalenca e ndërtimeve joformale dhe dokumenteve të zhdukura që nga vitet e 90-ta. Sistemi i regjistrimit për të drejtat e sigurisë mbi pasuritë e luajtshme është po ashtu online dhe i qasshëm publikisht, edhe pse kjo kërkon një kycje të personalizuar, pas së cilës përdoruesit mund të regjistrojnë pengjet edhe përmes sistemit. Banka Qendrore e Kosovës gjithashtu mbikëqyr një sistem të informacionit kreditor, dhe e drejta e një individit për t'iu qasur informacionit të tyre është e mbrojtur me ligj. Ky sistem u rishikua në qershor të vitit 2017 dhe tani përfshin informacione të drejtpërdrejta për dhe nga palët përkatëse të interesit, si dhe analiza të të dhënave në shkallë më të gjerë për institucionet. Në Kosovë ende nuk ka treg kapitali.

Burimet e financimit të jashtëm për NVM-të (financimi bankar, financimi jo-bankar dhe kapitali sipërmarrës)

Kreditimi bankar për NVM-të është shumë i përhapur në Kosovë, ku sektori përbën 64% të gjithëj kredive aktive nga bankat komerciale - pothuajse dyfishi i mesatares rajonale prej 34% (FMN, 2016_[32]). Përderisa baza e përgjithshme mund të jetë relativisht e ulët - raporti i Kosovës i kredive ndaj BPV-së është ndër më të ulët në rajon me 40% - sektori bankar gëzon likuiditet të lartë (me kreditë joperformuese nën 3%) dhe një rritje vjetore në totalin e asetëve prej 6% deri në tremujorin e dytë të vitit 2018.

Në sferën e skemave të mbështetjes qeveritare për qasje të NVM-ve në financa, Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) punon me bankat, si dhe institucionet mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare, duke garantuar deri në 50% të principalit të kredisë. I themeluar në vitin 2016, fondi raportoi një portfolio prej pothuajse 1,550 kredive për një shumë totale të miratuar të kredive prej 59 milionë euro deri në korrik të vitit 2018, krahasuar me 350 kredi dhe një shumë të kredive prej 16 milionë euro në vitin 2017, duke sugjeruar kërkesë më të madhe për këtë lloj të mbështetjes financiare (FKGK, 2018_[33]). Sidoqoftë, këta numra prapë se prapë paraqesin vetëm një pjesëz të vogël të tregut më të gjerë dhe bankat duket sikur hezitojnë sa i përket përdorimit të fondit për shkak të tarifës aktuale të sheshtë prej 2% që aplikohet për çdo institucion të regjistruar. Nga perspektiva e një NVM-je, FKGF-ja nuk ofron shërbime plotësuese, si asistencë teknike, këshilla ose programe trajnimi dhe i mungon monitorimi i pavarur dhe pjesëmarrja e sektorit privat. Mbetet kryesisht i financuar nga donatorët, që po ashtu caktojnë katër nga shtatë anëtarët e bordit.

Kosova ka një treg të mirë-zhvilluar për mikrofinancim, ku kishte 17 institucione mikrofinanciare (IMF) që operonin në vitin 2017. Ndërsa një dyfishim i fitimeve në gjithë sektorin në vitin 2017 sugjeron një qëndrueshmëri në rritje, sektori vazhdon të përballet me kufizimet e operimit si organizata joqeveritare (OJQ), me përjashtim të një IMF-je që është e regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Ndihej për të transformuar statusin e tyre ligjor është një prej sfidave më të mëdha të ardhshme të

politikave në këtë sferë. Statistikat e vitit 2017 të bankës qendrore tregojnë se kreditë për ndërmarrjet kanë shënuar një rritje të konsiderueshme nga viti në vit prej mbi 40%, ndonëse kjo mund të jetë edhe për shkak të rritjes në formalizimin e klientëve të regjistruar si ndërmarrje (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2017_[34]). Një projektligj i ri që synonte zgjerimin e aktiviteteve të IMF duke mundësuar lëshim të parave elektronike dhe shërbime të pagesave ndërkombëtare, ndërkohë duke e dyfishuar ekspozimin aktual maksimal ndaj një klienti të vetëm, u publikua për konsultim publik në vitin 2017.

Lizingu është një burim në rritje i financimit për NVM-të në Kosovë, ku të dhënat e muajit korrik 2018 tregojnë shumat totale të mbetura prej 33.2 milionë euro krahasuar me 26 milionë euro vitin e kaluar (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2018_[35]). Lizingu është rregulluar që nga miratimi i një ligji të dedikuar në vitin 2009 që mbulon të gjitha fushat që konsiderohen gjerësisht të jenë praktikë më e mirë, duke përfshirë përkufizime dhe rregulla të qarta mbi riposedimin. Lizingu i pajisjeve (në vend se vetëm i automjeteve) ofrohet gjithashtu dhe statistikisht zyrtare zbërthejnë pranimin sipas kategorive. Në fushën e ligjit të faktoringut, Banka Qendrore ka bashkëpunuar me BERZH-in në hartimin e rregulloreve të dedikuara, duke i miratuar ato formalisht në tetor të vitit 2018. Këto rregullore, të përafuara me praktikë më të mira ndërkombëtare, përshkruajnë llojet e faktoringut, kontratat që kërkohen, dhe raportimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të faktoringut.

Aktivitetet e kapitalit sipërmarrës janë të rregulluara në parim, edhe pse asnjë investim domethënës i kapitalit sipërmarrës nuk është bërë ende në ekonomi dhe nuk ka dëshmi që do të sugjerojnë një rishikim të strukturuar të aktiviteteve të kapitalit sipërmarrës në rrugën përpara. Për dallim nga kjo, “engjëjt” e biznesit janë relativisht aktiv në Kosovë, kryesisht duke përfshirë investime më të vogla por me një normë të krahasueshme me ekonomitë më të mëdha. Me një rrjet aktiv, Kosova ishte dëshmitare e 15 investimeve të veçanta në vitin 2017 (krahasuar me 19 në Greqi dhe 16 në Slloveni, për shembull), me një vëllim kumulativ prej 600,000 euro, krahasuar me 2.4 milionë euro në Greqi dhe 2.5 milionë euro në Slloveni (EBAN, 2018_[36]).

Edukimi financiar

Mjedisi mbështetës për edukimin financiar në Kosovë është i ngjashëm me shumicën e ekonomive në rajon: kurset e trajnimit organizohen nga organet qeveritare, por pa një kornizë gjithëpërfshirëse të monitorimit dhe vlerësimit. Banka Qendrore e Kosovës lansoi zyrtarisht një Program të Edukimit Financiar në tetor të vitit 2017 dhe organizon kurse të ndryshme trajnimi brenda kësaj kornize. Këto kurse synojnë kryesisht popullsinë më të gjerë, duke përfshirë ngritjen e vetëdijes për nxënësit e shkollave filllore dhe të mesme për rëndësinë e kujdesit financiar, kursimeve dhe një hyrje në bazat e financave personale. Megjithatë, siç ndodh shpesh në këtë fushë, programi i mungon një kornizë e formalizuar e monitorimit ose vlerësimit të ndikimit.

Rruga përpara për dimensionin 6

Kosova ka bërë përpertime të dukshme për të mbështetur qasjen e NVM-ve në financa, edhe pse reformat legjislativë shtesë do të mund të ndihmonin shumë për të zgjeruar burimet financiare dhe për të siguruar që mekanizmat e mbështetjes qeveritare kanë efekt maksimal. Hapa të tjerë të dobishëm përfshijnë:

- **Rritja dhe rishikimi i FKGK.** Përderisa themelimi i fondit ka qenë një hap i rëndësishëm, ai ka hapësirë të madhe për t'u rritur. Një rishikim i atraktivitetit të tij për bankat - duke përfshirë modelin e tij të caktimit të çmimeve - si dhe një vlerësim formal i performancës së tij, do të ndihmonin në rritjen e efektivitetit të

tij. Zgjerimi i FKGK për të mbuluar edhe IMF-të do të zgjeronte shtrirjen e tij edhe tek ndërmarrjet mikro, që janë grupi më pak i shërbyer nga akterët financiarë në treg. Përveç kësaj, përfshirja e mbështetjes teknike dhe cilësore dhe skemave të trajnimit për huamarrësit mund të jetë një hap tjetër i suksesshëm për të rritur shtrirjen e tij.

- **Futja e legjislacionit të planifikuar të faktoringut dhe të faktoringut të kundërt dhe konsiderimi i një rishikimi të kapitalit sipërmarrës.** Në fushën e financimit jobankar, futja e ligjit të planifikuar të dedikuar të faktoringut mund të prezantojë një burim tjetër të kapitalit për NVM-të, veçanërisht duke zbutur pengesat e rrjedhës së parasë së gatshme.

Ngjashëm, një rishikim gjithëpërfshirës i rregulloreve ekzistuese të kapitalit sipërmarrës, dhe reformat pasuese që inkurajojnë aktivitetet e fondit, mund të kanalizojnë investime direkte shtesë drejtë NVM-ve të Kosovës, veçanërisht duke marrë parasysh popullsinë e saj të madhe të diasporës. Inkurajimi i akseleratorëve për të përgatitur bizneset start-up për investimet e kapitalit sipërmarrës mund të rrisin edhe mundësitë e investimit në atë fushë.

- **Formalizimi i mbështetjes së edukimit financiar.** Futja e një kornize të kodifikuar të vlerësimit për përpjekjet e qeverisë për edukim financiar, duke përfshirë tregues të vendosur të performancës për grupe të ndryshme demografike të synuara - nga fëmijët e shkollës fillore e deri tek ndërmarrësit ekzistues - do të mundësonte rregullimin dhe përshtatjen e këtyre skemave për të siguruar shtrirje maksimale dhe efektivitet.

Standardet dhe rregulloret teknike (Dimensioni 7)

Performanca e Kosovës në fushën e standardeve dhe rregulloreve teknike ka stagnuar që nga vlerësimi i fundit. Me një rezultat prej 3.60, ajo renditet e dyta në mesin e ekonomive më të vlerësuara (Tabela 15.14). Ndonëse është arritur progres i caktuar në koordinimin e përgjithshëm dhe masat e përgjithshme për infrastrukturën e cilësisë, Kosova është ende në fazat e hershme të përgatitjes përkitazi me përafrimin me *acquis* të BE-së për lëvizjen e lirë të mallrave.

Tabela 15.14. Rezultati për Dimensionin 7: Standardet dhe rregulloret teknike

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Bloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT |
|--|--|---|-------------|-----------------|
| Dimensioni 7: Standardet dhe rregulloret teknike | Nën-dimensioni 7.1: Koordinimi i përgjithshëm dhe masat e përgjithshme | | 2.75 | 3.12 |
| | | Rregulloret teknike | 4.13 | 3.87 |
| | | Standardizimi | 3.88 | 3.97 |
| | Nën-dimensioni 7.2: Harmonizimi me <i>acquis</i> të BE-së | Akreditimi | 4.62 | 4.53 |
| | | Vlerësimi i konformitetit | 3.60 | 3.65 |
| | | Metrologjia | 3.94 | 4.47 |
| | | Mbikëqyrja e tregut | 3.80 | 4.43 |
| | | Mesatarja e ponderuar | 3.99 | 4.15 |
| | Nën-dimensioni 7.3: Qasja e NVM-ve në standardizim | Ngritja e vetëdijes dhe informacioni | 3.50 | 4.24 |
| | | Pjesëmarrja e NVM-ve në zhvillimin e standardeve | 2.50 | 2.57 |
| | | Mbështetje financiare për NVM-të | 1.80 | 2.39 |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.60 | 3.07 |
| | | Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 7 | | 3.60 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Koordinimi i përgjithshëm dhe masat e përgjithshme

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është përgjegjëse për koordinimin e infrastrukturës së cilësisë dhe harmonizimin e legjislacionit teknik me *acquis* të BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Divizioni i MTI-së për Infrastrukturën e Cilësisë ka zhvilluar një strategji për infrastrukturën e cilësisë në Kosovë si pjesë të Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022, me objektiva të lidhur me secilën "shtyllë" të infrastrukturës së cilësisë. Megjithatë, shumicës së aktiviteteve të planifikuara u mungojnë treguesit për të matur performancën.

Kosovës i mungon një portal i caktuar për t'i ofruar informacionet relevante NVM-ve që do të dëshironin të eksportonin në Tregun e Vetëm të BE-së. Aktualisht, ndërmarjet mund të gjejnë disa informata (statistika të eksportit, ngjarje të eksportit, etj.) në faqet e internetit të MTI-së dhe KIESA-s, por informacioni nuk është i përshtatur për NVM-të dhe nuk është specifik për Tregun e Vetëm të BE-së. Edhe pse Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat parashih krijimin e një pike të vetme kontakti për tregtinë në shërbime, asnjë iniciativë e tillë nuk duket të jetë në listë për tregtinë e produkteve.

Harmonizimi me *acquis* të BE-së

Numri i rregulloreve teknike që transpozojnë direktivat e BE-së është rritur gjatë periudhës referuese. Në vitin 2017, për shembull, janë transpozuar direktivat e BE-së për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë, si dhe për etiketimin dhe shënjinimin e produkteve të tekstit. Ligji i ri për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësimin e Konformitetit (Republika e Kosovës, 2018_[37]) është miratuar në maj të vitit 2018. Miratimi i rregulloreve të reja teknike, si për pajisjet me gaz, është planifikuar gjithashtu sipas Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022 dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së si dhe zbatimi i rregulloreve tashmë të miratuara, duke përfshirë për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë.

Ligji i ri për Standardizimin, i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2018, është përafër me tej me *acquis* të BE-së. Tani vendos kornizën për diversifikimin e shërbimeve të ofruara nga Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS) tek palët e interesit. Megjithatë, AKS është ende organi i vetëm për zhvillimin e standardeve në rajonin e BPT që nuk është anëtare e plotë ose anëtare e afiliuar e Komitetit Evropian për Standardizim/Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CEN/CENELEC). Ajo ka kryer një analizë të nevojave për anëtarësim në CEN/CENELEC, megjithëse me objektivin pasues të pjesëmarrjes në Asamblenë e Përgjithshme të CEN/CENELEC deri në vitin 2020, se sa anëtarësimin e vërtetë. AKS gjithashtu ka nënshkruar një marrëveshje licencimi në vitin 2017 me CEN/CENELEC për qasje të drejtpërdrejtë në standardet e BE-së.

Kosova nuk zhvillon standardet e veta por vetëm miraton standarde të BE-së. Ajo ka shënuar progres, duke miratuar 650 standarde evropiane vetëm në vitin 2017. Megjithatë, ajo ka miratuar vetëm rreth gjysmën e standardeve evropiane në total. Kapaciteti administrativ i AKS-së mbetet në mënyrë kritike i ulët, duke penguar atë që të rrisë përpjekjet për miratim. Në vitin 2018, kishte vetëm shtatë punonjës të përhershëm. Për më tepër, nuk ka as buxhetin e vetë e as llogari bankare. Mungesa e një funksioni të tregtisë elektronike e pengon AKS-në që të shesë standarde online. Për më tepër, rrjedhat e saj të kufizuara të të hyrave kanalizohen drejtpërsëdrejti tek buxheti i shtetit, duke penguar çdo stimul për t'u angazhuar në aktivitete shtesë të shtimit të të hyrave.

Kosova ende nuk ka një përkufizim sistematik të nevojave kombëtare të infrastrukturës për vlerësimin e konformitetit (OECD, 2018_[10]). Ligji i ri për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësimin e Konformitetit sjell procedurat e vlerësimit tërësisht në përputhje me Vendimin 768/2008 EC mbi një kornizë të përbashkët për produktet e marketingut. Ligji gjithashtu miraton parimet e zbatuara në legjislacionin e harmonizuar evropian, d.m.th. prezumimin e konformitetit dhe mungesën e standardeve të detyrueshme. Edhe pse *acquis* më i fundit i BE-së është transpozuar në një numër fushash, organet e vlerësimit të konformitetit (OVK-të) mbeten ende për t'u përgatitur për akreditim për të përmirësuar nivelin e tyre të kompetencave dhe për të arritur status të qëndrueshëm të organeve të caktuara. Aktualisht, në ekonomi janë vetëm 38 OVK të akredituara - 30 për testim dhe 8 për inspektim. Shërbimet e vlerësimit të konformitetit nuk janë në dispozicion për sektorë të caktuar, si p.sh. për ashensorë dhe pjesë të ashensorëve. Prandaj, NVM-të që operojnë në disa sektorë detyrohen të kërkojnë ato shërbime jashtë vendit. Akreditimi i OVK-ve të ri mbetet një çështje madhore për organin kombëtar të akreditimit, Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës, e cila aktualisht ka të punësuar vetëm tre vlerësues. Kohëve të fundit, mungesa e stafit të kualifikuar nënkuptonte se nuk mund të nënshkruante Marrëveshjen Shumëpalëshe të EA-së për akreditimin e laboratorëve testues nga Bashkëpunimi Evropian për Akreditim (EA). Kosova mbetet anëtare e asociuar e EA-së, dhe është po ashtu anëtare e Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit dhe anëtare e asociuar e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Akreditimit të

Laboratorëve.

Sistemi i metrologjisë në Kosovë është në fazat e hershme të përgatitjes për lëvizjen e lirë të mallrave. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës është funksionale dhe ka 17 punonjës të punësuar. Megjithatë, i mungon stafi i kualifikuar në fushat e praktikave të verifikimit dhe kalibrimit, si në fushën e metrologjisë industriale ashtu dhe asaj ligjore (Zyra e BE-së në Kosovë, 2018_[38]). Për më tepër, laboratorët metrologjikë nuk furnizohen në mënyrë adekuate me pajisjet relevante të metrologjisë.

Në vitin 2017, u përgatitën akte të reja ligjore për të transpozuar direktivat për instrumentet joautomatike të peshimit, para-paketimin dhe shishet enë matëse dhe janë në pritje të miratimit në parlament. Aktualisht, agjencia e metrologjisë nuk është mirë e integruar në sistemet evropiane të metrologjisë por Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat për periudhën 2018-22 cakton një qëllim të anëtarësimit në Shoqatën Evropian të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë, Organizatën Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore dhe Byronë Ndërkombëtare të Peshave dhe Matjeve deri në vitin 2020.

Mbikëqyrja e tregut është sfiduar nga një koordinim i dobët ndërinstitucional i aktiviteteve, në veçanti ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale. Megjithatë, koordinimi pritet të përmirësohet pasi që inspektorët lokalë janë duke u transferuar tek autoritetet qendrore të mbikëqyrjes së tregut nën Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Për më tepër, reforma e planifikuar e mbikëqyrjes së tregut dhe aktiviteteve të përgjithshme të inspektimit për vitin 2019 parasheh një rritje të numrit të inspektorëve të mbikëqyrjes së tregut. Numri i inspektimeve të sigurisë së produkteve u ul pak në vitin 2017 në 266 inspektime, krahasuar me 273 në vitin 2015.

Qasja e NVM-ve në standardizim

Kosova ka të vendosura vetëm masa bazë për të lehtësuar qasjen e NVM-ve në standardizim. Për të ofruar informacione mbi standardet dhe për të ngritur vetëdijen për përfitimet e tyre, AKS organizoi pesë aktivitete promovuese në vitin 2017 në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës. Disa prej këtyre aktiviteteve u organizuan në universitete. AKS po ashtu ofron udhëzues praktik për përfitimet e përdorimit të standardeve dhe standardizimit, por ato shpërndahen vetëm si kopje fizike dhe nuk ka versione online në dispozicion. Ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet AKS-së dhe Odës Ekonomike të Kosovës për të ofruar informacione të përditësuara mbi standardet për NVM-të, megjithëse në baza ad-hoc. Oda Ekonomike e Kosovës po ashtu organizon takime rajonale në zyrat e saj në shtatë rajone për të prezantuar standardet e reja dhe për të këshilluar NVM-të se si t'i zbatojnë ato. Përveç kësaj, së bashku me Shoqatat Kosovare të Biznesit, ajo merr pjesë në Këshillin Profesional të Standardizimit si organi këshillëdhënës i Agjencisë Kosovare të Standardizimit (Kutia 15.5).

Kutia 15.5. Këshilli Profesional i Standardizimit: Drejtë përfshirjes më të mirë të sektorit privat në standardizimin kombëtar

Kosova themeloi Këshillin Profesional të Standardizimit (KPS) në vitin 2018 me qëllim të sigurimit të një përfaqësimi më të balancuar dhe përfshirjes së të gjithë akterëve në aktivitetin kombëtar të standardizimit. Edhe pse ekzistojnë organe të ngjashme këshillëdhënëse në ekonominë e tjera të BPT, ato janë zakonisht në nivel ekspertësh dhe nuk përfshijnë përfaqësues joqeveritarë dhe të biznesit. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Nr. 08/2018 përcakton rregulloren e punës, kompetencat dhe funksionimin e KPS. Këshilli përbëhet nga nëntë anëtarë, duke përfshirë

katër përfaqësues të ministrive të linjës, dy OJQ, një përfaqësues të komunitetit shkencor, një nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe një nga Shoqatat Kosovare të Biznesit. KPS shërben si një organ këshillëdhënës i Agjencisë Kosovare të Standardizimit me kompetencat e mëposhtme:

- shqyrtimi i planeve standarde të punës, si dhe analizimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që lidhen me zbatimin e tyre
- lëshimi i rekomandimeve, promovimi i standardizimit, dhe krijimi i iniciativave të mbështetjes për të kryer aktivitete të standardizimit
- mbështetja e AKS-së në përmbushjen e kërkesave për pranim në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit.

Për të inkurajuar pjesëmarrjen në këshill, të gjitha shpenzimet e takimit mbulohen nga Agjencia Kosovare e Standardizimit dhe anëtarët e KPS kanë të drejtë në një zbritje prej 50% kur marrin standardet.

Burimi: Republika e Kosovës (2018^[39]), *Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit*, <https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/E6DD3362-7916-4956-B05A-E5B803776984.pdf>.

Siç u përmend më lart, AKS nuk zhvillon standarde kombëtare; për momentin, vetëm miraton standarde të BE-së. Kosova nuk ka futur ndonjë masë financiare apo tjetër për të inkurajuar përfshirjen e NVM-ve në komitetet teknike që analizojnë prioritetet për miratimin e standardeve të BE-së dhe që udhëheqin procesin e përgjithshëm të miratimit. Për më tepër, kostot e udhëtimit të përfaqësuesve të NVM-ve në komitete nuk mbulohen, dhe nuk ka mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre. Megjithatë, pjesëmarrja në takimet e komiteteve teknike mbetet e lirë, dhe AKS formalisht fron të gjitha NVM-të për ta bërë këtë në faqen e saj të internetit.

Zbritje deri në 50% për blerje të standardeve ofrohen për anëtarët e komiteteve teknike, por nuk ka masa mbështetëse për popullacionin e përgjithshëm të NVM-ve për të blerë standarde. Në aspektin e mbështetjes financiare për zbatimin e standardeve, Kosova ka futur një skemë vauçer për certifikimin e produkteve, por në vitin 2017 vetëm një NVM në listën paraprake të përfituesve është shpallur si e kualifikuar.

Rruga përpara për dimensionin 7

Përkundër progresit të Kosovës në miratimin e një kornize legjislative për infrastrukturën e cilësisë dhe transpozimin e rregulloreve teknike të BE-së, sfidat kryesore mbetet të adresohen përmes masave të mëposhtme:

- **Zgjerimi i kapacitetit të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS).** Me rreth 9500 standarde evropiane të miratuara deri në fund të vitit 2017, Kosova mbetet prapa të gjitha ekonomive të BPT në përpjekjet e saj për transpozim. Shkalla e saj aktuale e miratimit të standardeve evropiane, në rreth 50%, duhet të rritet në 80% që Kosova të arrijë një nga kërkesat për anëtarësim të plotë në organizatat evropiane CEN/CENELEC. Për të përshpejtuar miratimin e standardeve evropiane, duhet të forcohet kapaciteti institucional i AKS-së. Aktualisht, AKS nuk ka buxhet të vetin ose llogari bankare dhe të gjitha të hyrat që mbledh kanalizohen në buxhetin kombëtar. Për më tepër, neni 12 i Ligjit për Standardizim, i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2018, thekson se buxheti kombëtar dhe fondet e donatorëve janë burimet e vetme të financimit për AKS-në. Kjo dobëson më tej stimujt për të rritur të hyrat nga tarifat e anëtarësimit, shitjet e standardeve ose shitjet e shërbimeve të tjera. Mbajtja e të hyrave që

mbliiden nga AKS brenda institucionit do të rriste nivelin e saj të pavarësisë financiare dhe do të inkurajonte diversifikimin e shërbimeve për palët e interesit. Për më tepër, ekziston një nevojë për të rritur numrin e saj të komiteteve teknike (të cilat aktualisht janë 19) dhe për të pajisur AKS-në me burimet njerëzore të nevojshme për të rritur kompetencën dhe efikasitetin e saj për miratimin e standardeve evropiane.

- **Përmirësimi i mbështetjes për NVM-të për të zbatuar standardet.** NVM-të shpesh nuk kanë kohën, burimet njerëzore apo financiare për t'u angazhuar në zbatimin e standardeve. Me 650 standarde të BE-së të miratuara nga Kosova vetëm në vitin 2017, NVM-të mund po ashtu të kenë vështirësi që të identifikojnë standardet relevante për to - veçanërisht nëse nuk janë të përfshira siç duhet në proces. Megjithatë draft Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022 parasheh organizimin e sesioneve informative dhe përgatitjen e materialeve promovuese mbi rolin e standardeve në ekonomi, ekziston një mungesë e masave të përshtatura për të komunikuar më mirë miratimin e standardeve të reja për NVM-të. Prandaj, AKS-ja mund të organizojë kampanja dhe të përgatisë buletine informative që synojnë sektorë specifikë të industrisë dhe që marrin parasysh karakteristikat dhe sfidat e NVM-ve që operojnë në ata sektorë. Udhëzuesit e zhvilluar në Itali nga *Confartigianato Imprese* janë një shembull i mirë (Kutia 15.6). Kosova duhet të përmirësojë edhe ofrimin e mbështetjes financiare për NVM-të për zbatimin e standardeve duke vlerësuar së pari skemën aktuale vaçer për certifikimin e produkteve. Meqenëse vetëm një NVM është shpallur si e kualifikuar për të përfituar nga skema në vitin 2017, autoritetet kosovare duhet të hetojnë nëse procesi i aplikimit për skemën vaçer është shumë kompleks dhe i rëndë për NVM-të, ose nëse thjeshtë nuk është promovuar mirë. Për më tepër, qeveria duhet të krijojë instrumente të reja financiare për të mbështetur NVM-të në zbatimin e standardeve, siç janë grantet vjetore për NVM-të që operojnë në sektorët prioritarë.

Kutia 15.6. *Confartigianato Imprese*: Udhëzimet e NVM-ve për zbatimin e markës CE

Confartigianato Imprese është një shoqatë tregtare italiane që përfaqëson interesat e artizanëve, zanateve dhe NVM-ve italiane. Shumë NVM përballen me probleme me zbatimin e direktivave të Qasjes së Re¹, në këtë rast, Direktiva e Produkteve Ndërtimore, dhe standardet e ndërlidhura. Këto hutojnë shumë punonjës. Për të zgjidhur këtë problem, *Confartigianato* ka themeluar një Grup Punues Teknik ad-hoc për markimin CE, duke punuar së bashku me partnerët territorial me përvojë që kanë qenë tashmë duke zbatuar standardet për një kohë të gjatë. Ky grup ka zhvilluar udhëzimet për tri lloje të produkteve që janë kryesisht me interes për ndërmarrjet e vogla artizanale:

- dyert dhe portat industriale, komerciale dhe/ose të garazheve (standardi: EN 13241-1)
- kanata errësuese dhe grila të dritareve (EN 13659)
- dritare dhe porta (EN 14351-1)

Publikimet përfshijnë:

- udhëzues që adresojnë temat që mbulojnë udhëzimet teknike e deri te instruksionet konkrete të operimit
- një dokument me pyetje të shpeshta (FAQ) në të cilin shpjegohen disa prej çështjeve më të rëndësishme në mënyrë që ndërmarrësit artizanale të mund të kuptojnë lehtësisht tri metodat e mundshme të markimit CE
- raporte që përmbajnë përshkrime të praktikave më të mira bazuar në shërbimet e konsulencës për markimin CE të ofruar nga disa shoqata territoriale

Manualet standarde për kontrollimin e prodhimit të fabrikave që u ofrojnë prodhuesve këshilla për kontrollimin e procesit të prodhimit, duke u mundësuar atyre garantimin se

¹Bashkimi Evropian miraton legjisllacionin (Direktivat e BE-së) që përcakton kërkesat themelore për sigurinë dhe dhe aspekte të tjera të interesit publik, të cilat duhet të plotësohen nga produktet dhe shërbimet që shiten në Tregun e Vetëm.

performanca e verifikuar nga fillimi i testeve (Testimi Fillestar i Tipit) vazhdon të jetë e vlefshme dhe e barabartë për të gjitha produktet pasuese, duke përfshirë inovacionet në procesin e prodhimit.

Këta udhëzues mund të përdoren nga kolegët e *Confartigianato* në shërbimet e konsultimit për markimin CE që u ofrojnë ndërmarrjeve të ndryshme.

Burimet: De Vries et al. (2009^[40]), *SME Access to European Standardization: Enabling Small and Medium-Sized Enterprises to Achieve Greater Benefit from Standards and from Involvement in Standardization (Qasja e NVM-ve në Standardizimin Evropian: Mundësimi që Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme të Arrijnë Përfitime më të Mëdha nga Standardet dhe nga Përfshirja në Standardizim)*; Confartigianato (2018^[41]), faqja e internetit e *Confartigianato*, www.confartigianato.it.

Aftësitë e ndërmarrjes (Dimensioni 8a)

Kosova shënon një rezultat prej 2.78 për aftësitë e ndërmarrjes, që është rreth mesatares rajonale (Tabela 15.15).

Tabela 15.15. Rezultatet për Dimensionin 8a: Aftësitë e ndërmarrjes

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Biloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT |
|--|---|--------------------------|-------------|-----------------|
| Dimensioni 8a: Aftësitë e ndërmarrjes | Nën-dimensioni 8a.1: Aftësitë e ndërmarrjes | Planifikimi dhe dizajni | 4.17 | 3.38 |
| | | Implementimi | 2.25 | 2.83 |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 2.00 | 2.29 |
| | | Mesatarja e | 2.78 | 2.87 |
| Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 8a | | | 2.78 | 2.87 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Sektori privat i Kosovës përbëhet pothuajse tërësisht nga NVM-të. Për të siguruar rritjen e tyre të qëndrueshme, një analizë e nevojave për trajnim është kryer në baza dyvjeçare (në 2012, 2015 dhe 2017) nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe KIESA. Qëllimi është të kuptohen si nevojat e trajnimit dhe këshillimit, ashtu edhe boshllëqet në ofrimin e trajnimeve - duke përfshirë edhe ato për gratë - dhe të parashikohen nevojat e aftësive. Analiza dhe struktura e partneritetit përbëjnë një bazë për të ndërtuar një kuptueshmëri të implikimeve të aftësive të specializimit të mençur, një qasje të cilën Kosova ka filluar së zbatuari në vitin 2018.

Bashkëpunimi ndërinstucional ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, KIESA-s dhe Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë nënkupton që rezultatet e analizës së nevojave për trajnim janë përdorur për të informuar vendimmarrjen nëpër ministri. KIESA është pjesë e bordit të Këshillit për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe rezultatet e analizës së nevojave për trajnim të NVM-ve janë përdorur në hartimin e Fondit të Inovacionit, të udhëhequr nga Ministria e Inovacionit. Përmes Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, Kosova demonstroi praktikë të mirë në financimin e trajnimit të institucioneve mbështetëse të NVM-ve për të përmirësuar gatishmërinë për investime.

Kosova po ashtu demonstroi praktikë të mirë në përdorimin e analizës së nevojave për trajnim të NVM-ve për të informuar Programin e saj të Reformës Ekonomike për në BE (Rubrika 15.1). Arsimit dhe aftësitë janë të listuara në mënyrë eksplicite si grupi i shtatë i reformave prioritare dhe hendeku i aftësive midis arsimit / trajnimit dhe nevojave të tregut të punës është theksuar si një pengesë e detyrueshme për rritjen dhe punësimin.

Kosova ka bërë përparim të mirë në mbështetjen e NVM-ve në ekonominë digjitale. Qendra për Inovacion e Kosovës (QIK) ofron një gamë të gjerë të kurseve të trajnimit për NVM-të në aftësitë dixhitale, duke përfshirë kurse online, shpenzimet e të cilave mbulohen pjesërisht nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Rëndësia e NVM-ve në ekonominë dixhitale është pasqyruar edhe në Programin e Reformës Ekonomike, me grupin e pestë të reformave prioritare që adreson inovacionin, kërkimin dhe zhvillimin dhe ekonominë digjitale. Ministria e Zhvillimit Ekonomik po kërkon të zbatojë një projekt për të zgjeruar qasjen dhe përdorimin e TIK-ut. Ky projekt për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë dixhitale të Kosovës, i financuar nga Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësisë, është planifikuar të fillojë deri në fund të vitit 2018.

Asnjë progres nuk është bërë në monitorimin, i cili vazhdon të zhvillohet vetëm në nivel të projektit, ndërkohë që vlerësimi nuk është kryer fare.

Rruga përpara për Dimensionin 8a

Përkundër përparimit të Kosovës në ndërtimin e aftësive të NVM-ve, sfidat kyçe që mbeten mund të adresohen përmes masave të mëposhtme:

- **Sigurimi i një grumbullimi më të mirë të informacionit për aftësitë me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit më kuptimplotë.** Kosova ka vazhduar të përparojë në gjenerimin e informacionit më të gjerë për nevojat e trajnimit të NVM-ve. Megjithatë, të dhënat e rregullta dhe të besueshme për aftësitë e NVM-ve mbeten një sfidë. Kjo pastaj prek monitorimin dhe vlerësimin - ku të dyja mbeten të dobëta, por sidomos vlerësimi. Në mënyrë që politikë-bërësit të përshtatin më mirë bazën e kapitalit njerëzor të Kosovës me strukturën e saj ekonomike, përmirësimi i grumbullimit të informacionit rreth aftësive është kritik.
- **Forcimi i mekanizmave të koordinimit.** Aktualisht, një ministri e re, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, bashkëpunon me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe KIESA-n për analizën e nevojave për trajnim. Forcimi i këtij mekanizmi koordinues duke formalizuar dhe sistematizuar bashkëpunimin dhe duke e zgjeruar atë ndaj një grupi më të gjerë akterësh (si zyrat statistikore, shërbimet e punësimit, odat ekonomike dhe ofruesit e arsimit dhe trajnimit) do të ndihmonin në zvogëlimin e boshllëqeve të informacionit për aftësitë e NVM-ve. Ky organ ose mekanizëm i dedikuar koordinues gjithashtu do të ndihmonte në zgjerimin e monitorimit vetëm nga projektet e financuara nga donatorët, në mënyrë që informacioni i grumbulluar rreth aftësive të përkthehet në arsim dhe trajnim dhe veprime të politikave që mbështesin NVM-të sot dhe në të ardhmen.
- **Forcimi i trajnimit për bizneset fillestare (start-up) dhe qasshmërisë përmes një ueb platforme me mundësi kërkimi.** Kosova nuk ofron sistematikisht programe trajnimi të financuara nga qeveria në mënyrë specifike për bizneset fillestare (start-ups). Fondi i ri për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik ka lansuar së fundi një thirrje të hapur për të mbështetur financiarisht një numër të përzgjedhur të bizneseve fillestare në sektorin e TIK-ut dhe teknologjisë. Trajnimi për bizneset fillestare mund të forcohet, për shembull duke zhvilluar këto trajnime së bashku me ngjarjet ekzistuese siç është *Techstars Startup Week Kosovo* (mbajtur në mars 2018). Eventi përfshiu sesione mentorimi për *start-up*-et të udhëhequra nga një mentor i huaj. Zhvillimi i një platforme online të përhershme dhe me mundësi për kërkim të lehtë (në krahasim me uebfaqe për ngjarje specifike) ku ofruesit e arsimit dhe trajnimit mund të prezantojnë mentorimin, instruktimin dhe llojet e ndryshme të punëtoreve, do të promovonin një përshtatje më të mirë midis arsimit dhe trajnimit dhe kërkesës. Kjo gjithashtu do të ndihmonte lidhjen e ndërmarrësve të rinj me njerëzit dhe rrjetet që mund t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë kompaninë e tyre. Së fundmi, të bërit e trajnimit, mentorimit dhe instruktimit një parakusht për pranimin e granteve apo kredive, mund të shërbejë si një nxitje e rëndësishme për të përmirësuar aftësitë dhe ndërtuar rrjete për bizneset fillestare. Aktualisht, përkrahja e tillë jofinanciare është kryesisht e shtytur nga donatorët.
- **Shqyrtimi i dokumenteve kryesore të politikave që drejtojnë ofrimin e arsimit dhe trajnimit për të forcuar aftësitë dhe kompetencat ndërmarrëse të grave.** Kosova duhet t'i përditësoj dokumentet e saj kryesore të politikave, përkatësisht Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat (2013-17) dhe Strategjinë për Zhvillimin e NVM-ve (2012-16), për të shërbyer si referenca për ndërmarrësinë e

grave. Këto dokumente janë ndërfaqe të dobishme për drejtimin e mbështetjes relevante të donatorëve për NVM-të si shtytësit kryesorë të inovacionit, rritjes ekonomike dhe konkurrueshmërisë në Kosovë. Për më tepër, progresi me specializimin e mençur (shih më poshtë) do të hapë një mundësi për të zhvilluar një vizion të përbashkët në të gjitha fushat e politikave.

- **Integrimi i aftësive të NVM-ve në strategjitë e specializimit të mençur.** Në ecjen përpara me specializimin e mençur, Kosova do të duhet të identifikojë aftësitë e kërkuara nga segmentet e specializimit të mençur dhe ndikimin që kjo ka në kërkesën për fuqi punëtore. Politikat e arsimit dhe trajnimit dhe investimet relevante publike duhet të përshtaten me qëllim që të sigurohet ofrimi i fuqisë punëtore të kualifikuar dhe përmirësimi i aftësive të fuqisë punëtore ekzistuese.

Politika e inovacionit për NVM-të (Dimensioni 8b)

Me një rezultat prej 2.40, Kosova është një nga performuesit më të dobët në politikën e inovacionit në rajon (duke lënë prapa vetëm Bosnje dhe Hercegovinën, e cila ka një rezultat prej 1.86) (Tabela 15.16). Megjithatë, Kosova ka treguar gjithashtu përmirësimin më të madh që nga vlerësimi i vitit 2016, duke filluar nga një bazë e ulët prej 1.86 (Figura 15.1). Është evidente se politika e inovacionit po fiton përkrahje midis politikëbërësve në Kosovë dhe ka më shumë vëmendje mbi rëndësinë e inovacionit për konkurrueshmërinë e përgjithshme.

Tabela 15.16. Rezultatet për Dimensionin 8b: Politika e inovacionit për NVM-të

| Dimensio | Nën-dimensio | Blloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT |
|--|--|---|-------------|-----------------|
| Dimensio 8b: Inovacioni për NVM-të | Nën-dimensio 8b.1: Korniza politike për inovacion | Qasja Strategjike | 2.90 | 3.46 |
| | | Koordinimi i politikave të inovacionit | 2.33 | 2.97 |
| | | Implementimi i politikave të inovacionit | 2.43 | 3.04 |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.55 | 3.15 |
| | Nën-dimensio 8b.2: Shërbimet mbështetëse nga institucionet qeveritare për NVM-të inovative | Inkubatorët dhe akseleratorët | 3.00 | 2.99 |
| | | Shërbimet e zgjerimit të teknologjisë për NVM-të e themeluara | 1.00 | 1.74 |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.20 | 2.49 |
| | Nën-dimensio 8b.3: Shërbimet mbështetëse nga institucionet qeveritare për NVM-të inovative | Përkrahja e drejtpërdrejtë financiare | 3.40 | 3.76 |
| | | Përkrahja indirekte financiare | 1.00 | 1.38 |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.44 | 2.81 |
| Nën-dimensio 8b.4: NVM-të dhe bashkëpunimi me institucionet kërkimore dhe transferi i teknologjisë | Skema e vauçerit të inovacionit dhe grantet bashkëpunuese | 2.00 | 2.52 | |
| | Infrastruktura institucionale për bashkëpunimin industri-komunitet akademik | 2.40 | 2.72 | |
| | E drejta e pronës intelektuale | 2.50 | 3.00 | |
| | Mesatarja e ponderuar | 2.26 | 2.70 | |
| Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 8b | | | 2.40 | 2.86 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Korniza politike për inovacionin

Qeveria ka përmirësuar kornizën institucionale për politikën e inovacionit duke themeluar Ministrinë për Inovacionin dhe Ndërmarrësi në vitin 2017. Kjo filloi hartimin e Strategjisë për Përkrahjen e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (2019-2023). Megjithatë, edhe pse strategjia është hartuar që nga shtatori 2018, ajo ende nuk ishte miratuar nga qeveria në kohën e përpilimit të këtij dokumenti. Ministria gjithashtu ka finalizuar koncept dokumentin për Ligjin për Inovacionin, por ky ende ishte në pritje të miratimit.

Ministria nuk është e dizajnuar si një agjenci e pavarur zbatuese për inovacionin, por ajo

ka në fakt një buxhet specifik të alokuar për inovacionin. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rritur kapacitetin e saj të burimeve njerëzore, pasi që ajo kishte vetëm gjashtë punonjës në vitin 2018.

Në dhjetor 2017, është krijuar një Këshill Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi, ku përfshihen përfaqësues të ministrive përkatëse (Arsimit dhe Shkencës, Financave, Integritimit Evropian) si dhe komuniteti akademik dhe biznesi (odat ekonomike). Ai ka vetëm një rol këshillues dhe takohet një herë në muaj.

Shërbimet mbështetëse institucionale qeveritare për NVM-të

Inkubatorët ekzistojnë në Kosovë dhe institucionet kryesore në këtë fushë janë Qendra e Inovacionit të Kosovës (QIK) dhe Gjirafa Lab. Të dyja këto institucione janë iniciativa të bazuara në donacione ku QIK merr mbështetje përmes programeve të donatorëve norvegjez, suedez dhe gjerman dhe grantet e BE-së, dhe Gjirafa Lab është një projekt i USAID-it (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar). Qendra e Inovacionit Jakova u themelua nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Kosovë.

Buxheti i vitit 2018 i Ministrisë së Inovacionit parashikon një alokim prej 1.1 milion euro për krijimin e qendrave rajonale të inovacionit dhe për këtë qëllim ministria ka nënshkruar marrëveshje me komunën e Ferizajt dhe Universitetin 'Hasan Prishtina' për krijimin e dy qendrave të "inovacionit dhe ndërmarrësisë" në Ferizaj dhe Prishtinë. Këto qendra përfaqësojnë një partneritet midis niveleve qendrore dhe lokale nga njëra anë dhe komunitetit akademik dhe sektorit privat nga ana tjetër. Fondet e alokuara do të përdoren për pajisjen e këtyre qendrave me laboratorë dhe pajisje specifike bazuar në nevojat e bizneseve fillestare (start-up) dhe NVM-ve.

Shërbimet e mbështetjes financiare qeveritare për NVM-të inovative

Në vitin 2018, është lansuar një fond i ri për inovacion, i dedikuar për bizneset fillestare, NVM-të dhe OJQ-të, në bashkëpunim me Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), e cila ka alokuar 1.2 milion euro për fondin, duke e çuar shumën totale në 7.2 milionë euro. Fondi është në dispozicion për ndërmarrjet kosovare mikro, të vogla dhe të mesme në sektorët relevantë për punësimin që përdorin tregjet potenciale ndërkombëtare. Programi liston tre sektorë: bujqësinë, prodhimin dhe TIK-un. Skema e saj e granteve të fondit të oportunitetit (Opportunity Fund) synon kompanitë, të cilat prezantojnë inovacione në produkte, procese të prodhimit ose shërbime që janë relevante për tregjet e eksportit. Qëllimi i kësaj skeme është të tërheqë idetë më inovative me potencial për eksporte dhe krijimin e vendeve të punës. Kompanitë kosovare që dëshirojnë të marrin fonde përmes Fondit të Oportunitetit duhet të plotësojnë kriteret teknike dhe procedurale, siç janë tre vjet përvojë ose dëshmi të eksporteve dhe / ose potenciale për eksport.

Disa stimuj tatimor janë prezantuar për të mbështetur në përgjithësi NVM-të, por këto nuk ofrojnë stimuj të drejtpërdrejta për shpenzimet e sektorit privat për kërkime dhe zhvillim. Blerjet e pajisjeve të TIK-ut janë përjashtuar nga TVSH-ja që nga muaji janar 2018. Edhe pse kjo është një masë e përgjithshme, do të jetë me dobi edhe për NVM-të inovative.

Bashkëpunimi i NVM-ve dhe institucioneve hulumtuese dhe transferimi i teknologjisë

Edhe pse nuk ka grante bashkëpunimi që do të financonin hulumtime të përbashkëta

biznes-komunitet akademik në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ofron vauçer për inovacione. Thirrja e fundit për propozime për vauçer u shpall më 1 tetor 2018, duke ofruar mbështetje deri në 1 000 euro për kompanitë individuale. Megjithatë, një thirrje e ngjashme e MTI-së në vitin 2017 e cila planifikoi të disbursojë 25 000 euro në total, nuk dha rezultate, pasi kompanitë nuk ishin të interesuara të aplikonin. Kjo sugjeron që programi do të kërkojë ridizajnim të konsiderueshëm në mënyrë që të arrijë qëllimin e tij për të krijuar lidhje ndërmjet bizneseve dhe hulumtuesve. Në fund të vitit 2017, Universiteti i Prishtinës hapi një qendër për inovacion dhe ndërmarrësi, e mbështetur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Edhe pse kjo qendër nuk i shërben qëllimit të transferimit të teknologjisë, ajo ka pasur sukses të mirë në vitin e saj të parë, ku studentët kanë treguar interes të madh për pjesëmarrje në programet e trajnimit dhe mentorimit të ndërmarrësisë. Në vitin 2018, një projekt i përbashkët u iniciua me Qeverinë Federale të Gjermanisë për të transformuar kampin ushtarak të KFOR-it në Prizren në parkun shkencor dhe teknologjik, i pari ndonjëherë në Kosovë (Kutia 15.7).

Kutia 15.7. Parku Kosovaro-Gjerman i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren

Në 2016, qeveritë gjermane dhe kosovare arritën një marrëveshje për të shqyrtuar mundësinë e shndërrimit të zonës së kampit ushtarak të KFOR-it në Prizren në Park të Inovacionit dhe Trajnimit (PIT). Ideja për të krijuar PIT rrodhi nga shembulli i parqeve të ngjashme të hapura në vende të tjera, të cilat sjellin ekspertizën akademike më afër përvojës së biznesit, duke stimuluar transferimin e teknologjisë. PIT në Prizren është planifikuar të jetë funksional në fillim të vitit 2019, kur 39 hektarë të zonës së kampit ushtarak do t'i dorëzohen qeverisë së Kosovës.

Parku është paraparë të përfshijë hapësira për kompani, aftësim profesional, institucione akademike, institucione qeveritare, si dhe OJQ. Pas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit (GIZ Kosovo, 2018 [42]), PIT do të përzgjedhë kompani dhe specialistë bazuar në fushën e tyre të veprimtarisë. Për të siguruar ndikimin pozitiv të PIT në krijimin e vendeve të punës dhe në rritjen ekonomike në Kosovë, u identifikuan tre sektorë prioritarë me potencialin më të madh të rritjes:

- Firmat e TIK/të bazuara në teknologji
- përpunimi agro / ushqimor
- industrinë kreative dhe kulturore.

Gjithashtu u identifikuan dy fusha ndërsektoriale për zhvillim:

- arsimimi dhe aftësimi profesional
- hulumtimi dhe zhvillimi (H & Zh).

Misioni i PIT-së është të bëhet qendra kryesore e inovacionit në Kosovë në fushën e industrive TIK, agro-ushqimore dhe kreative. PIT synon të sigurojë një gamë të plotë të shërbimeve për kompanitë që bëhen pjesë e parkut. PIT do të ofrojë hapësirë të përbashkët pune, hapësirë për zyre, dhe zona manufakturimi dhe prodhimi. Për më tepër, parku do të ndihmojë bizneset të zhvillohen nëpërmjet inkubacionit, trajnimit, menaxhimit të pronësisë intelektuale, transferimit të teknologjisë, mbështetjes financiare dhe qasjes në rrjetet e “engjëjve” të biznesit. PIT gjithashtu do të akomodoj nevojat e shkollave duale profesionale dhe qendrave të trajnimit, të cilat do të jenë në gjendje të përdorin hapësirën e tyre për të ofruar arsim dhe trajnim profesional të përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe për të bashkëpunuar ngushtë me bizneset e vendosura në park.

Në tre-katër vitet e para, para se PIT të bëhet e qëndrueshme në aspektin financiar, projekti

do të bashkë-mbështetet financiarisht nga qeveritë kosovare dhe gjermane . Më pas, PIT do të financohet nëpërmjet fitimit të realizuar nga qiraja dhe shërbime të tjera me pagesë të ofruara për klientët. Në fillim të vitit 2019 është planifikuar një thirrje publike për aplikime për të kërkuar kompanitë që duan të operojnë në PIT.

Burimet: PIT Prizren (2018^[43]), *Parku Kosovaro-Gjerman i Inovacionit dhe Trajnimit*, <http://itp-prizren.com/wp-content/uploads/2018/10/Gizz-Leaflet-Trifold-ITP.pdf>; GIZ Kosovë (2018^[42]) *Studimi i fizibilitetit: Një propozim koncept për përdorimin e ardhshëm e kampit të KFOR-it në Prizren, Kosovë*, www.alg-prizren.com/pdfs/GIZ-Feasibility-Study.pdf.

Rruga përpara për Dimensionin 8b

Kosova ka dëshmuar një momentum pozitiv me hartimin e politikave të saj të inovacionit - kjo duhet shpjerë tutje me zbatimin e këtyre politikave. Sfidat e mëposhtme mbeten:

- **Miratimi i një strategjie të inovacionit dhe monitorimi me kujdes i zbatimit të saj.** Edhe pse është hartuar strategjia kombëtare e inovacionit, e njëjta ende nuk është miratuar. Pasi të miratohet, duhet të përcaktohen qartë rolet e të gjithë akterëve, në veçanti ato të Ministrisë së re të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Roli i Këshillit Kombëtar për Inovacionin dhe Ndërmarrësi mund të përdoret për të monitoruar zbatimin e strategjisë në mënyrë të rregullt dhe transparente.
- **Rritja e investimit në H & Zh dhe shfrytëzimi i financimit konkurrues të bazuar në projekte.** Një sektor i fortë hulumtimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm për inovacionin. Në Kosovë, financimi për H & Zh është i ulët dhe i alokuar në një mënyrë që nuk promovon ekselencë ose relevancë hulumtimi. Kosova duhet të investojë më shumë në H & Zh dhe të prezantojë financime konkurruese të bazuara në projekte që do të mbështesnin hulumtuesit e saj më të mirë për të punuar në hulumtime që janë relevante për sektorin privat. Kjo gjithashtu do të ndihmonte në përmirësimin e pjesëmarrjes së ekonomisë në programin e BE-së-Horizon 2020,⁷ në të cilin Kosova merr pjesë si palë e tretë, por me pak sukses deri më sot.
- **Përmirësimi i dizajnit të instrumenteve mbështetëse.** Fakti që asnjë kompani nuk ka aplikuar për 25 000 euro në grante të ofruara nga MTI në vitin 2017 sugjeron mangësi në hartimin e këtij instrumenti mbështetës. Kosova mund të përfitojë nga mbështetja e donatorëve për të hartuar instrumente të inovacionit bazuar në shembujt e praktikave të mira, veçanërisht ato në ekonomitë e tjera të rajonit. Pasi të jenë prezantuar, instrumentet duhet të monitorohen dhe vlerësohen rregullisht për të siguruar që ato janë duke arritur objektivat e tyre fillestare.

NVM-të në një ekonomi të gjelbër (Dimensioni 9)

Performanca e Kosovës në fushën e bërjes së NVM-ve të gjelbërta mbetet mjaft e dobët dhe rezultati i saj, 1.92, është përkeqësuar paksa që nga vlerësimi i fundit (Tabela 15.17).

Tabela 15.17. Rezultatet për Dimensionin 9: NVM-të në një ekonomi të gjelbër

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Blloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT | |
|--|--|---|-------------|-----------------|-------------|
| Dimensioni 9: NVM-të në një ekonomi të gjelbër | Nën-dimensioni 9.1: Komiza për politikat mjedisore të synuara për NVM-të | Planifikimi dhe hartimi | 3.67 | 3.81 | |
| | | Zbatimi | 2.20 | 2.56 | |
| | | Monitorimi dhe Vlerësimi | 1.50 | 2.12 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 2.50 | 2.85 | |
| | Nën-dimensioni 9.2: Incentivat dhe instrumentet për bërjen e NVM-ve të gjelbërta | Planifikimi dhe hartimi | 1.67 | 2.32 | |
| | | Zbatimi | 1.50 | 2.76 | |
| | | Monitorimi dhe Vlerësimi | 1.00 | 1.72 | |
| | | Mesatarja e ponderuar | 1.45 | 2.42 | |
| | | Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 9 | | 1.92 | 2.61 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Korniza për politikat mjedisore të synuara për NVM-të

Asnjë nga dokumentet strategjike kombëtare nuk fokusohet në politikat dhe masat mjedisore specifike për NVM-të në Kosovë. Drafti i Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat (2018-2022) nuk përfshin ndonjë objektiv ose pikë të veprimit lidhur me bërjen e NVM-ve të gjelbërta, megjithëse drafti strategjia merr parasysh rritjen e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e energjisë së ripërtitshme si një "mundësi" për industri të caktuara në të cilat operojnë NVM-të.

Elementet e politikave mjedisore që kanë rëndësi për NVM-të janë përfshirë në tre strategjitë dhe planet përkatëse të veprimit: Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (2013-2022), e cila është një dokument qendror kombëtar për politikat mjedisore; Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë deri në vitin 2030; dhe Strategjia e Menaxhimit të Mbeturisë 2.0 (2017-2021). Dy dokumentet e para strategjike parashikojnë përmirësime të efikasitetit të energjisë në sektorin privat kosovar, por deri më sot nuk është zbatuar asnjë masë domethënëse. Sipas qeverisë, realizimi i kufizuar i këtyre masave shpjegohet me alokimet buxhetore të kufizuara për to dhe vonesat e mëdha në mobilizimin e fondeve të donatorëve.

Incentivat dhe instrumentet për bërjen e NVM-ve të gjelbërta

Ashtu si në vlerësimin e fundit, nuk ekzistojnë incentiva financiare për të inkurajuar bërjen e NVM-ve të gjelbërta pasi kjo fushë nuk konsiderohet prioritet i qeverisë. E njëjta vlen edhe për instrumentet rregullatore dhe politikat e gjelbërta të prokurimit publik. Para vitit 2016, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) ndërmorën veprime të caktuara për të promovuar efikasitetin e burimeve në mesin e NVM-ve dhe për të ofruar informacion se si të përmirësohet performanca mjedisore përmes sistemeve të menaxhimit mjedisor. Sidoqoftë, gjatë periudhës referuese këto aktivitete u ndërprejnë dhe nuk kishte masa të ngjashme mbështetëse për NVM-të të planifikuara në kohën e përpilimit të këtij dokumenti.

Rruga përpara për Dimensionin 9

Për të ecur përpara në këtë fushë dhe për të shfrytëzuar mundësitë që dalin nga bërja e NVM-ve të gjelbërta, qeveria duhet të marrë parasysh sa vijon:

- **Prezantimi i masave për bërjen e NVM-ve të gjelbërta në dokumentet strategjike dhe planet përkatëse të veprimit.** Edhe pse politikat mjedisore që kanë të bëjnë me ndërmarrjet, siç janë rritja e efikasitetit të energjisë dhe menaxhimi i përmirësuar i mbeturinave, ndonjëherë mbulohen pjesërisht në dokumentet strategjike, ato nuk përmbajnë veprime konkrete dhe nuk ka qasje të koordinuar për bërjen e NVM-e të gjelbërta. Prandaj, qeveria këshillohet që t'i japë përparësi hartimit të politikave të gjelbërta për NVM-të dhe të ketë një plan veprimi të qartë mbi atë se si të mbështesin tranzicionin e tyre në një ekonomi të gjelbër.
- **Përqendrimi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve për NVM-të në miratimin e praktikave të shëndosha mjedisore.** Qeveria këshillohet të ndihmojë NVM-të për të kursyer shpenzimet e energjisë, materialit dhe ujit dhe për të demonstruar mënyra të reja dhe më të mira për të qenë efikase në burime duke u ofruar atyre mjete dhe informata të synuara. Shërbimet këshilluese të efikasitetit të burimeve mund t'iu ofrohen direkt NVM-ve nga një agjenci publike përkatëse, si KIESA ose AKMM. Qëllimi i tyre mund të jetë për t'i bindur NVM-të që efikasiteti i burimeve ofron kthime të larta për investime me kosto të ulët. Shembulli i Irlandës se si qeveria mund të rrisë ndërgjegjësimin për gjelbërimin mes NVM-ve dhe t'i mbështesë ato në rritjen e efikasitetit të burimeve mund të replikohet në Kosovë (Kutia 15.8).
- **Përmirësimi i mbështetjes financiare për bërjen e NVM-ve të gjelbërta.** Gjer më tani, NVM-ve nuk i është ofruar asnjë incentivë financiare për të rritur performancën e tyre mjedisore. Prandaj, qeverisë i rekomandohet të zhvilloj instrumente të reja financiare që mbështesin NVM-të në ndërmarrjen e investimeve në shkallë të vogël në eficiencën e energjisë. Për më tepër, mekanizmat ekzistues mund të ri-dizajnohen në një mënyrë që do t'i jepte shtysë eko-inovacionit. Për shembull, Kosova lansoi Fondin e saj të parë të Inovacionit në vitin 2018. Një pjesë e këtyre fondeve mund t'i dedikohet komercializimit të ideve eko-inovative dhe për të mbjellë farat e një ekonomie cirkulare. Për më tepër, Instrumenti i NVM-ve në kuadër të Horizont 2020 mund të promovohet edhe në mesin e NVM-ve, pasi që mundëson mbështetjen financiare për promovimin e eko-inovacionit.

Pasi që dhënia e granteve të drejtpërdrejta për bërjen e NVM-ve të gjelbërta mund të jetë barrë për buxhetin, Kosova gjithashtu mund të shqyrtoj shfrytëzimin e kanaleve të ndryshme për të mbështetur NVM-të financiarisht. Prezantimi i një skeme të dedikuar të garantimit të kredive ose subvencionimi i normave të interesit për kredi të projekteve të gjelbërta mund të jetë i realizueshëm, pasi që NVM-të do të mund të përdornin kursimet e efikasitetit të burimeve për të shlyer huamarrjen paraprake.

Kutia 15.8. Green Business Ireland: Ngritja e ndërgjegjësimit për përparësitë e bërjes së NVM-ve të gjelbërta dhe rritja e efikasitetit të burimeve

Në vitin 2011, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) e Irlandës formoi Programin e Biznesit të Gjelbër në kuadër të Programit Kombëtar të Parandalimit të Mbeturinave. Qëllimi i tij ishte të ofronte përmirësime përmbajtësore të efikasitetit të burimeve dhe kursimeve të

kostos përmes parandalimit të mbeturinave dhe zvogëlimit të konsumit të ujit dhe energjisë. Programi menaxhohet nga Qendra e Teknologjisë së Pastër (CTC) në Institutin e Teknologjisë të Kork. CTC, e themeluar në vitin 1994, ka një ekip ekspertësh në efikasitetin e burimeve dhe parandalimin e mbeturinave.

Programi i Biznesit të Gjëlber ofron një sërë shërbimesh për të ndihmuar NVM-të në rritjen e efikasitetit të resurseve: vizitat në terren, dokumentet udhëzuese, mjetet online, seminarët dhe rrjetëzimin e komunitetit. Duke u regjistruar në www.greenbusiness.ie dhe duke përdorur mjetet e auditimit online, përdoruesit mund të fillojnë të matin përdorimin e burimeve të tyre dhe të identifikojnë se ku mund të bëhen kursimet. Gjithashtu mund të kërkohet një vizitë në terren, gjatë së cilës një Këshilltar për Biznesin e Gjëlber do të vizitojë ambientet e pjesëmarrësit dhe do të identifikojë masat e lira dhe me kosto të ulët që do të çojnë në kursime të kostos. Shërbimi është pa pagesë dhe operohet nga CTC në emër të EPA-së.

Deri më sot, me një buxhet vjetor prej 350 000 eurosh, Iniciativa e Biznesit të Gjëlber ka vizituar 270 ndërmarrje nga një sërë sektorësh (përpunimi i ushqimit, sektori bankar, sektori publik, shitësit me pakicë) dhe ka arritur identifikimin e kursimeve prej rreth 10 milionë euro për ndërmarrjet anëtare (6.2 milion euro në energji, 2.7 milion euro në mbeturina dhe 1.2 milion euro në ujë). Kursimet individuale varionin nga 2 000 deri në 200 000 euro.

Disa nga mësimet e nxjerra nga përvoja e Biznesit të Gjëlber janë se NVM-të nuk po monitorojnë shpenzimet e tyre komunale dhe nuk janë në dijeni për shkallën e mbeturinave. Përveç kësaj, ato nuk janë në dijeni për mundësitë për të zvogëluar mbeturinat pa kosto ose me kosto të ulët, si dhe mundësitë për të rritur fitimet neto dhe për të përmirësuar imazhin e tyre. Gjithashtu ato shpesh nuk janë në dijeni për asistencën në dispozicion për përmirësimin e performancës së tyre mjedisore.

Shembulli i Biznesit Gjëlber tregon se si mund të dizajnohet një mekanizëm mbështetës efikas dhe efektiv: përfshirja e një bashkëpunimi midis qeverisë dhe akademisë, që është me kosto efektive dhe sjell përfitime të ndryshme vetëm duke identifikuar kursimet e mundshme për të cilat bizneset zakonisht nuk janë në dijeni. Modeli nënvizon rëndësinë e ofrimit të këshillave dhe udhëzimeve për NVM-të që të "bëhen të gjëlbera". Është gjithashtu lehtësisht e zbatueshme në kontekstin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë dhe mund të aplikohet me mbështetjen e agjencive ekzistuese të mbrojtjes së mjedisit.

Burimet: Programi i Biznesit të Gjëlber (2017^[44]), *faqja e internetit e GreenBusiness*, <http://greenbusiness.ie/>; EPA (2018^[45]), *Iniciativa e Biznesit të Gjëlber*, www.epa.ie/waste/nwpp/gbi/; EPA (2018^[46]), *Programi Kombëtar për Parandalimin e Mbeturinave*, www.epa.ie/waste/nwpp/.

Ndërkombëtarizimi i NVM-ve (Dimensioni 10)

Që nga vlerësimi i fundit, Kosova ka bërë një progres të konsiderueshëm në promovimin e ndërkombëtarizimit të NVM-ve, duke rritur rezultatin e saj nga 3.15 në 3.74 (shih Tabelën 15.18 dhe Figurën 15.1). Hapat e bërë në zhvillimin dhe zbatimin e hershëm të programeve për të mbështetur promovimin e eksportit dhe zhvillimin e klustereve kanë dhënë kontributin më të madh për këtë performancë të përmirësuar.

Tabela 15.18. Rezultatet për Dimensionin 10: Ndërkombëtarizimi i NVM-ve

| Dimensioni | Nën-dimensioni | Bloku tematik | Kosova | Mesatarja e BPT |
|--|--|--------------------------|-------------|-----------------|
| Dimensioni 10: Ndërkombëtarizimi i NVM-ve | Nën-dimensioni 10.1: Promovimi i eksportit | Planifikimi dhe hartimi | 5.00 | 4.86 |
| | | Zbatimi | 4.81 | 4.24 |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 3.57 | 3.01 |
| | | Mesatarja e | 4.62 | 4.18 |
| | Nën-dimensioni 10.2: Integrimi i NVM-ve në zinxhirët global të vlerave | Planifikimi dhe hartimi | 4.00 | 3.58 |
| | | Zbatimi | 3.86 | 3.08 |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 1.00 | 1.76 |
| | | Mesatarja e | 3.33 | 2.97 |
| | Nën-dimension 10.3: Promovimi i përdorimit të tregtisë elektronike | Planifikimi dhe hartimi | 3.29 | 3.45 |
| | | Zbatimi | 2.00 | 2.26 |
| | | Monitorimi dhe vlerësimi | 1.00 | 1.36 |
| | | Mesatarja e | 2.19 | 2.44 |
| Rezultati i përgjithshëm i Kosovës për Dimensionin 10 | | | 3.74 | 3.43 |

Gjendja aktuale dhe zhvillimet kryesore

Pavarësisht progresit të bërë në reformat e biznesit në vitet e fundit, Kosova mbetet ekonomia më së paku e integruar në rajon. Performanca e saj është veçanërisht e ulët në eksportet në përgjithësi, me një raport të eksportit ndaj BPV-së në vitin 2017 prej vetëm 26.6% krahasuar me mesataren rajonale prej 38.2% (Banka Botërore, 2018^[47]). Ndërkohë, ajo ka pjesën më të madhe të eksporteve të NVM-ve të të gjitha ekonomive të BPT-së, në 97.3%, ku pjesa dominante vjen nga mikro ndërmarrjet (54.9%). Sidoqoftë, sipas të dhënave të marra për këtë vlerësim, Kosova kishte një vlerë mesatare shumë më të ulët të eksporteve për ndërmarrje (rreth 215.000 euro) krahasuar me mesataren e BPT-së prej rreth 662.000 euro në vitin 2016.⁸

Sa i përket performancës tregtare, Kosova ka reduktuar kohën e kërkuar për përputhshmërinë dokumentare dhe kufitare për eksportim duke përmirësuar sistemin e automatizuar të menaxhimit të të dhënave doganore, duke ristrukturuar proceset e zhdoganimit dhe duke zbatuar Korridorin Transit Shqipëri-Kosovë. Kjo reformë e proceseve të saj të zhdoganimit paraqet një përmirësim të konsiderueshëm për lehtësinë e të bërit biznes në Kosovë (Banka Botërore, 2018^[48]). Megjithatë, kostoja e importit sa i përket përputhshmërisë kufitare u rrit nga 83 në 128 dollarë amerikanë ndërmjet vitit 2014 dhe 2017 dhe megjithëse kostoja e eksportit ka rënë nga 137 në 105 dollarë amerikanë gjatë periudhës së njëjtë, mbetet dukshëm mbi mesataren e BE-së prej 85 dollarësh, megjithëse nën mesataren e OECD prej 164 dollarësh (Banka Botërore, 2018^[48]). Vlen të theksohet se shumica e

detyrimeve doganore për importet dhe eksportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së janë eliminuar përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, e cila hyri në fuqi në prill 2016 (CEU, 2015^[49]).

Promovimi i eksportit

Më parë promovimi i eksportit është mbuluar nga Strategjia e Zhvillimit të Sektorit Privat 2013-2017, që përfshinte veprime mbi promovimin e investimeve dhe eksportit dhe mbështetjen e sektorëve të mundshëm të eksportit. Kosova tani adreson promovimin e eksportit në Strategjinë e saj të ripërtërirë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022 (ende draft gjatë kohës së përpilimit të këtij dokumenti) e cila është e lidhur me Strategjinë aktuale Kombëtare për Zhvillim. Prioritetet kryesore përfshijnë identifikimin e ndërhyrjeve strategjike për të rritur kapacitetin e NVM-ve për të arritur një vlerë më të lartë të eksporteve nëpërmjet një qasje sektoriale.

Gjatë periudhës së vlerësuar, KIESA ka zbatuar aktivitete për promovimin e eksporteve për NVM-të, financuar nga qeveria dhe donatorët. Sidoqoftë, stafi i saj i kufizuar dhe fondet e kufizuara vazhdojnë ta pengojnë atë - ka vetëm tre punonjës përgjegjës për promovimin e eksporteve. Në vitin 2018, nga buxheti operativ i KIESA-s u ndanë 351,000 euro për aktivitetet e promovimit të eksportit.

Departamenti i KIESA-s për Promovimin e Eksportit u ofron NVM-ve informata të politikës tregtare dhe inteligjencë komerciale, përfaqësim të ekonomisë në panairë të mëdha tregtare, promovim të eksportit dhe marketing, si dhe zhvillim të produkteve dhe trajnim. Përveç kësaj, KIESA mban një bazë të dhënash për kompanitë eksportuese dhe ndihmon në bashkë-koordinimin e çështjeve ndërinstucionale lidhur me eksportet e kompanive (KIESA, 2018_[50]). Faqja e internetit e KIESA-s përmban raporte të detajuara të sektorit të eksportit që vënë në pah aktivitetin e NVM-ve dhe jep udhëzime të qarta për eksportin, si dhe informacion mbi zhvillimin e një plani të marketingut.⁹ Mbështetjet financiare ofrohet edhe për kompanitë prodhuese me potencial për eksport. Gjatë vitit 2017, mbi 300 NVM përfituan nga asistencë financiare për të marrë pjesë në konferenca, panairë tregtare dhe shërbime konsulence të dedikuara për mbështetjen e eksportit; në të njëjtin vit u nënshkruan 47 kontrata të lidhura me eksportin.

Një numër programesh të financuara nga donatorët gjithashtu synojnë të përmirësojnë promovimin e eksporteve dhe konkurrueshmërinë midis NVM-ve. Për shembull, nga janari 2018 deri në dhjetor 2020, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në partneritet me KIESA-n, po zbaton programin e financuar nga GIZ prej 3 milionë eurosh, "Krijimi i Vendeve të Punës përmes Promovimit të Eksportit" (GIZ, 2018_[51]).

Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë ofron mjete të financimit tregtar nëpërmjet bankave lokale komerciale për të ndihmuar NVM-të për qasje në financimin tregtar, për të mbështetur eksportet. Megjithatë, ka një kërkesë të ulët për produktet e financimit tregtar në mesin e NVM-ve, pasi ato prirën të zgjedhin të parapaguajnë për inputet në mënyrë që të përfitojnë zbritje nga furnizuesit. Produktet e financimit tregtar janë veçanërisht në dispozicion për ndërmarrjet më të mëdha, ndërkohë që vëllimet e letërkredive për NVM-të përfaqësojnë vetëm 0.1% të kredive të institucioneve huadhënëse dhe vëllimet e garancive përbëjnë 1-6% të totalit të kredive të portofolit (EIB, 2016_[52]).

KIESA monitoron programet e promovimit të eksportit me masa për të promovuar transparencën. Për shembull, publikon raporte vjetore për aktivitetet e saj, të cilat janë në dispozicion për publikun, dhe që nga viti 2018 ka filluar të publikojë formularin e vlerësimit të nënshkruar dhe të vulosur të secilit aplikant në faqen e vet të internetit, duke ofruar kështu transparencë të plotë mbi përfituesit dhe rezultatet e vlerësimit të të gjithë aplikantëve. Kjo gjithashtu rrit përgjegjësinë e zyrtarëve qeveritarë të cilët kryejnë vlerësimet dhe vendosin për përfituesit e programeve mbështetëse. Megjithatë, vlerësimet mbi efektivitetin e programeve në rritjen e eksporteve ende nuk janë kryer.

Integrimi i NVM-ve në zinxhirët globalë të vlerave

Gjatë periudhës së vlerësimit, Kosova ka qenë më pro-aktive në përcaktimin e strategjisë së saj dhe zbatimin e projekteve të financuara nga donatorët që trajtojnë këto mangësi. Ajo është duke vendosur një sërë masash për rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe për sigurimin e kapacitetit të tyre për integrim dhe avancim brenda zinxhirëve të furnizimit me theks në zhvillimin e shoqatave të klasterëve midis NVM-ve dhe ndërmarrjeve të mëdha. Draft Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat parasheh mbështetje të vazhdueshme për NVM-të në përmirësimin e konformitetit të produkteve me kërkesat teknike të BE-së dhe standardeve globale, rritjen e kapacitetit të tyre të prodhimit dhe modernizimin e impianteve dhe pajisjeve të NVM-ve për të lehtësuar integrimin e tyre në zinxhirët global të vlerave.

Në të njëjtën mënyrë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Kosovës 2016-2022 thekson objektivin e përmirësimit të cilësisë së standardeve për aktivitetet prodhuese; zhvendosjen drejt aktiviteteve me vlerë më të lartë të shtuar dhe krijimin e lidhjeve me zinxhirët e vlerave në të gjithë sektorët. Strategjia Kombëtare për Zhvillim gjithashtu synon promovimin e rrjeteve dhe shoqatave të klasterëve nëpërmjet tre komponentëve që do të zhvillohen në kuadër të një strategjie të ardhshme kombëtare të konkurrueshmërisë, si në vijim:

1. identifikimi i shtatë klasterëve konkurrues dhe ofrimi i mbështetjes atyre përmes granteve dhe asistencës teknike.
2. krijimi i një kuadri institucional për të mbështetur zhvillimin e klasterëve industrial që përfshin qeverinë, biznesin dhe klasterët, ku firmat më të mëdha do të jenë në pozitë udhëheqëse.
3. krijimin e një rrjeti të furnizuesve përmes takimeve të rregullta midis qeverisë dhe biznesit për të forcuar lidhjet brenda zinxhirëve të vlerave (Zyra e Kryeministrit, 2016^[53]).

Kosova ende nuk ka programe operacionale për të mbështetur këta komponentë. Megjithatë, projektet e mëparshme kanë kontribuar në përkufizimin dhe qasjen sektoriale të strategjive të saj aktuale: klasteret janë ngritur në krye të prioritetëve pas një ushtrimi në hartimin e klasterëve ekzistuese dhe potenciale në Kosovë përmes një projekti të Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në vitin 2014 (UNDP dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, 2014^[54]). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së fundmi ka publikuar një dokument informativ të quajtur Udhërrëfyesi për Klasterë (Grupime), që përcakton rrugën e zhvillimit të klasterëve nga përcaktimi i një strategjike, arritja e aktiviteteve të rregullta të përbashkëta, e deri tek arritja e fazës së vetë-qëndrueshmërisë.

MTI së bashku me KIESA-n kanë planifikuar një program mbështetës për klasteret, i cili përfshin ofrimin e stimujve NVM-ve për bashkëpunimin e tyre, ndihmë në lehtësimin e takimeve, sigurimin e broshurave mbi hapat e nevojshëm për të formuar klasterë dhe mbulimin e shpenzimeve administrative, me synimin e përgjithshëm për arritjen e klasterëve të vetëfinancuara. Megjithatë, buxheti mbështetës kryesisht në kontributet e donatorëve dhe programet mbeten në një fazë të hershme të zbatimit – të penguar nga numri i kufizuar i personelit dhe fondet e kufizuara. Pavarësisht vështirësive, një klaster në industrinë e metaleve dhe sektorin e energjisë së rinovueshme (KIMERK) është krijuar deri më tani.

Ndërkohë, programet e financuara nga donatorët po plotësojnë boshllëqet. Programi i Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport financiar nga Banka Botërore në

shumën prej 14.3 milionë euro, përfshin mbështetjen për NVM-të me potencial eksportues, për të rritur gatishmërinë e tyre për eksport dhe konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare. Masat e përfshira deri në vitin 2022 do të ndihmojnë Kosovën të ndër marrë përpjekjen e konsiderueshme për përmirësimin e infrastrukturës kombëtare të cilësisë për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të përgatitur NVM-të për t'u integruar në zinxhirët globalë të vlerave (Banka Botërore, 2017^[55]).

NVM-të informohen sistematikisht përmes “Ditëve të Biznesit të Vogël” rreth programeve dhe nismave të politikave për lehtësimin e integritimit në zinxhirët globalë të vlerave. Rreth 10 konferenca janë organizuar gjatë vitit në komuna të ndryshme nga MTI dhe KIESA, gjatë të cilave janë prezantuar objektivat e qeverisë dhe NVM-të kanë pasur mundësi të japin reagime kthyes.

Promovimi i përdorimit të tregtisë elektronike

Të dhënat zyrtare mbi tregtinë elektronike në Kosovë ende nuk janë në dispozicion, edhe pse Agjencia e Statistikave të Kosovës ka filluar të mbledhë dhe të zhvillojë statistika mbi shoqërinë informative që nga prilli i vitit 2017, në përputhje me standardet e Eurostat (rezultatet nuk janë ende të gatshme). Kosova po përgatit udhëzime administrative për operatorët e tregtisë elektronike dhe faqet e tyre në një përpjekje për të reduktuar pengesat (OECD, 2018^[10]). Ndërkohë, në Kosovë nuk ka asnjë faqe interneti me informata lehtësisht të qasshme mbi tregtinë elektronike.

Për sa i përket mjedisit rregullator për mbështetjen e tregtisë elektronike, Ligji i Kosovës për Shërbimet e Shoqërisë Informatike (Nr. 04 / L-094), përcakton se dokumentacioni në formë elektronike është ligjërisht ekuivalent me dokumentacionin tradicional të paraqitur në formatin letër. Kjo lehtëson shërbimet elektronike që përfshijnë shërbimet elektronike bankare dhe financiare, ofrimin e shërbimeve qeveritare, prokurimin elektronik nga ndërmarrjet dhe aplikimin e nënshkrimeve elektronike për të mbuluar pagesat elektronike.

Megjithatë, Kosova ka zbatuar vetëm pjesërisht ligjin e saj mbi tregtinë elektronike, ndërkohë që korniza e autentikimit elektronik ende është duke u përditësuar dhe ende ka nevojë të punojë me bankat komerciale për të zëvendësuar proceset rigoroze që i dekurajojnë bizneset nga adoptimi i praktikave të tregtisë elektronike (OECD, 2018^[10]). Për shembull, akterët e sektorit privat në Kosovë raportojnë vështirësi në mbajtjen e klientëve ndërkombëtarë në tregtinë elektronike, për shkak të vështirësive të krijimit të shërbimeve online për të pranuar pagesa me kartela krediti, që bankat lokale shpesh nuk e ofrojnë. Përveç kësaj, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (Nr. 04/L-121), ka ende rrugë për të bërë për përafrim me kornizën e BE-së për tregtinë elektronike (OECD, 2018^[10]).

Ministria e Zhvillimit Ekonomike së bashku me akterë të tjerë, ka ndërmarrë hapin e parë në transpozimin e Rregullores eIDAS të Bashkimit Evropian mbi shërbimet elektronike të identifikimit dhe besimit në legjislacionin e brendshëm të Kosovës. Në mars 2018, qeveria miratoi Koncept Dokumentin për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e besimit për Transaksionet Elektronike, i cili do të formojë draftin e ardhshëm të Ligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e besimit për Transaksionet Elektronike.

Rruga përpara për dimensionin 10

Pavarësisht nga progresi i bërë, ende mbeten sfida të mëdha. Barrierat e rëndësishme tregtare dhe cilësia e dobët e produkteve pengojnë eksportet e NVM-ve dhe integritimin e tyre në zinxhirët globalë të vlerave, pavarësisht nga projektet në vazhdim që kërkojnë t'i adresojnë këto. Bashkë-koordinimi më i madh institucional për mundësimin e tregtisë

elektronike mbetet ende për t'u realizuar. Në dritën e këtyre sfidave të vazhdueshme, Kosova duhet të synojë të miratojë rekomandimet e mëposhtme:

- **Fokusimi në zbatimin e fuqishëm të programeve dhe ndjekja e tyre përmes monitorimit dhe vlerësimit të fuqishëm** për të siguruar që objektivat e Kosovës për gatishmërinë për eksport dhe nxitjen e eksportit të paraqitura në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat dhe Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit përkthehen në rezultate konkrete dhe të matshme. Vetëm 5% e NVM-ve në Kosovë eksportojnë dhe niveli i mbijetesës së firmave eksportuese është jashtëzakonisht i ulët. Kosova duhet të synojë të zbatojë programe mbështetëse që së pari do të sigurojnë që më shumë NVM të jenë "të gatshme për eksport", teksa punon në programet e promovimit të eksportit për të mbështetur ato që tashmë janë të afta dhe për të rritur mundësitë e tyre të mbijetesës. Mekanizmat konsistentë të vlerësimit duhet të jenë një tipar i brendshëm i këtyre programeve për të vlerësuar efektivitetin e tyre.
- **Rritja e përpjekjeve për të zhvilluar programe për të mbështetur klasteret e sektorëve të zgjedhur.**
Përderisa ky objektivi është përshkruar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe në draft Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat, ende nuk janë ndërmarrë iniciativa konkrete. Kosova duhet të mbështetet në aktivitetet e saj të mëparshme sporadike dhe të zgjerojë më tutje mbështetjen e saj për klasteret e identifikuara që janë të nxitura nga disponueshmëria e lëndëve të para dhe aftësive dhe që janë vlerësuar se kanë potencial eksporti në afat të mesëm dhe të gjatë. Kosova duhet të përmbahet nga krijimi i klasterëve të reja nga e para, dhe në vend të saj të ofrojë mbështetjen e saj për ato ekzistuese.
- **Krijimi i një mjedisi operativ dhe ligjor që mund të mbështesë përdorimin e tregtisë elektronike.** Kosova së pari duhet të zhvillojë një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse që mbështet përdorimin e rregulluar të tregtisë elektronike duke harmonizuar legjislacionin e saj mbi tregtinë elektronike dhe mbrojtjen e konsumatorit me kuadrin rregullator të BE-së. Në kohën e përpilimit të këtij dokumenti, Banka Botërore dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës ishin në proces të lansimit të Programit të Ekonomisë Digjitalë të Kosovës, me qëllim të përmirësimit të lidhshmërisë digjitale në të gjithë ekonominë. Nëse zbatohet pa vonesa, ky program mund të ndihmojë në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e tregtisë elektronike për NVM-të dhe rritjen e pranisë së NVM-ve në internet nëpërmjet faqeve të internetit, marketingut të medias sociale dhe mundësimin e tregtisë elektronike për produktet dhe shërbimet e tyre (Banka Botërore, 2018^[56]).

Përfundime

Në vitet e fundit, Kosova ka demonstruar progres të konsiderueshëm në zvogëlimin e barrës administrative për NVM-të dhe në ndërtimin e një mjedisi të favorshëm për biznes. Veçanërisht, krijimi i zyrave për shërbime në një vend (one stop shops) në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës ishte një moment i rëndësishëm, pasi i lejon ndërmarrësit të themelojnë bizneset e tyre në një mënyrë të shpejtë dhe të lirë.

Megjithatë, përmirësimet në mjedisin rregullator nuk janë plotësuar duke integruar plotësisht parimin "think small" të ABV në politikë-bërje. Megjithëse mbetet ende një rrugë e gjatë përpara për të përfshirë një test të NVM-ve në vlerësimet e ndikimit rregullator, ndikimi i rregulloreve të reja në NVM-të duhet prapë se prapë të shqyrtohet.

Në fund, Kosova është ende në fazat shumë të hershme të ofrimit të mbështetjes financiare dhe jofinanciare të përshtatur për NVM-të për të përmirësuar konkurrueshmërinë e tyre. I gjithë peizazhi i mbështetjes për NVM-të aktualisht dominohet nga donatorët, gjë që mund të rezultojë në mbivendosje të iniciativave. Një qasje më strategjike ndaj punës me donatorët në kuadër të Strategjisë së re për Zhvillimin e Sektorit Privat do të ishte një hap i parë i mirë përpara.

Shënime

- ¹ Në rastin e Kosovës përqindja norma e rritjes duhet të analizohet në kontekstin e efektit të bazës së ulët. Kjo i referohet tendencës që një ndryshim i vogël nga një shumë e vogël fillestare të përkthehet në një përqindje të madhe, duke e bërë që të duket i madh.
- ² Rajoni i BPT i referohet gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor në fazën e para-anëtarësimit (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia) dhe Turqia. Përveç nëse specifikohet ndryshe, referimi në "rajonin" në këtë publikim nënkupton këto shtatë ekonomi.
